

Dhjetor 2020
Numri: 153
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

**KY ËSHTË LIBRI
NË TË CILIN
NUK KA DYSHIM**




revistaetika



progresibotime

E çfarë mund të jetë tjetër
qëndrimi indiferent,
pandjenja dhe injorant përballë
mrekullive të pafundme
madhështore, që prej
grimcës më të vogël, e deri tek
trupi më i madh, prej botës
mikro, e deri në atë makro,
të cilat ndriçojnë më së miri
mendjen dhe zemrën,
përveçse një çoroditje
dhe falimentim i mendjes!?



Profeti (a.s.), thotë:

“Ditën e Kiametit asnjë rob
nuk do të bëjë qoftë edhe një hap
pa u pyetur se ku e ka kaluar jetën
e tij, se çfarë ka bërë me dijen e
tij, se ku e ka (tuar dhe shpenzuar
pasurinë e tij dhe se ku e ka
konsumuar trupin e tij.” (Tirmidhi,

Kiamet, 1/2417)

“Allahu i Madhëruar e do të riun e
pjekur, që nuk sillet si fëmijë, që
është drejtuar kah e mira dhe ka
braktisur dëshirat e kënaqësitë (e
ulëta të egos).” (Ahmed, IV, 151.)



Allahu Teala çdo peygamberi i ka dhënë një mrekulli për të vërtetuar profecinë e tij. Ajo mrekulli jepej në atë çështje që nuk ishte e natyrshme për atë kohë. Për shembull, në periudhën kur magjia ishte në nivelin më të përparuar, Musai i mposhti të gjithë magjistarët me shkopin e tij. Nëse mund ta përfytyrojmë, Faraoni edhe pse kishte me vete ushtrinë prej mijëra ushtarësh, komandantët dhe thesaret, mbeti pa asnjë rrugëzgjidhje kundrejt shkopit të Musait (a.s.) dhe u poshtërua ndaj popullit dhe burrave të tij. Në të njëjtën mënyrë, edhe Isai (a.s.), i ngjalli të vdekurit dhe i shëroi menjëherë sëmundjet që mjekësia nuk u gjente dot zgjidhje. Por sot nuk gjendet as shkopi i Musait (a.s.), as dija mjekësore e Isait (a.s.). Mrekullitë e tyre mbetën të kufizuara me atë kohë, sepse këta peygamberë kanë qenë dërguar për popuj të caktuar në një kohë të caktuar. Ndërsa Peygamberi ynë, Muhamedi (a.s.), ka qenë i dërguar për të gjithë njerëzimin dhe për të gjitha kohërat. Ngaqë situata është e tillë, atëherë si ndryshe nga peygamberët e tjerë, edhe mrekullia që iu dha atij duhet të ishte e përhershme.

Me të vërtetë, mrekullia e Kuranit që i është dhënë të Dërguarit të Allahut (a.s.), i ka mahitur njerëzit edhe me tekstin, edhe me kuptimin e saj. Edhe pse ka kaluar shumë kohë, Kurani Fisnik prapë se prapë nuk është vjetërsuar dhe nuk është manipuluar si librat e tjerë hyjnorë. Sot një hafiz që rritet në fund të Kinës nuk mund ta kuptojë gjuhën e një hafizi tjetër që rritet në ndonjë fshat të Afrikës, por nëse ndonjëri bën gabim në këndimin e Kuranit përgjatë namazit, tjetri mund ta korrigjojë. Nëse e shohim Librin tonë Fisnik nga aspekti i kuptimit, shkencat moderne dhe zbulimet shkencore vazhdimisht i mbështesin të vërtetat e Kuranit. Shumë njerëz mbesin pa fjalë kundrejt strukturës letrare, shkencore dhe psikologjike të Kuranit dhe hyjnë në Islam.

Bota përëndimore e cila nuk e ka mposhtur dot botën Islame me shekuj të tërë, e ka kuptuar se fuqia jonë vjen nga Kurani Fisnik. Si rrjedhojë janë përpjekur për të nxjerrë në pah gjëra të dyshimta nga Kurani Fisnik, në mënyrë që ta ndalonin përparimin e botës islame. Bazuar në këtë, së pari filluan të analizonin tekstin e Kuranit. Ata kërkuar kundërthënie dhe gabime duke menduar se edhe myslimanët do ta bënin të njëjtin manipulim siç e kanë bërë ata me librin e tyre. Po të gjenin disa kopje të ndryshme të Kuranit në çfarëdo cepi të botës qoftë, do të zgjidhej i gjithë problemi dhe do të thoshin: "Shikoni, Kurani nuk është fjalë e Allahut. Po të ishte ashtu, nuk do të kishte katër-pesë kopje të ndryshme." Pasi orientalistët dështuan në këtë çështje, këtë herë filluan të sulmonin përmbajtjen e Kuranit. Ata hodhën mendimin më të rrezikshëm prej shumë mendimeve të humbura se gjoja Kurani është historik dhe se urdhrat e tij nuk përfshijnë të gjitha kohërat. Për fat të keq, prej njerëzve të mposhtur nga mendjemadhësia e nefsit në botën islame, pati prej atyre që u mashturuan nga ky mendim. Këta krahas vetes, e konsideruan si detyrë edhe ngatërrimin e kokave të myslimanëve të tjerë. Sipas këtyre të devijuarve, fjala e Allahut, i Cili është Krijuesi i gjithësisë, është historike dhe nuk ka fuqi për t'ju dhënë dritë të gjitha kohërave. Ndërsa përrallat që i shkruan me mendjet e tyre të pakta na qenkan universale. Pra, mendimet e tyre të devijuara qenkan mbi shekujt.

Dhjetor 2020

VITI: XIV
NUMRI: 153

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"
Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardan Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 45 639 143
Prishtinë; Kosovë
Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Maqedonija
Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni: 900 Denar
Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrate të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.


Përmbajtja



7 Ndërkohë që urdhri i Allahut
është i qartë...
Dr. Adem Ergyl



21 Ngushtimi i së gjerës
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan




10



34 Lumturia Familjare
Osman Nuri Topbash

- 5** Thirrja për gjykim të shëndoshë
Ahmet Tashgetiren
- 10** Kurani, mrekullia e pafundme
Prof. dr. Sulejman Derin
- 13** Mus'hafi është historik, jo Kurani!
Senai Demirxhi
- 15** Disa gabime që bëhen
në komentimin e Kuranit
Dr. Murat Kaja
- 24** Analiza e "Ah sikur"-ëve në Kuranin Fisnik
Xhafer Durmush
- 26** Rëndësia e rinisë
dhe çështja e identitetit
Prof. dr. Kerim Bulladë
- 29** Përpjekja për kapërcimin
e pengesave të jetës
Sami Byjkkajnak



50

Një Ajet - Një Hadith 32

- Ndarja, ah ndarja 40**
Mehmet Ali Var
- Mëshira, nevoja e shekujve
dhe ilaçi i zemrave 42**
Hajretin Durmush
- Altruizmi 50**
Sami Gëksyn
- Feja është sinqeritet! 54**
Hadi Enall
- Nevoja e njerëzimit
për mëshirën e botëve 56**
Sali Shasivari

44



**Shkaqet e divorceve
që përjetojnë nëpër familje**
Ahmet Zyljan

Nëse fqinjësia ka vdekur, ejani ta ngjallim!
Ajnur Tutkun

52



Thirrja për gjykim të shëndoshë

— Ahmet Tashgetiren —

Ky shkrim, është një thirrje për gjykim të shëndoshë, që i drejtohet qarqeve të cilat njihen si “modernistë” ose “historicistë”, duke u nisur nga mendimi se “bashkohemi në pikën e përbashkët Islame”. Kjo është një thirrje që bëhet pa pretendime për superioritet.

Për këtë arsye, nuk do të shpreh dhe as që do të diskutojë se në cilën pikë të besimit ndodheni ju. Këtë mund ta bëj vetëm si një besimtar, me dëshirën që ju të mos përjetoni asnjë problem në çështjen e besimit. Të njëjtin kujdes tregoj edhe për veten time. Në fund të fundit, uniteti i besimit, na e bën të detyrueshëm një kujdes të tillë ndaj njëri-tjetrit.

Kjo thirrje për gjykim të shëndoshë, është për një shkak tjetër:

Ligjërimet tuaja moderniste dhe historiciste që fillojnë me cekjen e haditheve, dhe më pas kthehen duke “vënë në pikëpyetje vet Profetin (a.s.)”, trondit besimin e të rinjve që janë të detyruar të jenë nxënës të tuaj.

Ky problem, ndonjëherë bëhet i njohur nga debatet që bëjnë të rinjtë në lidhje me besimin, me tema të ndryshme si “deizmi”, etj. Ndonjëherë, del në pah për shkak të ndryshimeve që vënë re prindërit tek fëmijët e tyre.

Është realitet se, sot, ky fenomen ka arritur në dimensione të atilla, ku ata të cilët predikojnë të tilla mendime, akuzohen për “besim të dobët” nga ana e shtresës fetare. Dhe, vihet re qartë se, për shkak të pasojave që mund të lindë, kjo gjuhë akuzuese irriton shumë njerëz.

Në të njëjtën mënyrë, duke u shkëputur nga atmosfera e ndjenjave të thella Islame dhe duke u tërhequr në truallin e akuzave reciproke, këto debate krijojnë probleme të mëdha edhe në botën e mendimit. Por, është e pamundur që të shpëtojmë nga kjo duke akuzuar njerëzit vetëm me një bagazh dijeshe të kushtëzuara nga procesi historik. Po ashtu, është e pamundur të shpëtojmë edhe nëse i konsiderojmë të rinjtë që vënë në pikëpyetje besimin e tyre, si “të rinj të shpëtuar”. Nëse nuk duam ta neglizhojmë gjendjen që do të katandisen marrëdhëniet e këtyre të rinjve me Islamin në hapin tjetër, ose nëse këta të rinj nuk duan të pësojnë diçka të tillë, le të bëjmë më parë një evidentim:

- Ky fenomen, nuk duket si një përpjekje për të kuptuar më mirë, duke medituar mbi Kuranin Fisnik.

- Ky fenomen, nuk duket as si përpjekje për evidentimin e transmetimeve që nuk i përkasin Profetit tonë (a.s.).

- Po ashtu, ky fenomen nuk duket as si shqetësim për përmirësimin e akides/sistemit të besimit të të rinjve.

Por, si duket?

- Prioriteti që i jepet Kuranit, synon t'i kufizojë kompetencat Profetit tonë (a.s.).

- Kritika ndaj hadithit, synon të bëjë të debatueshme çdo gjë që ka të bëjë me Profetin (a.s.).

- Pretendimi se një pjesë e ajeteve të Kuranit janë historike, synon që pas kufizimit të hapësirës së Profetit, të kufizohet edhe hapësira e Kuranit.

- Debatu rreth përmbajtjes dhe mesazhit të disa ajeteve kuranore, synon të krijoj idenë se në Kuran mund të gjenden edhe ajete të tjera të debatueshme.

- Për më tepër, këto synojnë të lindin dyshime në lidhje me ato që janë shpallur nga Allahu i Madhëruar.

- Krahas këtyre, synojnë të lënë jashtë loje funksionet kufizuese të dy burimeve themelore të fesë, Kuranit dhe Sunetit, duke i bërë ato të manipulueshme.

Të gjitha këto, barten para popullit, gjë e cila shkakton irritimin dhe acarimin e shtresës fetare. Por, kur këto barten tek të rinjtë, ato krijojnë lëkundje të besimit tek ata.

Pyetja është:

A me të vërtetë këtë duam?

“Thirrja për gjykim të shëndoshë” mbështetet pikërisht në mendimin se nuk është kjo ajo që duam. Por, nëse ekzistenca e një problemi anashkalohet dhe mendimet më problematike i paraqiten hapur publikut, ose nëse, fjala vjen, ky problem bartet tek nxënësit e medreseve në mënyrë që të duket si “mision” dhe përdoret si truall për të edukuar “misionarë” nga fakultetet teologjike, atëherë eliminohet aspekti i sinqeritetit të çështjes dhe në lojë hyjnë llogari të tjera.

Prandaj lind pyetja: Nëse çështja është të konsiderohen të pamjaftueshëm Kurani dhe i Dërguari i Allahut dhe kapërcimi i kriterëve të vendosura nga Fjala e Allahut dhe sunneti i Profetit tonë (a.s.), duke e reduktuar vlerën e tyre deri aty sa t'i konsiderosh “historike”, atëherë përse merren me Islamin? A nuk do të ishte më e zgjuar nga ana e atyre që përpëliten për këtë, të kërkonin një libër dhe një profet tjetër?

Çfarë do të bëni? “Do ta rregulloni?” Çfarë? Kuranin, fjalët e të Dërguarit të Allahut dhe parimet e tij të jetës? Pse? A nuk është më e lehtë të gesh një “Zot” që do të zbresë ajete dhe profetë të tjerë? Nuk bën të gjendet një “Zot” tjetër, një “Profet” tjetër? Pra, puna është të rregullojmë Allahun, të rregullojmë Profetin, të vëmë në rrugë të drejtë Islamin, apo jo? Vallë, mos duken më lehtë këto?

Në qasjen e atij rrethi nuk po dëshmojmë respekt ndaj Kuranit. Nuk po shohim as respekt ndaj Profetit (a.s.). Cili ajet dhe çfarë problemi ka? Cili hadith mund të hidhet në gropën e së shkuarës? Pikërisht këtë lë të kuptohet kjo çështje!

Sahabët dhe dijetarët që kanë ardhur e kanë shkuar prej më se 14 shekujsh, janë botë që tashmë u është hequr viza me kohë!?

Pika e parë e përkufizimit të fesë, është “Ta’dhim li emril-lah / Madhërim dhe respekt ndaj urdhrave të Allahut”. Kjo është një ndjesi zemre.

Por, çfarë kanë për qëllim shprehjet si, “Kurani mund të copëzohet” apo “Madhërimi i ajeteve të Allahut është një dobësi e myslimanëve”, përveçse përçmim? Unë, edhe përcjelljen e këtyre fjalëve këtu në këtë shkrim, e konsideroj si sulm ndaj Allahut, të Dërguarit të Tij (a.s.) dhe Kuranit Fisnik. Nuk ma bën zemra. Dua të kuptoj atmosferën e besimit dhe botën e ndjenjave të atyre që ua bën zemra. I trembur, shoh erozioni e respektit dhe lehtësinë me të cilën menaxhohen parimet Islame në ambientet ku rrihen këto mendime.

Por ne e dimë se:

Feja e Allahut nuk ka “nevojë” për besimin e këtij apo atij individ. Kush dëshiron, beson; kush nuk dëshiron, nuk beson. Po ashtu, edhe feja nuk e humbet vlerën e saj, nëse nuk beson ky a po ai. Kjo fe, ashtu siç ka parë besimtarë, ka parë edhe shumë jobesimtarë, hipokritë dhe nga ata që hyjnë në fe në mëngjes dhe dalin në mbrëmje.

Sprova e njeriut, është të gjejë kriteret e ardhura nga Allahu, t'i besojë ato dhe ta rregullojë jetën sipas tyre. Besimtarët ndjehen të lumtur më tepër kur pranë tyre ndodhet një besimtar tjetër. Hyrja e botës në Islam grupe-grupe i mbyt ata në gëzim të madh. Megjithatë, gjithsecili do të japë provimin e vet. Myslimanët mund edhe të përjetojnë kohë të vështira. Nëse një pjesëtar i ndonjë feje tjetër tërheq pas vetes njerëz të tjerë prej myslimanëve, ose nëse ndonjë myslimani i turbullohen mendimet dhe i lëkundet besimi, padyshim se është për tu hidhëruar. Por, nëse ndonjë prej myslimanëve fillon të vërdalloset hapur duke thënë, “shikoni si ua pështjelluam mendjen!”, dëmi i kësaj, në fillim prek zemrat e atyre që luajnë këtë rol.

Mbase edhe Zoti ynë i Madhëruar, për të tilla situata na e ka mësuar duanë e cila fillon: “Rabbena la tuzig kulubena ba'de idh hedejtenu / Zoti ynë! Mos na i rrëshqit zemrat pasi na udhëzuar njëherë!”

Një gjykim i shëndoshë.

Mendje, por mendje e shëndoshë...

Largpamësi...

Vetëdija se ndodhemi para Allahut...

Vetëdija se nesër do të takohemi me Të dhe do të dalim para Tij...

Kuptimi i vlerës që ka Resulullahu (a.s.), tek Allahu dhe i lidhjes shpirtërore që pritet prej nesh...

Dosja e një jete që mund të mbrohet në botën tjetër...

Allahu na ndihmoftë në provimin e kësaj jete!..



Njeriu në shumicën e rasteve është një krijesë që mund t'i shndërrojë në idhuj dëshirat dhe pasionet e tij. Kështu që në brendësinë e tij nuk mbart ndjenjën e adhurimit ndaj Zotit (xh.xh.), por mbart ndjenjën e të qenët Zot. Kur e gjen mundësinë dhe fuqinë, menjëherë i futen në funksion ndjenjat për ta bërë veten zot, për të formuar sundim dhe për t'i bërë të tjerët shërbëtorë e robër të vetes.



Ndërkohë QË URDHRI I ALLAHUT ËSHTË I QARTË...

— Dr. Adem Ergyl —

Njeriu në shumicën e rasteve është një krijesë që mund t'i shndërrojë në idhuj dëshirat dhe pasionet e tij. Kështu që në brendësinë e tij nuk mbart ndjenjën e adhurimit ndaj Zotit (xh. xh.), por mbart ndjenjën e të qenët Zot. Kur e gjen mundësinë dhe fuqinë, menjëherë i futen në funksion ndjenjat për ta bërë veten zot, për të formuar sundim dhe për t'i bërë të tjerët shërbëtorë e robër të vetes. Ndërsa duhet që dëshirat e tij të ndjekin Zotin dhe të vërtetën, ai përpigjet ta imponojë të vërtetën për t'u bërë shërbëtorja e pasioneve të tij.

Adij ibn Hakimi (r.a.), tregon: Shkova te i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, ndërkohë që në qafë kisha një kryq prej floriri. Ai më tha: “Çfarë është ky kështu, o Adij? Hiqe atë idhull prej trupi!” Pastaj e dëgjova atë duke kënduar ajetin e sures Teube: **“Në vend të Allahut, ata kanë zgjedhur për zot rabinët dhe murgjit e tyre, si dhe Mesinë, të birin e Merjemes...”** (Teube, 31) Pastaj më tha: “Ata nuk i adhuronin këta, por kur këta ua bënë hallall diçka, ata e pranonin si hallall dhe kur ua bënë haram diçka e pranonin si haram. (Në këtë mënyrë i pranonin ata si zota.)” (Tirmidhi, Tefsir, 9/10.)

Prirja për të qenë zot nganjëherë shfaqet te pushtetarët si she-mbulli i Faraonit, nganjëherë shfaqet te njerëzit e pasur si she-mbulli i Karunit dhe nganjëherë tjetër shfaqet te klasa e dijetarëve dhe rabinëve. Ne në këtë material do të shtjellojmë lëvizjet manipuluese të atyre njerëzve historicistë dhe modernistë që i konsiderojnë dispozitat e qarta që ka zbritur Allahu si rregulla që i takojnë të kaluarës, që nuk i shikojnë ato si të përshtatshme për kushtet e periudhës sonë dhe që i kanë përveshur krahët për t'i shndërruar ato në përputhje me epshin e tij apo të dikujt tjetër. Ndoshta njerëzit e këtij orientimi thonë se nuk janë duke shkak-tuar prishje, por duke bërë rregullime. Madje ata edhe mund të besojnë se janë të tillë. Këta lloj njerëzish mbrojnë mendimin se disa dispozita që i ka vendosur Allahu duhet të jenë të kufizuara



me një kohë të caktuar, vend të caktuar dhe kushte të caktuara dhe se nuk mund të jetë e drejtë që ato dispozita të zbatohen në kohë, vende dhe kushte të ndryshme. Domethënë këta lloj njerëzit pothuajse dëshirojnë t'i mësojnë fenë Allahut dhe të jenë zota mbi robërit e Allahut. Këto paralajmërime të Zotit i deshifrojnë plotësisht njerëzit që kanë pikëpamje të tilla: **"Thuaj: "Vallë, a të kërkoj tjetër gjykatës përveç Allahut, kur është Ai që ju ka zbritur këtë Libër të hollësishëm?!" Ata që Ne u kemi dhënë Shkrimet e shenjta, e dinë se Kurani është me të vërtetë i zbritur nga Zoti yt. Prandaj, kurrësi mos u bëj nga ata që dyshojnë!"** (En'am, 114)

"Prandaj gjykoji sipas asaj që të ka shpallur Allahu e mos ndiq dëshirat e tyre të kota! Ki kujdes që ata mos të të nxisin të largohesh nga një pjesë e asaj që të ka shpallur Allahu! Nëse ata të kthejnë kurrizin e nuk dëgjojnë gjykimin tënd, atëherë ta dish se Allahu do vetëm që t'i dënojë për disa gjynahe të tyre. Në të vërtetë, shumë njerëz janë të pabindur." (Maide, 49)

Le të japim edhe një të vërtetë tjetër kuranore të cilën historicistët nuk e shohin dot apo nuk duan që ta shohin: Edhe pse ndërmjet Musait, alejhi's-selam (shekulli i 13-të para erës sonë) dhe të Dërguarit të Allahut, pagja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, kishte kaluar një kohë prej dy mijë vjetësh, çifutët që jetonin në periudhën e Pejgamberit (a.s.), nuk gjykonin me ligjet e zbritura në Teurat. Kjo u bë shkak që ata të cilësoheshin si qafirë, zullumqarë dhe njerëz të prishur. Domethënë, nisur nga botë-kuptimi historicist, ata që i manipulojnë dispozitat e Allahut janë gjendur ballë për ballë me një kërcënim shumë të madh hyjnor. Zoti duke iu drejtuar atyre na paralajmëron edhe neve si besimtarë, në mënyrë që të mos biem në të njëjtin gabim:

"E qysh të drejtohen ata ty për t'i gjykuar, ndërsa e kanë Teuratin, në të cilin është gjykimi i Allahut, e madje edhe pas kësaj shmangen prej teje? Sepse

Çfarë qëndrimi prej besimtari është tentativa për ta ndryshuar dispozitën e Zotit të Lartësuar i Cili ka dije të pakufizueshme, duke i konsideruar si të mjaftueshme dijen, mendjen dhe perceptimin e kufizuar të njeriut? Në fakt njerëzve të tillë u duket i vështirë nënshtrimi ndaj Zotit. Të mos harrojmë se arritja e suksesit në sprovën e nënshtrimit ndaj Zotit nuk varet nga rregullat tona, por nga qëndrimi që mbajmë kundrejt urdhrave dhe ndalesave të Zotit (xh.xh.).

ata nuk janë besimtarë. Ne kemi dërguar Teuratin, në të cilin janë udhëzimet dhe drita. Sipas tij, profetët që ia kishin dorëzuar veten Allahut, i gjykonin hebrenjtë; por edhe të diturit dhe rabinët kështu vepronin, sepse atyre iu qe besuar mbrojtja e Librit të Allahut, për të cilin ata dëshmonin. Prandaj, mos kini frikë nga njerëzit, por kini frikë vetëm prej Meje! Dhe mos i ndërroni Fjalët e Mia me ndonjë vlerë të vogël! Kushdo që nuk gjykon sipas asaj që ka shpallur Allahu, ai është mohues i vërtetë. Ne u caktuam atyre në Teurat: jeta me jetë, syri me sy, hunda me hundë, veshi me vesh, dhëmbi me dhëmb dhe plaga me plagë (të njëjtë me të). Por kushdo që fal shpagimin si lëmoshë, ka bërë një vepër që është shlyerje për gjynahet e veta. Kushdo që nuk gjykon sipas asaj që ka zbritur Allahu, ai është shkelës i vërtetë. Pas atyre profetëve, Ne dëguam Isain, të birin e Merjemes, si vërtetues të Teuratis që kishte ardhur para tij. Dhe i dhamë atij Ungjillin, në të cilin ka udhëzim dhe dritë, si përmbushje të asaj që ishte shpallur para tij në Teurat dhe si udhërrëfim e këshillë për ata që i frikësohen Allahut." (Maide, 43-46)

Kush e di, ndoshta ka pasur edhe shumë rabinë që i kanë konsideruar të rënda këto dispozita dhe kanë tentuar për t'i ndryshuar. Ndoshta kanë thënë: "Njerëzimi i djeshëm nuk ka qenë si i sotshmi. Këto dispozita kanë qenë të drejta për ata, por në ditët e sotme shoqërisë moderne duhet t'i vendosim ndëshkime të ndryshme në vend të ndëshkimeve të tilla." Andaj këto ajete na tregojnë se ata që mendojnë kështu kanë probleme me besimin. Sa paralajmërim i madh që janë për atë të cilin dëshiron të kuptojë!

Dispozitat e prera që shprehen qartazi në fjalën hyjnore nuk mund të ndryshohen me supozime dhe bindje personale. Fjalët e mëposhtme të hoxhës së nderuar, Prof. Dr. Sait Shimshekut janë udhërrëfyese për ata që kanë rënë në dyshime:

“Për çdo ajet të Kuranit Fisnik nuk mund të thuhet se ka zbritur për të zgjidhur problemet e shoqërisë në atë periudhë apo se ka zbritur vetëm si përgjigje për ngjarjet që kanë ndodhur në atë kohë. Madje, edhe në ajetet që kanë zbritur në lidhje me disa ngjarje të caktuara dhe veprime të dikujt, flitet shumë pak për personat, emrat e vendeve dhe kohën.

Personat nuk përmenden me emra e tyre dhe nuk përcaktohet ngjarja apo koha, në mënyrë që t’u jepet një cilësi universale mesazheve etike apo juridike për të cilat bëhet fjalë. Dijetarët tanë thonë se ajetet kanë dy shkaqe zbritjeje. Bazuar në këtë, siç ka ajete që shkaku i zbritjes së tyre është i veçantë, ka edhe ajete që shkaku i zbritjes së tyre është i përgjithshëm. Ajeteve të cilat e kanë të veçantë shkakun e zbritjes janë ajetet që kanë zbritur në lidhje me një ngjarje të caktuar. Ndërsa ajetet që e kanë të përgjithshëm shkakun e zbritjes janë ajetet e zbritura për rregullimin e besimit, moralit dhe të çështjeve sociale të njerëzve që do të vijnë (në këtë botë) deri në kiamet. Këto ajete nuk kanë zbritur duke u bazuar në ndonjë shkak të caktuar. Dijetarët veçanërisht kanë thënë se edhe ajetet që kanë zbritur në bazë të ndonjë shkakut të caktuar nuk vlejnë vetëm për atë shkak, por se dispozita e tyre është e përgjithshme. Këtë e kanë shprehur kështu: “Shkaku specifik nuk është pengesë për të qenët e dispozitës e përgjithshme.”¹

“Është e pamundur ta ndryshojmë dispozitën e tekstit të prerë duke u bazuar në diçka të supozueshme. Domethënë, nëse te teksti (argumenti hyjnor apo profetik), i cili shpreh një dispozitë, nuk gjendet ilet i asaj dispozite (dmth. qëllimi i cili është bërë shkak për dhënien e asaj dispozite) apo nëse në ndonjë vend tjetër të Kuranit nuk është treguar ky ilet, ne nuk mund të themi se ilet i kësaj dispozite është ky dhe se dispozita ka ndryshuar ngaqë ka ndryshuar ilet. Kështu, pasi Allahu shprehet se nuk ka asnjë problem që gratë e divorcuara t’u kthehen përsëri bashkëshortëve të mëparshëm pasi ta plotësojnë kohën e ide-

tit/pritjes, thotë: “...Allahu di, ndërsa ju nuk dini.” (Bekare, 232) Është shumë interesant fakti që kjo shprehje gjendet në fund të grupit të ajeteve në të cilat përmenden martesat, mehri, divorci dhe ideti. Përveç të tjerash, shprehja: “Allahu di, ndërsa ju nuk dini.”, gjendet edhe në shumë ajete të tjera. Andaj dija e njeriut është e paafte për të gjetur iletin e disa dispozitave.”²

Sigurisht se dijetarët tanë kanë bërë vlerësime/shpjegime të ndryshme në lidhje me ajetet që nuk kanë vetëm një kuptim dhe që japin mundësinë për të bërë komentime të ndryshme. Andaj në lidhje me dispozitat që nuk janë të qarta, gjithmonë mund të bëhet ixhtihad. Përfundimet e arrira në këtë mënyrë dihet se mund të ndryshojnë sipas kohës dhe vendit, sepse edhe ixhtihadi nuk është dije e prerë, por e supozueshme. Por në ditët e sotme po shohim guximtarë të tillë që edhe në lidhje me dispozitat krejt të qarta të Zotit (xh.xh.), thonë se duhet të ndryshohen duke u shprehur se u ka kaluar koha.

Çfarë qëndrimi prej besimtari është tentativa për ta ndryshuar dispozitën e Zotit të Lartësuar i Cili ka dije të pakufizueshme, duke i konsideruar si të mjaftueshme dijen, mendjen dhe perceptimin e kufizuar të njeriut? Në fakt njerëzve të tillë u duket i vështirë nënshtrimi ndaj Zotit. Të mos harrojmë se arritja e suksesit në sprovenë e nënshtrimit ndaj Zotit nuk varet nga rregullat tona, por nga qëndrimi që mbajmë kundrejt urdhrave dhe ndalesave të Zotit (xh.xh.). Shndërrimi dhe lartësimi i shoqërisë në pozitën që e do Zoti (xh.xh.), në vend të zbritjes së dispozitave hyjnore në nivelin e shoqërisë duke e perceptuar jetën dhe vlerat e saj si burim i dijes, përgjatë gjithë historisë ka qenë misioni i pejgamberëve. Andaj edhe në ditët e sotme preokupimi dhe përpjekja e zemrave besimtare, e dijetarëve dhe e njerëzve të urtë duhet të jenë në këtë aspekt. Zërat dhe thirrjet e ndryshme shpesh herë janë pëshpëritje djallëzore dhe vetjake. I kërkojmë mbrojtje Allahut nga rënia në një gjendje të tillë.

1. Sait Shimshek, Problemet e Tefsirit në ditët e So - me, fq. 245.

2. Sait Shimshek, vepra e lartpërmendur, fq. 248.



Kurani

MREKULLIA E PAFUNDME

— Prof. dr. Sulejman Derin —

Allahu Teala çdo peygamberi i ka dhënë një mrekulli për të vërtetuar profecinë e tij. Ajo mrekulli jepej në atë çështje që nuk ishte e natyrshme për atë kohë. Për shembull, në periudhën kur magjia ishte në nivelin më të përparuar, Musai i mposhti të gjithë magjistarët me shkopin e tij. Nëse mund ta përfyty-

Mrekullia e Kuranit që i është dhënë të Dërguarit të Allahut (a.s.), i ka mahnitur njerëzit edhe me tekstin, edhe me kuptimin e saj. Edhe pse ka kaluar shumë kohë, Kurani Fisnik prapë se prapë nuk është vjetërsuar dhe nuk është manipuluar si librat e tjerë hyjnorë.

rojmë, Faraoni edhe pse kishte me vete ushtrinë prej mijëra ushtarësh, komandantët dhe thesaret, mbeti pa asnjë rrugëzgjdhje kundrejt shkopit të Musait (a.s.) dhe u poshtërua ndaj popullit dhe burrave të tij. Në të njëjtën mënyrë, edhe Isai (a.s.), i ngjalli të vdekurit dhe i shëroi menjëherë sëmundjet që mjekësia nuk u gjente dot zgjidhje. Por sot nuk gjendet as shkopi i Musait (a.s.), as dija mjekësore e Isait (a.s.). Mrekullitë e tyre mbeten të kufizuara me atë kohë, sepse këta peygamberë kanë qenë dërguar për popuj të caktuar në një kohë të caktuar. Ndërsa Peygamberi ynë, Muhamedi (a.s.), ka qenë i dërguar për të gjithë njerëzimin dhe për të gjitha kohërat. Ngaqë situata është e tillë, atëherë si ndryshe nga peygamberët e tjerë, edhe mrekullia që iu dha atij duhet të ishte e përhershme.

Me të vërtetë, mrekullia e Kuranit që i është dhënë të Dërguarit të Allahut (a.s.), i ka mahnitur njerëzit

edhe me tekstin, edhe me kuptimin e saj. Edhe pse ka kaluar shumë kohë, Kurani Fisnik prapë se prapë nuk është vjetërsuar dhe nuk është manipuluar si librat e tjerë hyjnorë. Sot një hafiz që rritet në fund të Kinës nuk mund ta kuptojë gjuhën e një hafizi tjetër që rritet në ndonjë fshat të Afrikës, por nëse ndonjëri bën gabim në këndimin e Kuranit përgjatë namazit, tjetri mund ta korrigjojë. Nëse e shohim Librin tonë Fisnik nga aspekti i kuptimit, shkencat moderne dhe zbulimet shkencore vazhdimisht i mbështesin të vërtetat e Kuranit. Shumë njerëz mbesin pa fjalë kundrejt strukturës letrare, shkencore dhe psikologjike të Kuranit dhe hyjnë në Islam.

Bota perëndimore e cila nuk e ka mposhtur dot botën Islame me shekuj të tërë, e ka kuptuar se fuqia jonë vjen nga Kurani Fisnik. Si rrjedhojë janë përpjekur për të nxjerrë në pah gjëra të dyshimta nga Kurani Fisnik, në mënyrë që ta ndalonin përpërimin e botës islame. Bazuar në këtë, së pari filluan të analizonin tekstin e Kuranit. Ata kërkuar kundërthënie dhe gabime duke menduar se edhe myslimanët do ta bënin të njëjtin manipulim siç e kanë bërë ata me librin e tyre. Po të gjenin disa kopje të ndryshme të Kuranit në çfarëdo cepi të botës qoftë, do të zgjidhej i gjithë problemi dhe do të thoshin: “Shikoni, Kurani nuk është fjalë e Allahut. Po të ishte ashtu, nuk do të kishte katërpesë kopje të ndryshme.” Pasi orientalistët dështuan në këtë çështje, këtë herë filluan të sulmonin përmbajtjen e Kuranit. Ata hodhën mendimin më të rrezikshëm prej shumë mendimeve të humbura se gjoja Kurani është historik dhe se urdhrat e tij nuk përfshijnë të gjitha kohërat. Për fat të keq, prej njerëzve të mposhtur nga mendjemadhësia e nefsit në botën islame, pati prej atyre që u mashtruan nga ky mendim. Këta krahas vetes, e konsideruan si detyrë edhe ngatërrimin e kokave të myslimanëve të tjerë. Sipas këtyre të devijuarve, fjala e Allahut, i Cili është Krijuesi i gjithësisë, është historike dhe nuk ka fuqi për t’ju dhënë dritë të gjitha kohërave. Ndërsa përrallat që i shkruan me mendjet e tyre të pakta na qenkan universale. Pra, mendimet e tyre të devijuara qenkan mbi shekujt.

Siç është shprehur edhe imam Gazaliu, ata të cilët e marrin dijen, e cila është një dritë që vjen nga Allahu, për interesat e kësaj bote dhe për ta bërë veten të famshme, herët apo vonë janë të predispozuar për të devijuar. Për këtë arsye i këshillohet që fillestarët, të preokupohen më shumë me dhikër (përmendjen e Allahut). Kur besimtari të pastrohet me dhikër, atëherë fillon të lexojë Kuran dhe të preokupohet më shumë me këtë të fundit. Madje, teksa

përparimi shpirtëror në fillim bëhet me dhikër, në fund merret për bazë përparimi me Kuran. Imam Rabbani e shpjegon si më poshtë këtë çështje:


“Ajo që është e përshtatshme për besimtarët fillestarë është preokupimi i tyre me dhikër dhe përpjekja për ta shkukur nga zemra çdo gjë derisa të mos mbetet në mendjet e tyre asgjë përveç Allahut (xh. xh.). Besimtari duhet të vijë deri në atë gjendje saqë, nëse të tjerët ia kujtojnë me imponim gjërat përveç Allahut, ai prapë se prapë pothuajse nuk i kujton fare ato. Ja pra, ata që hyjnë në rrugën e lartësimit shpirtëror mund të fitojnë të drejtën për të lexuar Kuran në vend të dhikrit pasi të jenë pastruar nga shirku dhe zotat e rremë. Këtej e tutje lartësimin shpirtëror mund ta realizojnë me këndimin e Kuranit.” (Mektubat, vëll. III, 4.)

Sipas Imamit, nëse në zemër gjenden aktive dëshirat vetjake dhe idhujt, para së gjithash duhet të hiqen këto, sepse fjala e Allahut nuk zë vend në zemrat e papastra dhe njerëzve dashakeqës u shton vetëm devijim. Njerëzit e tillë përpigën t’i komentojnë sipas qejfeve të tyre dispozitat e Kuranit. Si shembull për këtë është ky paralajmërim që Imam Rabbani ua bën mistikëve që e përdorin kamatën: “I nderuar! Të qenët haram të kamatës është vërtetuar me Kuran si për atë që ka nevojë, si për atë që nuk ka nevojë. Nxjerrja jashtë kësaj dispozite e njerëzve në nevojë absolutisht do të thotë shfuqizim i rregullit të Kuranit.” (Letra e 112-të)

Kurani është një burim udhëzimi i përhershëm. Themeli i edukimit shpirtëror është Kurani dhe Suneti. Xhunejd Bagdadi i cili ishte prej të parëve të misticizmit Islam, e shpreh këtë gjendje siç vijon: “Një njeri që nuk e mëson Kuranin përmendësh dhe nuk shkruan hadithe nuk mund të merret si shembull në këtë rrugë, sepse dija është e rrethuar me Kuranin dhe Sunetin.” (Kushejri, 107) “Dija është e vërtetuar me hadithet e të Dërguarit të Allahut.” “Përveç rrugës së ndjekjes së të Dërguarit të Allahut hap pas hapi, të gjitha rrugët e tjera që të shpien te Allahu janë të mbyllura për njerëzit.” (Kushejri, 107)

Në përgjithësi mistikët i kanë mbajtur me besnikëri këto parime të Xhunejd Bagdadit.

Si mund të quhet misticizëm Islam ai që i shfuqizon dispozitat islame?



Krahas kësaj, disa grupe kohëve të fundit po përpiqen ta përbalnin dijen e Kuranit me mendimet e devijuara që i kanë marrë nga fetë dhe filozofitë e huaja. Imami e kundërshton kështu këtë gjendje: “A nuk i shikon filozofët grekë, brahmanët e Indisë dhe jogistët (murgjit që bëjnë joga)? Pehrizi u ka dhënë atyre hare të egos. Andaj edhe ata kanë pandehur se kjo është diçka dhe e kanë pëlqyer veten. Madje Platoni budalla i besoi shumë nefsit dhe nuk iu nënshtrua Isasë i cili ishte peygamber në kohën e tij. Njerëzit e tillë thanë: “Ne jemi njerëz që e kemi gjetur rrugën e drejtë. Andaj nuk kemi nevojë për një prijës që të na shpie në rrugën e drejtë.” (Letra e 313-të)

Siç shprehet edhe Imami, disa grupe mistike mashtrohen nga dija shpirtërore që arrijnë dhe si rrjedhojë e neglizhojnë sheriatin i cili përbëhet nga dispozitat e Kuranit. Në një aspekt shkojnë pas rrjedhës së historianëve. Këto grupe që i hedhin mënjatë dispozitat e fesë dhe e shfaqin këtë të fundit sikur të përbëhej nga semaja, ritualet muzikore dhe një filozofi spirituale, mendojnë se dispozitat e Kuranit janë obligim vetëm për njerëzit e thjeshtë dhe besojnë se të ndriturit si vetë ata nuk janë të kufizuar me asnjë rregull fetar. Ky lloj komentimi i misticizmit për fat të keq përgjatë ditëve të sotme është shndërruar në një stil jete i cili sugjerohet jashtëzakonisht shumë. Kjo ndodh për arsye se, njerëzit që jetojnë me filozofinë kapitaliste i konsiderojnë rregullat e fesë në kundërshtim me interesat e tyre për sa i përket marrëdhënies me shoqërinë dhe paratë. Kur gjendja bëhet e tillë, atëherë kënaqësia shpirtërore në kontekstin e religjionit që nuk ka rregulla, por ka vetëm dashuri, sevda, muzikë dhe sema, përputhet plotësisht me epshet e këtyre nefseve. Në botëkuptimin e këtij misticizmi gradualisht normalizohen alkooli, imoraliteti dhe kamata apo një pjesë e tyre që e ka ndaluar feja. Sipas këtyre misticizëm do të thotë kënaqësi shpirtërore që njeriu i përjeton me zemër dhe jo në botën e jashtme. Imam Rabbani e mohon me këto fjalë botëkuptimin e një tasavufi / misticizmi të tillë dhe të devijuar: “Praktikat e mistikëve nuk mund të jenë argument në lidhje me të qenët haram apo hallall të ndonjë gjëje... Në këtë fushë janë të vlefshme fjalët e Imam Ebu Hanifesë, Imam Ebu Jusufit dhe Imam Muhamedit. Jo fjalët e mistikëve të njohur si Shibli dhe Ebu Husejn Nuri. Allahu Teala i mëshiroftë të gjithë! Disa mistikë të mangët të ditëve të sotme e kanë shndërruar semanë dhe kërcimin në fe në sheriat të tyre. Ata i kanë pranuar si argumente praktikat e shehlerëve të tyre në këtë çështje dhe i kanë konsideruar këto

punë si ibadet ndaj Zotit. Allahu thotë në Kuran: **“...Ata janë njerëz që e kanë bërë fenë e tyre lojë dhe argëtim...”** (En’am, 70)

Si përfundim, edhe mistikët, edhe myslimanët duhet të qëndrojnë larg çdo lloj mendimi apo praktike që e vë në dyshim Kuranin. Kurani Fisnik dhe dispozitat e tij gjithmonë janë të zbatueshme dhe gjithmonë posedojnë një dinamikë aktive. Atyre që mbrojnë të kundërtën e kësaj dhe që hedhin dyshime ndaj Kuranit duhet t’u jepet përgjigjja e duhur dhe duhet të luftohet me mendimet e tyre. Ne duhet të formojmë institucione të veçanta për ta bërë këtë dhe studiuesit duhet t’i mbështesim. Allahu Teala na ruajt të gjithëve prej çdo lloj mendimi dhe praktike të gabuar. Gjithashtu na e mundësoftë të gjithëve që t’i kuptojmë mrekullitë e Tij të cilat i kalojnë shekujt! Amin!

Kur filozofi (tenton) të sfidojë Kuranin...

Mevlana e përmbledh në një formë të mrekullueshme në bejtet e mëposhtme qëndrimin kundrejt Kuranit të tipave që e lënë mënjatë udhëzimin e Kuranit dhe Pejgamberit dhe i besojnë vetëm mendjes së tyre duke e bërë idhull atë:

“Dikush që po lexonte Kuran, po këndonte ajetin: “Nëse uji humb thellë dhe nuk rrjedh, kush mund t’ua sjellë ujin e ëmbël?”

Allahu i Lartësuar thoshte: “Ujin mund ta fsheh në thellësitë e tokës, mund t’i thaj burimet dhe vendin mund të shkretoj.

Kush mund ta kthej ujin përsëri te burimi përveç Allahut i cili është Bujari dhe Ndëshkuesi i madh?”

Një filozof i zakonshëm në ato momente po kalonte pranë mejtepit. Kur e dëgjoi këtë ajet, nuk i pëlqeu dhe tha: “Edhe ne e hapim tokën me kazmë dhe e nxjerrim ujin.” Natën ra për të fjetur. Në ëndërr pa një trim si luan. Ai trimi i gjuajti me shuplakë filozofit dhe ia verboi të dy sytë.

Atij filozofit i tha: “O njeri që nuk mendon! Nëse e mban fjalën, nxirr me kazmë nga sytë e ty dritë (që të shohësh përsëri).”

Erdhi mëngjesi. Ai u hodh nga shtrati dhe u ngrit. Të dy sytë i ishin verbuar me të vërtetë. Drita e shikimit i ishte larguar nga sytë e tij.

Po të qante dhe të pendohej, drita e syve që i kishte ikur mund t’i vinte përsëri me mirësinë e Allahut. (Mesnevi, II, 1633-42.)

Mus'hafi është historik, JO KURANI!

— Senai Demirxhi —

Në shumicën e rasteve fjalët “Kuran” dhe “Mus’haf” i ngatërrojmë dhe i përdorim në vend të njëra-tjetrës. Jo, fjalët “Kuran” dhe Mus’haf” nuk janë sinonime. Çdo Kuran është një Mus’haf, por çdo Mus’haf nuk është Kuran.

Mus’hafi është një objekt. Ndërsa Kurani është një fenomen, është titulli i një komunikimi të veçantë, është lëvizjet befasuese të një veprimi të drejtpërdrejtë. Mus’haf është emri i një “gjëje” që shkruhet me dorë, apo që shtypet në shtypshkronjë dhe që në shumicën e rasteve përbëhet nga letra. Mus’hafi vjen nga dheu, ndërsa Kurani ka zbritur nga qiejt. Mus’hafi shitet dhe blihet. Mus’hafi mund të vjetërsohet dhe dëmtohet. Siç ka mus’hafë të rinj, ka edhe të vjetër. Mus’hafi edhe mund të digjet. Madje është e vërtetë se është djegur me mirësjellje, në mënyrë që ajetet e shkruara të mos mbeten nën këmbë. Ai ka edhe një “çmim” që të moçmit ia kanë pas vendosur me edukatë për ta bërë “dhuratë”.

Asnjëra prej këtyre fjalive që u përdorën për Mus’hafin, nuk mund të përdoren për Kurani. Kurani nuk është diçka që shitet dhe blihet. Kurani nuk vjetërohet dhe nuk digjet. Kurani nuk mund t’i vendoset një çmim.

Kuran është emri i interaktivitetit (bashkëveprimit) vullnetar i Mus’hafit me njeriun. Le ta shpjegojmë kështu: Asaj “gjësë” që e vendosim mbi gjunjë, që e mbartim në çantë, që është e veshur me plastikë, e zbukuruar me metal dhe që ka shumë kabuj, i themi “kompjuter”. Mirë, por ne e dimë se ajo gjë për ta fituar emrin “kompjuter” duhet që ta ketë prekur dora e njeriut, të ketë ndikuar mendja dhe t’ia ketë futur programet në punë. “Kompjuter” nuk është emri i një objekti, por është emri i një fenomeni në të cilin bashkëvepron inteligjenca e ngarkuar brenda një objekti me inteligjencën e njeriut. Ajo që e bën objektin “kompjuter” është e lidhur me trajtimin si kompjuter që njeriu i bën atij.

Pikërisht kështu, kur një “Mus’haf” bëhet objekt leximi për një njeri, emrin e ka “Kuran”. Kuran do të thotë “i lexueshëm”. Ai që nuk ka “lexues”, sigurisht që nuk mund të jetë “i lexueshëm”. Mus’hafi që nuk lexohet, mbetet si Mus’haf për atë që nuk e lexon, por bëhet “Kuran” për atë që e lexon.

Ndërsa qëllimi i leximit padyshim se është të kuptuarit. Asnjë njeri nuk e lexon një shkrim për të mos e kuptuar. Po ashtu nuk e lexon duke thënë: “S’ka gjë edhe nëse nuk e kuptoj.” Pastaj një shkrim që nuk ia vlen për t’u kuptuar, nuk lexohet që në fillim.

Ndërsa “Kurani që kuptohet” tashmë është një ‘libër i qartë’. Libri i qartë fillon veprimin aktiv. E ndan të vërtetën nga e pavërteta, e shton largësinë ndërmjet mirësisë e ligësisë, e zgjidh rrëmujën dhe e bën të qartë situatën e turbullt. Kështu që bëhet “Furkan” që e ndan të bukurën nga e shëmtuara. Kurani që është Bejan (libër i qartë) fillon një operacion në trurin e njeriut. Ai injekton fjalë dhe vendos koncepte në zemër. Lë gjurmë, hap rrugë të reja dhe shfaq horizonte të ndritura.

Po ashtu, siç e dimë të gjithë, krejt



kuptimet janë për të jetuar. Kuptimi që shpreh një tabelë trafikë, propozon një stil jete siç është mos hyrja në atë rrugë nëse thotë se “është e ndaluar”. Nëse mund të kalojmë nga Kurani që lexohet te Kurani që praktikohet, tashmë do të ishte me vend që Kurani të quhet “njeri”. Këtej e tutje, bashkëveprimi që fillon me Mus’hafin është takimi i dy njerëzve. Ky bashkëveprim përgatitet për të lindur të gjitha surprizat që priten nga dy njerëz që bashkohen.

Pejgamberi (a.s.), është njeriu i parë që ka nxjerrë kuptim nga leximi i Mus’hafit dhe që ka ndërtuar jetën sipas atij kuptimi që ka nxjerrë. Siç shprehet nëna jonë, Aishja: “Ai ishte një Kuran i gjallë.” Bazuar në këtë, prej të gjithë atyre që ecin në rrugën e Resulullahut (a.s.), pritët që të nxjerrin jetë nga Mus’hafi dhe të udhëtojnë drejt të qenët njeri i Kuranit.

Për ta përmbledhur, njeriu i cili i drejtohet me tri veprime të veçanta Mus’hafit i cili është objekt, si leximi, kuptimi dhe zbatimi, e konsideron Mus’hafin si një subjekt aktiv. Kështu, shprehja: “Kurani dhe njeriu janë dy vëllezër.”, realizohet me një thënie të re. Sa më shumë që njeriu ta lexojë, ta kuptojë dhe ta zbatojë Kuranin, aq më shumë fillon të njihet me binjakun e vet. Ai edhe mahnitët, edhe gëzohet. Fytyrën e vet fillon ta shikojë në një pasqyrë të bukur. Ai që njihet me binjakun e vet duke kënduar Kuran, e kupton atë që duhet të kuptohet, e vë re atë që duhet të aprovohet dhe e shikon se i është dhënë përparësi ekzistencës së tij në këtë rruzull tokësor. Kështu që e ndjen se është kapluar i tëri nga një subjekt.

Ata që e komentojnë Kuranin si “historik”, e trajtojnë revelatën hyjnore si një “tekst i vdekur”. Ndërsa teksti që trajtohet si i vdekur, sillet me “pandehje” ndaj atij që e trajton si të tillë. Kështu që mbetet i privuar nga një marrëdhënie produktive, nga një takim i begatë dhe nga një gjallëri që jep fryte të reja. Shkaku i këtij privimi nuk është Kurani, por ai që e përkufizon Kuranin në mënyrë të gabuar dhe të mangët. Një njeri që nuk e trajton kompjuterin si kompjuter, e humb kompjuterin. Ai që humb në këtë mes nuk është kompjuteri, por njeriu.

Kur ajeti i parë i Kuranit thotë: “Lexo me emrin e Zotit Tënd që krijon!”, dëshiron të shprehet se “Zoti i Cili flet” është “i njëjti Zot” me “Zotin që vazhdimisht krijon”. “Metoda e krijimit” dhe “metoda e të folurit” të kujtojnë njëra-tjetrën. Ndërsa të folurit e Zotit është aktual pikërisht si edhe krijimi i Tij. Çdo moment rinovohet, çdo herë fillon e re dhe gjithmonë është e freskët. Çdo gjë që krijohet, i bën jehonë shpalosjes së revelatës hyjnore. Ata që nuk gjejnë guximin për t’i thënë historik atij që krijohet, nuk mund t’i thonë historik as atij që “flet”.

Atëherë le ta provojmë për ta lexuar Kuranin prej

atyre që janë të krijuar. Së pari le të fillojmë me pemët që krijohen. Pemët janë argumente ekzistenciale. Argumentet e bëjnë ekzistencën që të flasë. Gjuha e pemës përzihet me gjuhën e argumentit dhe jehojnë te njëra-tjetra. Edhe pse pema është e vjetër me rrënjët, trupin dhe degët, çdo verë jep fruta “të reja”, çdo pranverë çel lule dhe mbart freski në majat e degëve. Fjalët e ajeteve duken të qëndrueshme dhe të vjetra si trangu i pemës, por nëse pritët koha e duhur, ato japin fruta të freskëta, falin kuptime të reja, nxjerrin filiza të reja dhe degëzohen. Pema nuk do të thotë se është e paimformuar për qiellin ngaqë rrënjët i ka në tokë. Ajo nuk do të thotë se është e pa interesuar për diellin, për erën dhe për njerëzit. Ajo është e re çdo moment, reagon për çdo moment dhe është e re në çdo moment të ekzistencës së saj.

Le të lagemi pak edhe në shi.

Shiu është një fenomen që ndodh që prej miliona vitesh. Ai është shumë i lashtë, por çdo herë që bie është i ri. Shiu që bie prej qindra vitesh, kurdo që të bie, është i freskët. Shiu është prej qiellit, por çdo pikë e tij zgjon farërat në tokë. Ato mbartin përgëzimin e jetës për rrënjët e pemëve. Shiu bie për të gjithë, por prapë se prapë është i veçantë për të gjithë. Ai i lag të gjithë dhe u flet në forma të ndryshme. Gjithmonë bie, por çdo prekje e tij lind rezultate të befasishme. Çdo rënie e tij është një poezi e papërshkrueshme. Ai bie nga lart, por nuk i lëndon ata që janë poshtë. Nuk i thyen gjërat mbi të cilat bie. Zbret prej lartësive, por të gjithëve u shpërndahet në formë të barabartë. Ai nuk bën ndasi ndërmjet njerëzve.

Gjithashtu le t’i bashkohemi edhe rrymës së një lumi që rrjedh pa reshtur.

Ajetet janë si lumi. Ato mbartin kuptime rrjedhëse. Ndërsa zemra e njeriut është shtrati i kësaj rrjedhe. Sa më shumë që t’i japim leje rrjedhjes së ajeteve në zemrën tonë, aq më shumë i kuptojmë baticat-zbaticat e ndjenjave tona dhe dëgjojmë zëra të rinj, të freskët dhe befasues nëpër pragje ku shpërthen (lulëzon) jeta jonë. Rrjedha e ajeteve e ushqen shtratin e natyrshmërisë sonë. Ndërsa shtrati i natyrshmërisë sonë dëshmon rrjedhën e ajeteve. Lumi vetë është i lashtë, por rrjedha nuk i vjetërsohet asnjëherë. Shtrati i lumit shpesh herë mbetet i njëjtë në hartë. Edhe nëse kalojnë me qindra vite, vija e lumit nuk ndryshon aspak. Por rrjedha e lumit gjithmonë është e re, gjithmonë është e freskët. Ajo është e re në çdo pikë, në çdo stinë dhe në çdo moment. Ai që e dëgjon mjaftueshëm zërin e kësaj rrjedhe dhe që e sheh sesi e reflekton hënën e diellit, zbulon bukuri të reja.



DISA GABIME QË BËHEN NË KOMENTIMIN E KURANIT

— Dr. Murat Kaja —

Kurani Fisnik është libri i fundit që Allahu Teala e ka dërguar për të udhëzuar robërit e Tij. Për këtë arsye, ai e plotëson nevojën e të gjithë njerëzve që do të vijnë deri në kiamet. Andaj në çdo periudhë atij i bëhet tefsiri (komentimi) dhe jepen përpjekje për t'i konceptuar kuptimet që përfshin ai. Por vihet re se njerëzit bëjnë disa gabime kur e komentojnë atë. Më kryesoret prej tyre janë këto:

PARAGJYKIMI DHE FANATIZMI NDAJ MEDHHEBIT DHE FRAKSIONIT

Gabimi që bëhet më së shumti kur komentohej Kurani është qasja ndaj çështjes me paragjykime dhe me gjykime të prera. Ky qëndrim në shumicën e rasteve sjell të vepruarit në mënyrë subjektive. Komentimet e atyre që u përkasin fraksioneve veçanërisht politike, besimore dhe ideologjike, shpesh herë dominohen nga anshmëria. Në këto lloje komentimesh që bëhen pa u mbështetur te ndonjë transmetim dhe me mendime personale, njeriu në fillim i beson një kuptimi dhe më vonë përpiket që këtë kuptim t'ua përshtatë fjalëve të Kuranit.¹ Për këtë çështje ka shumë shembuj. Le të japim dy shembuj:

1. Muhammed Husejn Dhehebi, el-Ittixhahatu'l-munharife fi tefsiri'l-Kur'ani'l-Kerim -Devafiuha ve def'uha- (Mektebetu Vehbe, 1406/1986), 20.

a. Ibn Omeri (r.a.), i konsideronte havarixhët si njerëzit më të këqij dhe shkakun për këtë e shpjegonte kështu: "Ata i praktikojnë te besimtarët ajetet që kanë zbritur për qafirët."² Havarixhët këtë e bënin për shkak të fanatizmit ndaj medhhebit të tyre. Nuk është e drejtë që të praktikohen ndaj besimtarëve ajetet që flasin për qafirët, por besimtarët duhet të marrin mësim prej atyre ajeteve dhe sipas kësaj duhet ta rregullojnë gjendjen e tyre.

b. Orientimi i njerëzve duke përdorur dijetarët dhe shkencat islame për interesa politike dhe të mbledhurit e simpatizantëve për të arritur fuqi ka qenë njëra prej taktikave më të rrezikshme përgjatë gjithë historisë prej së cilës myslimanët janë dëmtuar.

MOSZBATIMI I KUSHTEVE TË TEFSIRIT

Bazat dhe rregullat e një shkence janë si themeli për një ndërtesë. Ndërtesa mund të qëndrojë në këmbë vetëm mbi baza të forta.³ Edhe shkenca e tefsirit ka disa rregulla dhe baza të saj. Disa njerëz që i shohin të panevojshme kushtet e caktuara për tefsirin, i kanë komentuar fjalët e Kuranit me

2. Buhari, Istiabe, 6; Ibn Haxher el-Askalani, Tagliku't-ta'lik ala Sahihi'l-Buhari, korrektio Said Abdurrahman Musa (Bejrut, el-Mektebetu'l-Islami, 1405), 5: 259.

3. Mahmud Muhammed Jakub Tahir, Esbahu'l-hata' fi't-Tefsir (Daru Ibn'l-Xhevi, 1425), 85.

kuptime të papërshtatshme duke bërë tefsir sipas akumulimit të dijes dhe kulturës që kanë vetë.

Këto lloje komentimesh të bëra pa i marrë në konsideratë metodën dhe rregullat e tefsirit dhe shkencat e Kuranit, por vetëm duke u bazuar në gjuhën arabe, tregojnë qartazi që nuk është marrë aspak parasysh se fjala e kujt është Kurani, se kujt i ka zbritur dhe se kujt i drejtohet.

Edhe mungesa e dijes rreth çështjes së Ulumu'l-Kur'an – Shkencave të Kuranit sjell mosrespektim të kushteve të tefsirit dhe te'vilit (komentimit). Kjo mangësi në fund sjell gabime në komentim dhe kontradikta. Ky transmetim e shpreh qartë këtë: Omeri (r.a.), një ditë ishte vetëm. Vetvetiu filloi të mendonte: “Si mund të bie në kontradiktë ky umet ndërkohë që ka një të Dërguar?” Andaj i thirri Ibn Abbasit (r.a.) dhe e pyeti:

“Si do të bie në kontradiktë ky umet ndërkohë që ka të njëjtin pejgamber dhe të njëjtën kible?” Ibn Abbasi (r.a.), iu përgjigj:

“O prijësi i besimtarëve! Kurani na është zbritur neve dhe ne e kemi lexuar atë. Ne e dimë se për çfarë ka zbritur. Njerëzit pas nesh do të vijnë dhe do ta lexojnë Kuranin, por nuk do ta dinë se për çfarë ka zbritur. Për këtë arsye, do të japin mendimet e tyre në lidhje me të. Kur secili prej tyre të ketë mendimet e veta rreth Kuranit, do të bien në kontradikta. Kur të bien në kontradikta, do të grinden dhe luftojnë me njëri-tjetrin.” Omeri (r.a.), nuk e pëlqeu këtë përgjigje dhe e qortoi atë. Ndërsa Ibn Abbasi (r.a.), u largua prej aty. Pasi Omeri, radijall-llahu anih, mendoi pak rreth përgjigjes së tij, e kuptoi qartë se çfarë kishte dashur të thoshte ai. Menjëherë i thirri Ibn Abbasit dhe i tha: “Ma përsërit edhe një herë atë që më the më parë!” Edhe ai ia përsëriti atë që i kishte thënë më parë. Omeri (r.a.), e perceptoi kuptimin e fjalës së tij dhe i pëlqeu shumë ky shpjegim.⁴

Pika më e rëndësishme e përbashkët e njerëzve që përfshihen nga përkufizimi modernist është se ata i përjasen Kuranit në mënyrë historiciste dhe simbolike. Ata e kanë konsideruar Kuranin Fisnik si një tekst që e kanë nxjerrë në pah ndikimet eko-

nomike, sociale dhe politike dhe kanë pohuar se ai i përket një kohe dhe mjedisi të caktuar. Kur të studiohen librat e modernistëve dhe historicistëve, kuptohet krejt qartë se synojnë t'u zbrazin pjesën e brendshme ajeteve që përmbajnë lajme të gajbit me shpjegime mjaft relative që bazohen te lojërat e gjuhës dhe shpjegime simbolike e metaforike që mbështeten te pandehjet dhe që janë totalisht arbitrare. Ndërkohë në gjuhë si bazë merret kuptimi i vërtetë i fjalëve. Andaj nuk është e drejtë që kuptimi i vërtetë të braktiset pa argument. Në Mexhel-le thuhet: “Baza në gjuhë është kuptimi i vërtetë.”⁵ Kuptimi i vërtetë është bazë, ndërsa kuptimi figurativ është zëvendës i saj. Andaj nuk merret parasysh kuptimi figurativ ndërkohë që kemi kuptimin e vërtetë. Por nëse është i pamundur kuptimi i vërtetë nga fjala, atëherë shihet kuptimi figurativ, sepse të shprehurit e një kuptimi nga fjala është më mirë se të jetë pa asnjë kuptim. Muhamed Zahid el-Kevseri (v. 1952) thotë:

“Ndërmjet dijetarëve të vërtetë nuk gjendet asnjë që i komenton tekstet hyjnore përderisa të mos jetë i pamundur për t'u kuptuar kuptimi i tyre i vërtetë. Për këtë arsye, nëpër veprat e dijetarëve të vërtetë do të shohësh se kjo çështje shpjegohet në këtë formë: “Teksteve (hyjnore apo profetike) u jepet kuptimi i tyre i vërtetë. Braktisja e kuptimeve të vërteta të teksteve hyjnore dhe ngarkimi i tyre me kuptime që pretendojnë batinitë është mohim i Zotit. Refuzimi i teksteve hyjnore është kufër.””⁶ Sepse, siç është shprehur edhe Buti (v. 2013), po të

ishte e lejuar që çdo studiues dhe lexues ta nxirrte fjalën nga kuptimi i vërtetë i saj, t'i jepte kuptime të ndryshme figurative dhe të zgjidhte njërin prej tyre, gjuha do të paralizohej, fjalët do t'i humbnin kuptimet dhe njerëzit nuk do ta dinin dot çfarë të kuptonin. Si rrjedhojë, do të shastiseshin.⁷

PSIKOLOGJIA E MBROJTJES


Kundërshtimet dhe akuzat që orientalistët ia kanë

5. Mexhel-le, neni I 12-të.

6. Muhammed Zahid el-Kevseri, Nadhratun abira fi mezaimi men junkiru nuzule Isa (a.s) kable'l-ahira (Kajro: Daru'l-Xhil, 1408/1987), 124. Krahasoni Byjykk Hajdar Efendi, Mësimet e Usul-i Fikh, përgatiti Ibrahim Subashi, 211.

7. shik. Muhammed Said Ramadan el-Buti, Fikhu's-Sire (Damask: Daru'l-Fikr, 2007), 47.

4. Ebu Ubejd Kasim b. Sel-lam, Fedailu'l-Kur'an, korrektoi Mervan el-Atijje dhe të tjerë. (Damask, Daru Ibn Kethir, 1415/1995), 102-103.



adresuar Islamit, i ka futur disa mufesirë (komentues të Kuranit) në psikologjinë e mbrojtjes. Kjo i ka çuar ata në interpretim të gabuar të ajeteve fisnike. Për shembull, Abduh-Rizai është shprehur se të gjitha luftërat që ka bërë i Dërguari i Allahut (a.s.), kanë qenë luftëra mbrojtjeje. Sipas atyre lufta në Islam është e kufizuar vetëm me ata që luftojnë me myslimanët dhe që u kërcënojnë lirinë fetare. Përveç këtyre askujt tjetër nuk mund t'i hapet luftë.⁸ Ata që bëjnë tefsir në këtë mënyrë, duket se pohojnë kështu, pra pohojnë se Islami i ka dhënë leje vetëm luftës për mbrojtje, si një reagim ndaj atyre që dëshirojnë ta shfaqin Islamit si religion armiqësor dhe barbar.

PËRPPJEKJA PËR RACIONALIZIM

Një botëkuptim që është përhapur shumë përgjatë ditëve të sotme dhe që përpiket ta shpjegojë çdo gjë në mënyrë racionale e shkencore, kohë pas kohe ka ndikuar edhe te interpretuesit e Kuranit. Kështu Abduh-Rizai edhe pse e pranon mrekullinë si parim, ka pohuar se periudha e mrekullive emocionale ka marrë fund me largimin nga kjo botë e Pejgamberit (a.s.). Ai është përpjekur t'i racionalizojë shumë mrekulli që gjenden në Kuran dhe t'i shpjegojë brenda kornizës së shkaqeve të natyrshme.⁹ Mustafa Islamogllu për xhindët¹⁰ që punonin nën urdhrin e Sulejmanit (a.s.), është shprehur: "Këtu duhet të synohen njerëz "shumë të aftë si xhindë" apo "të zgjuar si xhindë" që punonin nën urdhrin e Sulejmanit (a.s.)."¹¹ Edhe kjo nuk është gjë tjetër përveçse një përpjekje për t'i racionalizuar qeniet e padukshme.

DËSHIRA PËR TË NXJERRË NË PAH NJË MENDIM ORIGINJAL

Edhe dëshira për të arritur famën duke thënë gjëra që nuk i ka thënë askush, që u duken njerëzve të ndryshme e tërheqëse dhe duke tërhequr vëmendjen e tyre në këtë mënyrë, shumë njerëz i ka bërë të gabojnë përgjatë interpretimit të Kuranit. Për shembull, Bajraktar Bajrakllë në parathënien e tefsirit të tij shprehet: "Kemi dhënë përpjekje për të bërë interpretim duke mos i përsëritur ato që janë thënë dhe duke mos i imituar ato që janë bërë deri në këtë kohë. Sepse të prodhuarit e gjërave origjinale

është dashuria dhe pasioni ynë në interpretimin e Kuranit."¹²

Kur të themi diçka që nuk e ka thënë askush, duhet të jemi shumë të kujdesshëm, sepse mundësia për të gabuar është shumë e madhe. Andaj është thënë: "Të kundërshtuarit e shumicës vjen nga gabimi i madh." Imam Zuferi (v. 158/775) ka thënë: "Kur debatoj me dikë, debatoj jo derisa të heshtë, por derisa ta humbë mendjen dhe të acarohet." Kur është pyetur: "Si acarohet personi me të cilin debaton?" Ai është përgjigjur: "Them diçka që nuk e ka thënë askush!"¹³

DËSHIRA PËR TË ZGJUAR DYSHIME RRETH KURANIT DHE ISLAMIT

Disa njerëz që dëshirojnë të zgjojnë dyshime rreth Kuranit Fisnik dhe Islamit në mendjen e njerëzve, kanë bërë interpretime të gabuara me qëllim dashakeqës. Me këtë kanë synuar t'u shërbejnë jomyslimanëve dhe t'i ftohin njerëzit nga Islami dhe Kurani. Kështu disa persona të kësaj kohe ajetin: "*Ne shënuam në Zebur, pas Teuratit, që tokën (e Xhenetit) do ta trashëgojnë robërit e Mi të mirë.*"¹⁴, e kanë komentuar në formën: "Rruzullin tokësor do ta zhvillojnë vetëm njerëzit e përshtatshëm për zhvillim pavarësisht se nga cila fe vijnë apo cilit medhheb i përkasin."¹⁵ Sipas Abdullah el-Gumarit (v. 1993) qëllimi i tyre nga ky interpretim është mbështetja e kolonializmit perëndimor dhe thyerja e rezistencës kundrejt perëndimorëve duke thënë se "Kurani na lajmëron se ata do ta trashëgojnë këtë botë".¹⁶ Ndërkohë fjala "ard" që është përmendur në ajet është komentuar si "xheneti" apo si "tokat që Allahu ua ka premtuar besimtarëve" dhe që umeti i Muhamedit do t'i çlirojë nga qafirët.¹⁷

Si përfundim, interpretimi i disa ajeteve të Kuranit Fisnik sipas kohës është i pashmangshëm ngaqë Kurani Fisnik u drejtohet të gjithë njerëzve që do të vijnë derisa të ndodhë kiameti. Andaj kur të bëjmë ndonjë interpretim të ajeteve, duhet që nevojat e kohës t'i bashkojmë në një pikë me metodën dhe rregullat e shkencës së tefsirit, në mënyrë që të mos biem në gabim.

12. Bajrakllë, Yeni Bir Anlayışın İsıgında Kur'an Tefsiri - Tefsiri i Kuranit nën dritën e një botëkuptimi të ri, 1: 63.

13. Kevseri, Nadhratun abira, 92.

14. Enbija, 105.

15. Ahmed b. Mustafa el-Meragi, Tefsiru'l-Meragi (Egjypt: Mektebetu Mustafa el-Babi, 1365/1946), 27: 76; Ibrahim ibn Ismail el-Ebjari, el-Mevsuatu'l-Kur'anije (Muessesetu Sixhil-li'l-Arab, 1405), 10: 338.

16. Ebu'l-Fadl Abdullah ibn Muhammed ibn es-Siddik el-Gumari, Bide'u't-tefasir (ed-Daru'l-Bejda, Daru'r-Reshadi'l-Hadithe, 1406/1986), 93.

17. Taberi, 18: 549-550.

8. Xhelil Kiraz, Menâr Tefsirinde Özgün Yorumlar - Komentime origjinale në Tefsirin Menar (Bursa: Botimet Emin, 2017), 274-281.

9. Për shembujt shik. Kiraz, Menâr Tefsirinde Özgün Yorumlar Komentime origjinale në Tefsirin Menar, 148-178.

10. Shik. Sebe' 34/12.

11. Mustafa Islamogllu, Hayat Kitabı Kur'an -Gerekçeli Meal-Tefsiri (Stamboll: Botimet Dyshyn, 2009), 848, 11.



Universalizmi i Islamit

dhe çështja e aktualizimit

— Mustafa Karabaxhak —

Prej universalizmit të Islamit kuptohet cilësia e tij që u flet të gjithë shekujve dhe i plotëson nevojat e kohës. Me të vërtetë, a është Islami një fe që u flet të gjitha periudhave dhe që i plotëson nevojat e kohës? “Po”, këtë mund ta themi lehtësisht. Para së gjithash, poseduesi i kësaj feje është poseduesi i botëve, domethënë edhe i kësaj bote, edhe i ditës së fesë (botës tjetër). Në suren e parë të Kuranit që e këndojmë përgjatë çdo namazi, pra në suren Fatiha, Zoti (xh.xh.), shprehet: ***“Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit! Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit, Sunduesit të Ditës së Gjykimit. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë. Udhëzoni në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur!”*** (Fatiha, 1-7)

Zoti i botëve i Cili është Zoti ynë, ia ka vendosur vetë emrin fesë së fundit që ka dërguar dhe na ka njoftuar se vetëm prej saj do të jetë i kënaqur duke u shprehur: ***“Feja e vërtetë te Allahu është Islami.”*** (Al Imran, 19) ***“Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur.”*** (Al Imran, 85)

UNIVERSALIZMI I KURANIT FISNIK I CILI ËSHTË LIBRI I ISLAMIT

Zoti i Lartësuar na njofton se Librin (Kuranin Fisnik) e ka dërguar si udhërrëfyes dhe udhëzues për të gjithë njerëzit: ***“...Kurani është zbritur si udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja)...”*** (Bekare, 185) ***“...Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje, si udhërrëfyes, si mëshirë dhe si lajm të mirë***

për myslimanët.” (Nahl, 89)

Në librin e lartë të Islamit, Kuranin Fisnik ka tri lloje thirrjesh. E para është thirrja që fillon në formën: “O njerëz!” Kjo thirrje u drejtohet të gjithë njerëzve qofshin burra apo qofshin gra. Në këto ajete Allahu Teala i fton njerëzit për t’i besuar njësimi të Tij dhe atyre që ka sjellë pejgamberi i fundit. Kuptimi i disa ajeteve të këtij lloji është si më poshtë: **“O njerëz! Adhuroni Zotin Tuaj, i Cili ju ka krijuar ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të ruheni** (ta shpëtoni veten nga ndëshkimi i Allahut).” (Bekare, 21) **“O njerëz, ju ka ardhur këshillë (Kurani) nga Zoti juaj, shërim për zemrat tuaja, udhëzim dhe mëshirë për besimtarët.”** (Junus, 57)

Lloji i dytë është thirrja që fillon në formën: “O ju që keni besuar!” Këto lloje ajetesh flasin rreth përgjegjësisë që duhet t’i kryejnë njerëzit

jush: se do të adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t’i shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim) **dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut!..”** (Al Imran, 64) **“O ithtarë të Librit! Përse i mohoni shpalljet e Allahut** (Kuranin), **edhe pse jeni dëshmitarë se ato janë të vërteta?”** (Al Imran, 70) Këto thirrje nuk janë për një popull të caktuar apo për një shoqëri të caktuar. Përderisa të vazhdojë jeta në këtë rruzull tokësor, është e pamundur të gjendet një grup tjetër përveç këtyre tri grupe njerëzish. Kështu që thirrja hyjnore u drejtohet njerëzve në tri mënyrë të cilat janë: Thirrja e përgjithshme, thirrja për besimtarët dhe thirrja për jobesimtarët.

PEJGAMBERI I ISLAMIT

ËSHTË DËRGUAR SI MËSHIRË PËR BOTËT

Profecia ka filluar me Ademin (a.s.), i cili ishte njeriu i parë dhe pejgamberi i parë. Pastaj profe-

ISLAMI ËSHTË FEJA E FUNDIT DHE UNIVERSALE. TASHMË NUK DO TË VIJË MË NDONJË FE E RE PËR NJERËZIMIN. EDHE PARIMET E ISLAMIT JANË UNIVERSALE. AJETET DHE HADITHET QË NDRYSHE I QUAJMË NASS (TEKSTE HYJNORE E PROFETIKE), NUK NDRYSHOJNË.

që kanë besuar. Kuptimi i disa ajeteve të këtij lloji është siç vijon: **“O ju që keni besuar! Jepni pa u kursyer nga të mirat që ju kemi dhënë! Ne, para se të vijë Dita (e Gjykimit) në të cilën nuk ka shit-blerje, as miqësi, as ndërmjetësi! Jobesimtarët janë keqbërësit e vërtetë.”** (Bekare, 254) **“O ju që keni besuar! Mos zgjidhni për miq dhe këshilltarë të afërt njerëz të tjerë jashtë gjirit tuaj; ata nuk ngurrojnë që t’ju bëjnë dëm. Ata dëshirojnë që të vuani. Urrejtja shfaqet në gjithçka që del prej gojës së tyre, kurse ajo që fshehin në zemrën e tyre, është edhe më e madhe...”** (Al Imran, 118)

Lloji i tretë është thirrja që përbëhet nga ajetet të cilat u drejtohen atyre që nuk besojnë (çifutëve, të krishterëve, politeistëve dhe hipokritëve). Kuptimi i disa ajeteve të këtij lloji është siç vijon: **“Thuaj (o i Dërguar): “O ithtarë të Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe**

cia është mbyllur me Muhamedin (a.s.). Kurani Fisnik flet për emrat e disa popujve që u ishin dërguar pejgamberë. Kurani në përgjithësi nuk flet nëse ishin të mëdhenj apo të vegjël popujt që iu dërguan pejgamberë. Vetëm jepet informacion në lidhje me çështjen e madhësisë së popullit ku ishte dërguar Junusi (a.s.). (Shik. Saffat, 142-147) Edhe Musai dhe Isai, të cilët ishin prej pejgamberëve të mëdhenj, ishin dërguar te një popull i caktuar, domethënë te bijtë e Izraelit. (Al Imran, 45-49; veçanërisht shik. Saf, 6; Al Imran, 50; Maide, 46.)

Hallka e fundit e pejgamberëve që ka dërguar Allahu Teala është Muhamedi (a.s.). Në ajetin fisnik thuhet: **“Muhamedi nuk është babai i askujt prej burrave tuaj, por është i Dërguari i Allahut dhe vula e profetëve; Allahu është i Gjithë-dijshëm për çdo gjë.”** (Ahzab, 40) Pejgamberi i fundit, Muhamedi (a.s.), është dërguar

për të gjithë njerëzimin: “(O Pejgamber!) **Ne të kemi dërguar ty vetëm si mëshirë për botët.**” (Enbija, 107) “**Ne të kemi dërguar ty (o Muhamed) vetëm si sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues për të gjithë njerëzimin, por shumica e njerëzve nuk dinë.**” (Sebe, 28)

Zoti (xh.xh.), u drejtohet pejgamberëve dhe u kërkon që t’u thonë njerëzve se u janë dërguar si pejgamberë atyre: “**Thuaj (o Muhamed!): “O njerëz, unë jam për ju vetëm paralajmërues i qartë.”**” (Haxh, 49) “**Thuaj (o Muhamed): “O njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju, i Atij që i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës...”**” (A’raf, 158) “**O njerëz! Me të vërtetë, juve ju ka ardhur një provë bindëse (Muhamedi a.s.) nga Zoti juaj dhe ju është zbritur një Dritë e dukshme (Kurani).**” (Nisa, 174)

I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, në një hadith fisnik na njofton se ndërkohë që pejgamberët e tjera kanë qenë të dërguar te një popull i caktuar, ai vetë është dërguar për të gjithë njerëzimin: “Unë jam dërguar jo te një popull i vetëm, por te i gjithë njerëzimi. Profecia është mbyllur me mua dhe unë jam pejgamberi i fundit.” (Muslim, Mesaxhid, 5; Tirmidhi, Sijer, 5.)

ÇËSHTJA E AKTUALIZIMIT

Islami është feja e fundit dhe universale. Tashmë nuk do të vijë më ndonjë fe e re për njerëzimin. Edhe parimet e Islamit janë universale. Ajetet dhe hadithet që ndryshe i quajmë nass (tekste hyjnore e profetike), nuk ndryshojnë. Por me kalimin e kohës, tekstet mund të kenë nevojë për t’u komentuar siç edhe janë komentuar kundrejt disa problemeve të reja. Në kushtetutën osmane, Mexhel-le ky rregull është shprehur kështu: “Ndryshimi i dispozitave me ndryshimin e kohës është i pamohueshëm.” (Neni 39) Dome thënë, kur ndryshon koha, nuk mund të mohohet se duhet të ndryshojnë edhe dispozitat. Edhe shprehja: “Dera e ixhtihadit është mbyllur.”, për të cilën mendojmë se është thënë për një kohë të caktuar, është një ixhtihad. Siç duket, kjo fjalë mund të jetë thënë me pretekstin se myslimanët nuk kanë edukuar dot njerëz të aftë për ixhtihad në një kohë të caktuar. Mbi të gjitha, myslimanët kanë nevojë për muxhtehidë të cilët mund ta mbajnë fenë në këmbë gjithmonë dhe mund ta komentojnë atë. Kjo është një domosdoshmëri

fetare. Zoti (xh.xh.), thotë: “**Nuk është mirë që besimtarët të shkojnë në luftë të gjithë njëherësh, por prej çdo bashkësie, një grup të mbetet mbrapa, që të thellohet në mësimin e fesë dhe kështu të këshillojë popullin e vet, mbasi të kthehet nga lufta, që t’i frikësohet Allahut.**” (Teube, 122)

Ne i quajmë ixhtihad interpretimet që muxhtehidi i nxjerr nga ajetet dhe hadithet. Dera e ixhtihadit gjithmonë është e hapur për njerëzit specialistë të asaj fushe. Vetëm se këto interpretime mund të ndryshojnë sipas kohës dhe nuk bëhet fjalë që ato të kenë shenjtëri. Kur e themi këtë, sigurisht se temat e besimit bazë dhe të ibadetit janë jashtë kësaj. Nëse e shohim me kujdes, do të vëmë re se Kurani nuk ka hyrë në detaje, por ka dhënë vetëm dispozita të përgjithshme në çështjet e tjera të fesë siç janë muamelatet (shitblerja) dhe ukubatet (jurisprudenca). Andaj ka shumë pak tema në detajet e të cilave ka hyrë Kurani. Njëra prej këtyre temave është çështja e martesës, divorcit dhe trashëgimisë. Nëse parashtrohet pyetja se përse ka hyrë në detaje te këto tema, përgjigja mund të jepet e tillë: Së pari këto dy tema janë prej çështjeve që njerëzit dhe popujt i shfrytëzojnë dhe i keqpërdorin. Andaj një çështje kaq të rëndësishme Allahu Teala nuk na e ka lënë neve, por e ka shpjeguar pikërisht Vetë.

Universalizmi i Islamit është i fshehur në faktin që nuk hyn në detaje në ndonjë vend. Siç dihet, kushtetutat nuk hyjnë në detaje. Nëse një kushtetutë hyn në detaje, shpesh herë do të lindë nevoja për ta ndryshuar kur të mos u japë dot përgjigje problemeve të reja që dalin me ndryshimin e kohës. Por diçka e tillë nuk mund të bëhet fjalë për Kuranin Fisnik.

Si përfundim, Kurani i cili është libri bazë i Islamit dhe Suneti i të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili është shpjegimi i tij, kanë hyrë në detaje te çështjet themelore të besimit dhe ibadetit. Në fakt te këto çështje nuk bëhet ixhtihad, sepse tekstet janë të qarta. Këto dy burime, domethënë Kurani dhe Suneti, nuk ka hyrë në detaje te çështjet si jurisprudenca, shitblerja, administrimi, etj. Kështu që muxhtehidët bëjnë interpretime sipas nevojës së kohës duke u nisur nga parimet themelore.



Ngushtimi I SË GJERËS

— Prof. dr. Ismail L. Çakan —

Në këtë shkrim, dëshirojmë të analizojmë ndodhinë e një lutjeje/dëshire interesante që është përjetuar në prani të Profetit tonë (a.s.).

NDODHIA

Duke bashkuar transmetimet e haditheve lidhur me këtë ngjarje, mund t'i bëjmë një përmbledhje të tillë:

Sipas konsensusit të shumicës, një beduin i quajtur Dhu'l-huvejsira vjen një ditë në Medinë, hyn në Xhaminë e Profetit (a.s.), dhe me një ton zëri që të mund ta dëgjonte Profeti (a.s.), lutet: O Allah! Më mëshiro mua dhe Muhamedin, dhe mos mëshiro askënd tjetër bashkë me ne!”

Profeti (a.s.), buzëqeshi dhe më pas i tërheq vërejtjen bedunit, duke i thënë:

“A e ngushtove atë që është e gjerë!”

Më pas, i bën me dije se mëshira e Allahut përfshin çdo gjë.

Pa kaluar shumë, personi ngrihet, shkon në një qoshe të xhamisë dhe fillon të urinojë mbi rërë. Sahabët tentuan të ndërhyjnë, por i Dërguari i Allahut (a.s.), i urdhëron ta lënë të mbarojë. Më pas, urdhëron të sjellin një kovë të madhe me ujë dhe ta derdhin mbi vendin ku urinoi beduini.

Pas kësaj, Profeti (a.s.), i drejtohet bedunit dhe i tërheq vërejtjen duke i thënë:

“Kjo ndërtesë është ndërtuar për të përmendur Allahun dhe për të falur namaz. Prandaj këtu nuk mund të urinohet!”¹

Në fakt, kjo ndodhi vë në pah në mënyrë të spikatur dallimin mes beduizmit dhe qytetërimit. Mirëpo, për shkak të aspektit interesant “të urinimit në xhami”, që bën edhe më tepër përshtypje në këtë ndodhi, në shpjegimet e këtij hadithi trajtohet më tepër çështja e pastërtisë. Lidhur me këtë, janë shpjeguar gjerë e gjatë dallimet e mendimeve mes medhhebeve dhe është vlerësuar nëse është e drejtë apo jo që sahabët tentuan të ndërhyjnë para Profetit (a.s.), në prezencë të tij.

Por me sa duket, pjesa e parë të kësaj ndodhie nuk është trajtuar aq sa duhet. E në fakt, të dyja pikat e kësaj ndodhie, “qëndrimi i besimtarit”

1. Për transmetime të ndryshme të këtij hadithi, shih: Buhari, Vudu 56, 57; Edeb 27; Muslim, Taharet 98, 100; Ebu Daud, Taharet 136, Salat 149; Tirmidhi, Taharet 112; Nesai, Taharet 44, Mijah 2; Ibn Maxhe, Taharet 78; Darimi, Vudu 62; Muvatta, Taharet 111; Ahmed b. Hanbel, Musned, II, 239, 272.

dhe “të drejtat e umetit”, janë po aq të vlefshme për t’u trajtuar në mënyrë thelbësore. Kjo, sepse të anashkalosh faktin se xhamia është qendër adhurimi për umetin dhe të ngushtosh lutjen në nivel personal apo grupor, do të thotë që të mos veprosh me dijen dhe vetëdijen e duhur dhe të mjaftueshme në lidhje me vendadhurimin, mëshirën dhe umetin. Ky është një veprim që mund ta bëjë vetëm një beduin që e ka kaluar gjithë jetën në shkretëtirë, larg qytetërimit. Pra, është e qartë se besimtarët e qytetëruar, që e njohin mëshirën Hyjnore, kuptimin e xhamisë dhe umetit, nuk do të vepronin në mënyrë të tillë.

Zoti ynë i Madhëruar, ka urdhëruar: “**...Mëshira Ime përfshin çdo gjë!..**”² Për rrjedhojë, edhe Profeti ynë (a.s.), duke i tërhequr vërejtjen bedunit, i thotë, “*E ngushtove atë që është e gjerë!*”. Me këtë, Profeti ynë (a.s.), në radhë të parë bedunit, e nëpërmjet tij të gjithë neve, umetit Islam, na mëson të lutemi dhe të kërkojmë prej Allahut, duke pasur parasysh gjerësinë e mëshirës së Tij hyjnore. Kjo do të thotë se, kufirin e lutjes e përcakton fakti se prej kujt dhe çfarë kërkon. Ndërsa mënyra se si e kërkon, tregon kujdesin dhe edukimin në lidhje me çështjen. Krahës këtyre, dëshirat dhe kërkesat individuale dhe grupore, të cila anashkalojnë myslimanët e tjerë apo gjithë pjesën tjetër të umetit, në një farë kuptimi, nënkuptojnë ngushtimin e mëshirës së Allahut, që përfshin çdo gjë, kufizimin e përfshirjes së saj, koprraci dhe moskuptim të gjerësisë së vërtetë të asaj mëshire.

MYSLIMANI ËSHTË GJITHËPËRFSHIRËS

“*Dëshirimi për vëllain e vet të fesë, atë që dëshiron për veten*”³, është tregues i pjekurisë së besimit. Në të njëjtën kohë, ky është edhe kushti i domosdoshëm i pjekurisë së besimit. Prandaj, përkujtimi i gjithë umetit Islam në lutje, është një virtut më vete dhe një detyrë e besimit. Kur individët e një shoqërie dëshirojnë për njëri-tjetrin atë që dëshirojnë për veten, do të thotë se ata ndajnë një mirësi dhe lutje të madhe. Në këtë mënyrë, umeti, në aspektin e dëshirave dhe lutjeve, bëhen një strukturë e unifikuar. E në fakt, kjo është ajo që duhet...

2. A'raf, 156.

3. shih. Buhari, Iman 7 ;Muslim, Iman 71,72; Tirmidhi, Kijamet 59; Nesai, Iman 19, 33; Ibn Maxhe, Mukaddime 9; Xhenaiz 1; Darimi, Isti'zan 5; Rikak 29; Ahmed b. Hanbel, Musned, I, 89, III, 176, 206, 251, 272, 278, 289.



Ata që luten vetëm për veten, apo grupin që duan; e thënë ndryshe, që preferojnë vetëm të vetët, në të vërtetë ndajnë të njëjtin nivel dhe gradë me beduinin e ngjarjes së mësipërme dhe e ngushtojnë mëshirën e gjerë hyjnore, gjë të cilën nuk kanë të drejtë ta bëjnë.

Myslimanët, -edhe pse dikush mund të mos e pëlqejë- në të vërtetë janë gjithëpërfshirës. Në këtë pikë, nuk duhet harruar se, përdorimi i fjalës “të gjithë” në formë shprehie apo zakoni, ndryshon nga vetëdija e umetit në kuptimin e vërtetë të fjalës. Pra, e rëndësishme është që të lutesh me gjithë zemër për mëshirë ndaj të gjithë umetit.

NJË KUJTIM

Rahmet pastë, një miku im mësues, në mëngjesin e një Nate të Mirë, më pyeti: “*Mbrëmë u lute për mua, apo jo?*” Pra, dëshironte që unë të isha lutur për të me emër, gjë që nuk ishte ndonjë problem. Mirëpo, për të bërë pak shaka, unë i thash: “*Unë u luta për të gjithë myslimanët. Nëse ti je mysliman, edhe ti ke përfituar.*”

Miku im, nuk e harroi përgjigjen time për një kohë shumë të gjatë dhe në bisedat që bënim



herë pas here, e tregonte shpesh dialogun mes nesh, duke thënë, “a e dini si më ka thënë ky burrë?” Allahu e mëshiroftë mikun tim, të gjithë të vdekurit tanë dhe të gjithë myslimanët.

ANALIZË

Nëse i kthehem edhe njëherë ndodhisë sonë, shohim se Profeti ynë (a.s.), nuk e perceptoi fjalën e beduinit si të qëllimshme, por si mungesë njohurie. Prandaj ai i kujtoi se gjerësia e mëshirës hyjnore ishte e pafundme dhe e pashtershme. Në vazhdim të ngjarjes, Profeti ynë (a.s.), bëri të ditur edhe funksionin e vërtet të xhamive. Kështu, për shkak se të dyja veprimet e beduinit buronin nga mangësia e edukimit dhe normave të edukatës, Profeti ynë (a.s.), iu qas atij me tolerancë dhe pjekuri të madhe, gjë e cila ishte e vlefshme edhe për edukimin e sahabëve, por edhe për edukimin e të gjithë umetit në aspektin e informimit dhe lehtësimit të fesë. Në një transmetim në Sahihun e Buhariut⁴, Profeti ynë (a.s.), i urdhëron sahabët duke u thënë: “Ju keni për detyrë të jeni vetëm lehtësues, e jo vështirësues!”

4. Buhari, Vudu’ 58

Siç duket, beduini e ka barazuar Profetin (a.s.), me veten e vet dhe nuk i ka njohur të drejtën e mëshirës hyjnore askujt tjetër prej besimtarëve, përveç Profetit (a.s.) dhe vetes të tij. Kushedi, mbase kështu ka shpresuar se do të fitonte admirimin e Profetit tonë (a.s.).

Sipas beduinit, diskriminimi pozitiv i shprehur në fjalinë, “Më mëshiro mua dhe Muhamedin dhe mos mëshiro askënd tjetër bashkë me ne!”, në vend që të merrte pëlqim, për shkak se përmbante një gabim të madh, u përball me tërheqjen e vërejtjes nga ana e Profetit (a.s.), i cili i tha; “e ngushtove mëshirën e gjerë të Allahut!”.

Në këtë vërejtje të Profetit tonë (a.s.), ka një përgëzim dhe shpresë të madhe për të gjithë umetin në përgjithësi dhe për gjynahqarët e umetit në veçanti. Për rrjedhojë, duhet që ne besimtarë të strehohemi tek mëshira hyjnore që përfshin çdo gjë, pa e humbur kurrë shpresën dhe pa u penguar nga madhësia e gabimeve dhe gjynaheve tona. Ky është parimi themelor!..

Mirëpo, këtu duhet të tregojmë kujdes edhe në një pikë të veçantë:

Në suren Lukman, Allahu i Madhëruar urdhëron:

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj dhe frikësojuni Ditës, kur prindi nuk do të mund ta ndihmojë aspak fëmijën e vet, e as fëmija nuk do të mund ta ndihmojë sado pak prindin e vet! Premtimi i Allahut është vërtet i sigurt, prandaj mos e lini jetën e kësaj bote t’ju mashtrojë dhe as djallin mos e lini t’ju mashtrojë për Allahun.” (Lukman, 33.)

Nga ky ajet, kuptohet qartë se, nuk duhet ta lejojmë shejtanin e mallkuar “të na mashtrojë për Allahun”, duke u zhytur në gjynahe dhe duke krijuar mendime të paqena në lidhje me Allahun, vetëm sepse i besojmë mëshirës së Tij. Nuk duhet harruar se, të bësh gjynahe vazhdimisht dhe të mos kërkosht asnjëherë falje, duke menduar se mëshira e Allahut është e madhe dhe Ai fal shumë, do të thotë “të mashtrohesh për Allahun”.

Shkurtimisht, ne duhet të bëjmë kujdes edhe të mos e ngushtojmë mëshirën e Allahut që përfshin çdo gjë, edhe të mos abuzojmë me faljen e Allahut, duke bërë gjynahe në mënyrë të vazhdueshme.

Allahu na ndihmoftë!



ANALIZA E “AH SIKUR”-ËVE NË KURANIN FISNIK

— Xhafer Durmush —

Mes ajeteve që na njoftojnë për çështjet mbi të cilat do të pendohet njeriu në të dyja botët, duhet qëndruar në mënyrë të veçantë mbi ato që kanë lidhje me ahiretin, sepse atje, pendimi nuk do të ketë asnjë dobi për të zotin. Këtu dëshirojmë të tërheqim vëmendjen në pikën fillestare të pendesës, e më pas të bëjmë një vlerësim në kuadrin e shembujve të dhënë.

A) Fillesa e pendimit:

Pendimi i vërtetë i njeriut, fillon kur atij i mbyllet perdja e kësaj bote dhe i hapet ajo e botës tjetër. Veçoria më e rëndësishme e këtij pendimi që ndryshon në bazë të punës së njeriut, është fakti se ai konsiderohet si “ah sikur”-i i fundit për këtë botë dhe i pari në lidhje me botën tjetër. Prandaj, Hasan Basriu (Allahu e mëshiroftë), mendon se fjala “ditë” në ajetin: **“Atë ditë, njeriu do të vihet në dijeni për veprat që ka bërë dhe për ato që ka lënë pa bërë.”**¹, nënkupton “momentin e vdekjes”. Në komentimin e këtij ajeti, ai thotë: “Në momentin e vdekjes zbresin meleket e memories dhe i paraqesin njeriut çdo të mirë e të keqe që ka bërë. Në atë situatë, kur njeriu sheh një vepër të mirë, e fikson shikimin aty, gëzohet dhe i ndrit fytyra. Por, kur sheh një vepër të keqe, i ul sytë, nuk dëshiron të shohë dhe e vrenjt fytyrën.”²

Sipas një transmetimi, një ditë, i Dërguari i Allahut (a.s.), shkoi pranë njërit prej ensarëve, i cili ndodhej në shtratin e vdekjes dhe e pyeti se si ndihej dhe çfarë shihte. Kur ensari i tha se po shihte që po përgatiteshin dy gjëra për të; njëra e bardhë, tjetra e zezë, atëherë i Dërguari i Allahut (a.s.), e pyeti se cila prej tyre është

më afër tij. Ensari i tha se e zeza ndodhej më afër tij dhe i kërkoi Profetit (a.s.), të lutej për të. Më pas, në sajë të begatisë së lutjes së Profetit (a.s.), ensari tha se gjëja e zezë po largohej nga ai.³

Ky transmetim, është konsideruar si argument se e zeza për të cilën bëhet fjalë, përfaqëson veprat e këqija, ndërsa e bardha veprat e mira, dhe se këto, do t'i shfaqen njeriut në momentin e vdekjes.

Qëllimi ynë për të tërhequr vëmendjen tek pika fillestare e “ah sikur”-ëve në lidhje me botën tjetër, është që të rikujtojmë se në momentin e fundi, njeriu i mbyllet dera e pendimit dhe i paloset libri i punëve. Kjo, sepse përkujtimet që do të bëjmë në ajetet e mëposhtme, janë shumë të rëndësishme për të kuptuar se sa të çmuara janë ato për ata që janë ende gjallë.

B) Shkaqet e pendimit në botën tjetër:

1. Refuzimi i ftesës profetike për shpëtim dhe pasimi i atyre që ftojnë në devijim.

Ata që e refuzojnë ftesën e atyre që i thërrasin në fenë e Allahut, duke shkuar pas egos së vet dhe shejtanit, **“Atë Ditë hanë gishtat e duarve të veta, duke thënë: «Ah, sikur ta kisha marrë rrugën (e drejtë) me të Dërguarin! Ah, sikur të mos e kisha bërë filanin mik! Ai më ka larguar nga Këshilla (Kurani) që më kishte ardhur!»**⁴ Kështu, ata do ta kuptojnë se i kanë bërë padrejtësi vetes së tyre, sepse si rezultat i natyrshëm i refuzimit të ftesës në rrugë të drejtë, ata pasuan miqtë e tyre që i thërrisnin në devijim. Për rrjedhojë, pendimi më i madh, do të jetë për shkak

të refuzimit të ftesës së njerëzve të devotshëm dhe mashtrimit pas fjalëve të stolisura të gjynahqarëve. E në fakt, ky është shkaku kryesor për të gjitha gjynahet dhe gabimet e bëra për të cilat njeriu do të pendohet. Pendimin e njerëzve të tillë, Kurani e përmbledh në këtë formë:

“Dhe, kur të vijë te Ne, (jobesimtari) do t’i thotë (shejtanit që e kishte shok): ‘Ah, sikur të kishte qenë largësia midis meje dhe teje sa ajo mes lindjes e perëndimit! Sa shok i keq paske qenë ti!’”⁵

Një tjetër pendesë e atyre që ndodhen në këtë situatë, është për shkak se ata kanë ndjekur verbërisht të parët e vet që ecnin në rrugë të devijuara. Për këtë arsye, të mëhershmit do të debatojnë me të mëvonshmit përpara Allahut, duke fajësuar njëri-tjetrin dhe do të thonë: **“O Zoti ynë, ne iu bindëm parisë tonë dhe eprorëve tanë, por ata na shmangën prej rrugës së drejtë. O Zoti ynë, atyre jepu dënim të dyfishtë dhe mallkim të madh!”⁶**

2. Puna e pareshtur për të fituar mirësitë e kësaj bote dhe neglizhimi i përgatitjeve për botën tjetër.

Ajeti fisnik që na tregon këtë situatë, përshkruan gjendjen e një të mjeri që shkon duarbosh në një vend ku duhet të shkojë me duart e mbushura plot me dhurata: **“Dhe, kur të silllet Xhehenemi, atë Ditë njeriu do të kujtohet, por ç’i duhet se u kujtua! Ai do të thotë: ‘Ah, sikur të kisha bërë diçka të mirë për jetën time!’”⁷**

Dhe me të vërtetë që, nëse njeriu shkon duarbosh në një vend ku do të jetojë përgjithmonë, ose pandeh se ka sjellë diçka me vete, kjo do t’i shkaktojë atij një zhgënjim dhe pendim shumë të hidhur.

3. Neglizhimi i adhurimeve dhe përgjegjësi shoqërore që ka për detyrë.

Lidhur me këtë pendesë, në Kurranin Fisnik urdhërohet: **“Çfarë ju ka sjellë në Sekar?» Ata do të përgjigjen: «Nuk ishim nga ata që falnin namaz dhe as prej atyre që i ushqenin të varfrit. Ne lëshoheshim në biseda të kota me llafazanët dhe mohonim Ditën e Llogarisë, derisa na erdhi vdekja.»”⁸**

4. Nënvlëftësimi i ndëshkimit, shpërblimit, llogarisë, librit të veprave dhe çështjeve të tjera që kanë të bëjnë me botën tjetër.

Gjendja e njerëzve të tillë, përshkruhet kështu në Kuran:

“Dhe Libri (i veprave të tyre) do t’u vihet përpara, e do t’i shohësh gjynahqarët se si do të tmerrohen nga ato që gjenden në të dhe do të thonë: ‘Të mjerët ne! Çfarë është ky libër që nuk paska lënë asnjë vepër të madhe apo të vogël pa e shënuar atë’...”⁹
Ndërsa në një ajet tjetër, urdhërohet: **“...«Ah, sikur të mos më ishte dhënë libri im dhe të mos e kisha ditur llogarinë time! Ah, të kisha qenë i vdekur (e të mos isha ringjallur)!»”¹⁰**

Shkurtimisht, njeriu do të pendohet tej mase që e ka refuzuar miqësinë me njerëzit e sinqertë dhe të devotshëm. Do të pendohet për miqësinë me gjynahqarët që nuk ruheshin nga haramet. Do të pendohet për zhytjen në dëfrime e lojëra dhe për ndjekjen verbërisht të rrugës së devijuar të të parëve të vet. Do të pendohet për

mos faljen e namazit dhe mos kryerjen e të gjitha adhurimeve të tjera për të cilat ka qenë përgjegjës. Ai do të pendohet për moskujdesin ndaj jetimëve, halleve të umetit, nevojtarëve dhe të vetmuarve. Do të pendohet për mos përgatitjen për botën tjetër dhe nënvleftësimin e ditës së llogarisë. Dhe, të gjitha këto, nuk janë pendesa kalimtare, por pendesa që do t’i japin vuajtje të zotit përjetësisht.

Tregohet se, Një ditë Behlul Dana pyeti një nga drejtuesit Abbasi, Harun Rashidin:

- O prijës i myslimanëve, kam tri pyetje për ty:

1. Çfarë ka më shumë mbi tokë?
2. Çfarë ka më shumë nën tokë?
3. Dhe çfarë ka më shumë në qiell?

Harun Rashidi i dha këtë përgjigje: **“Mbi tokë ka më shumë të gjallë. Nën tokë ka më shumë të vdekur dhe në qiell ka më shumë krijesa me krahe, si flutura, zogj etj. Behlul Dana kthehet nga ai dhe i përgjigjet në këtë formë:**

“Jo, o prijës i nderuar! Ti e kape çështjen nga ana e dukshme. E vërteta është se: mbi tokë ka më shumë smirë, zili, xhelozë dhe dëshira të panumërta të egos. Nën tokë ka më shumë pëshpëritje dhe pendim ‘i shkreti unë’ dhe ‘sikur’. Ndërsa në qiell mund të gjelesh më shumë veprat e mira që arrijnë tek Zoti i madhëruar.”

Pra, ajo që duhet bërë sot, është të përpiqemi të shtojmë veprat e mira, me qëllim që nesër në botën tjetër të mos pendohemi për mungesën e tyre, dhe të largohemi nga veprat e këqija, që të mos themi “pse e bëra këtë”.

AJO QË DUHET BËRË SOT, ËSHTË TË PËRPIQEMI TË SHTOJMË VEPRAT E MIRA, ME QËLLIM QË NESËR NË BOTËN TJETËR TË MOS PENDOHEMI PËR MUNGESËN E TYRE, DHE TË LARGOHEMI NGA VEPRAT E KËQIJA, QË TË MOS THEMI “PSE E BËRA KËTË”.



■ **REFERENCAT:** 1) Kijame, 13. 2) Sujuti, Sherhu's-Sudur. 3) Sujuti, Sherhu's-Sudur. 4) shih. Furkan, 27-29. 5) Zuhruf, 38. 6) shih. Ahzab, 67-68. 7) Fexhr, 23-24. 8) Muddeththir, 42-47. 9) Kehf, 49. 10) Hakka, 25-27.

RËNDËSIA E RINISË DHE ÇËSHTJA E IDENTITETIT

— Prof. Dr. Kerim Bulladë —

Ardhja në këtë botë e Pejgamberit tonë të Nderuar (a.s.), sipas kalendarit të shpallur nga Kryesia e Dijanetit (entit të çështjeve fetare në Republikën e Turqisë), këtë vit do të festohet në muajin nëntor si “Java e Lindjes së Pejgamberit”. Tema kryesore e organizimeve që do të realizohen në nderim të kësaj jave është zgjedhur si “Pejgamberi dhe Rinia”. Edhe ne në këtë material do të përpqemi të shtjellojmë rëndësinë e rinisë dhe problemin e identitetit.

PERIUDHA E RINISË:

Rinia nga aspekti psiko-social përkufizohet si një proces që fillon me pubertetin dhe që vazhdon deri në moshën 22-25 vjeçare.

Pejami Safa (v. 1961) me të vërtetë bën një portret origjinal në lidhje me rininë: “Kuptimi i rinisë në

fjalorin e natyrës është freskia. Lulëzimi i një fidani të freskët në trup, shkëlqimi i një gjetheje të freskët në lëkurë, shpërthimi i fijeve të freskëta në flokë, rrjedhja e një burimi të freskët te sytë, e kuqja e frutës së freskët te buzët dhe gjallëria e freskët në ecje. Kuptimi i rinisë në fjalorin e shoqërisë është diçka shumë më e lartë se freskia. Ajo është një gjallëri që lind nga kontakti me xhevahirin e ndjenjës kombëtare. Një dritë mishërimi në zgjuarsia që lind nga nevoja për të kuptuar çështjet të cilat na i ka radhitur përpara shoqëria. Tingulli i telave që e lidhin njeriun me njeriun në zemër. Përgatitja në vullnet për t’u gjuajtur nga harku e për t’u hedhur drejt synimeve më kuptimplota sesa të jetosh në mënyrë kafshërore. Një njeri i prapambetur dhe një popull i prapambetur është ai që e gjen kuptimin e rinisë vetëm në fjalorin e natyrës. Njeri i përparuar dhe popull i përparuar është ai që e shton edhe kuptimin e rinisë në fjalorin e shoqërisë. Në këtë mënyrë i riu nuk mjaftohet vetëm me të qenët një

fidan i freskët dhe një qenie e gjallë, por bëhet një njeri i vetëdijshëm, i zgjuar, i kulturuar, i përgatitur, i vullnetshëm dhe këmbëngulës.¹

RËNDËSIA E RINISË:

Rinia është burimi i krenarisë, fuqisë, shpresës dhe dëshirës së çdo populli. Të rinjtë në çdo fushë luajnë rolin e lokomotivës në zhvillimin dhe përparimin e vendit dhe popullit të tyre. Çdo popull që u ka dhënë vlerë brezave të rinj, është lartësuar. Ndërsa ata që i kanë nënvlerësuar, kanë mbetur mbrapa. Qëndrimi në këmbë i popullit, ruajtja e fesë dhe mbrojtja e vlerave kulturore, ndodh falë energjisë dhe aksioneve të të rinjve që kanë marrë një edukim të mirëfilltë dhe sakllam që në fillim.

Rinia, siç shprehet shumë bukur në shqipen tonë, është periudha e “adoleshencës”. Pra, është periudha kur gjaku zien, zemrat rrahin fort dhe emocioni arrin pikën kulmore. Kjo periudhë edhe një segment kohor kur përrenjtë shndërrohen në lumenj, kur ata nuk i zë më shtrati i tyre dhe kur bëhet një jetë plot çmenduri.² Rinia është një mirësi e rëndësishme për të cilën duhet ta falënderojmë Allahun, sepse ajo i është dhënë njeriut nga Zoti (xh.xh.). Pejgamberi (a.s.), na ka njoftuar me këto fjalë të bekuara se të gjithë do të merremi në llogari dhe do të pyetemi se ku dhe si e kemi harxhuar këtë mirësi: “Njeriu ditën e kiametit nuk do t’i lëvizë dot këmbët nga vendi pa u pyetur për këto katër gjëra. E para: Ku e ka harxhuar jetën. E dyta: Në cilën rrugë e ka harxhuar rininë...”³ Në këtë mënyrë njeriu do të merret në llogari për jetën në përgjithësi dhe për rininë në veçanti. Sepse rinia është periudha e fuqisë dhe aktivitetit që Allahu Teala ia ka dhënë njeriut ndërmjet dy periudha të dobësisë që janë fëmijëria dhe pleqëria.⁴

E ardhmja e popujve është e lidhur me rininë dhe me edukimin e rinisë. Popujt që i japin rëndësi edukimit dhe arsimimit të rinisë së tij duke marrë parasysh edhe rrethanat e kohës që përparojnë, gjithmonë janë lartësuar dhe janë bërë të zotët e fjalës në botë. E ardhmja e një vendi është e lidhur me kulturën, moralin, arsimimin dhe edukatën që do të marrë rinia. Madhështia dhe fuqia e një populli nuk është e lidhur me numrin e shumtë të banorëve, por është e lidhur drejtpërdrejt me numrin e të rinjve të mençur, largpamës, të virtytshëm, të ditur,

1. Pejami Safa, Seçmeler – Pjesë të zgjedhura (Yeni Mecmua, 19 Maj, 1939), Përgatitën, Faruk Timurtash - Ergyn Göze, Stamboll, 1970 (1000 Temel Eser) fq. 31.

2. Mustafa Əxhall, Gençligimiz ve Geleceğimiz – Rinia dhe e ardhmja jonë, Gençlik Dönemi ve Egitimi – Periudha e rinisë dhe edukimi, Stamboll, Brenda 2000 (Tartısmalı İlmî Toplantılar Dizisi – Seriali i mbledhjeve shkencore me debate, 29), fq. 13

3. Tirmidhi, Sunen, Kijamet, 1.

4. Shik. Surja Rum, 53.



të ndershëm, fisnikë, që i besojnë vetes, besimtarë dhe të vendosur.

Periudha e rinisë dhe adoleshencës i ngjan lumenjve që rrjedhin furishëm. Përderisa të mos kanalizohen në një orientim të saktë lëvizjet dhe energjia e të rinjve, këta të fundit e shkatërrojnë dhe e fshijnë nga faqja e dheut çdo gjë pikërisht si lumenjtë që dalin nga shtrati i tyre. Kështu që e dëmtojnë ndjeshëm jetën e shoqërisë dhe popullit. Rinia është themeli i popullit, e ardhmja e vendit, pavarësia e atdheut dhe shtylla e shoqërisë. Të rinjtë janë mirësia dhe begatia më e shtrenjtë që Allahu Teala ia ka dhënë familjes dhe popullit. Mbi të gjitha janë amaneti i Tij.

Qëllimi më i madh i një populli duhet të jetë edukimi i brezave që do ta ketë kauzë të tyre idealin e popullit dhe atdheut dhe që do t’i japin përparësi interesit të popullit e shoqërisë kundrejt interesit të tyre. Edukimi i brezave të integruar me fenë, zakonet, adetet dhe traditat e popullit është qëllimi absolut i idealit të shoqërisë. Sepse fuqia dhe parimet jetike që e mbajnë popullin në këmbë janë të fshehura dhe të goposura në jetën e atyre.

Rinia është periudha më energjike dhe aktive e jetës së njeriut. Idealet e njeriut, ndjenjat e ndryshme të tij, ëndrrat e pasura dhe emocionet e këndshme të tij fillojnë të formohen në këtë periudhë. Në këtë periudhë formohen dijet, cilësitë e bukura, zhvillohet karakteri dhe personaliteti dhe ndërtohet vullneti, durimi, qëndrueshmëria, vendosmëria dhe aftësia për t’u përpjekur të cilat do të jenë të nevojshme për njeriun përgjatë gjithë jetës. Formimi i idealeve dhe hedhja e hapave që i japin drejtim jetës së njeriut ndodhin përgjatë kësaj kohe. Fillimi i përgjegjësisë dhe i marrjes përsipër të problemeve merr start në këtë pikë.

Përgatitja për jetën, fitimi i lumturisë së përherëshme dhe arritja e shijes së nderit të të qenët rob

i Zotit, formohen në këtë periudhë. Kjo fazë është njëra prej etapave më të rëndësishme të jetës së njeriut. Për këtë arsye, duhet të shfaqet përpjekja më e madhe për ta bërë këtë etapë produktive, të begatë dhe të bereqetshme. Në lidhje me këtë çështje duhet të përgatiten programe të rëndësishme dhe të planifikohen projekte të tilla.

CAKTIMI I IDENTITETIT

Njëra prej çështjeve të rëndësishme që influencon te rinia është edhe çështja e identitetit. Të mos dish se kush je, të mos vendosësh dot se kush do të bëhesh, të mos caktosh dot se kujt do t'i ngjash dhe kë do të marrësh për shembull, janë prej çështjeve që e vështirësojnë më së shumti rininë. Një rini që ka mbetur ndërmjet dëshirës për t'u bërë një fëmijë i perëndimit si një nip i kulturës së Lindjes, pothuajse është e pamundur të gjejë prehje shpirtërore, ta njohë veten dhe të ecë me vendosmëri drejt të ardhmes.

Tani kemi të bëjmë me një rini që rrënjët i ka nga lindja dhe dëshirat i ka nga perëndimi. Një rini që vazhdon t'i drejtohet perëndimit apo të edukohet dhe orientohet gjithmonë në këtë drejtim edhe pse feja, morali, kultura, zakoni, adeti dhe tradita e saj është nga lindja. Një rini që edhe e dënon perëndimin, edhe përpëlitet për t'u bërë perëndimore.

Çështja e identitetit ndoshta është prej problemeve më të mëdha të rinisë së sotme. Të gjithë si njerëz kemi një identitet të poshtëm siç është prejardhja, raca dhe populli. Po ashtu kemi edhe një identitet të sipërm siç është feja, gjuha dhe kombi. Kurani Fisnik asnjëherë nuk e refuzon identitetin e poshtëm. Në ajetin fisnik: *"O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdhijshëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë."*⁵, njoftohet se të gjithë njerëzit kanë ardhur nga e njëjta rrënjë dhe shpjegohet qartë se nga kjo rrënjë kryesore kanë ardhur fise të ndryshme.

Shkaku i ardhjes së njerëzve në këtë botë dhe i nënshtimit të universit ndaj tyre që të jetojnë, është që ata të mirëkuptohen me njëri-tjetrin, të njihen dhe të formojnë miqësi. Të gjithë mund ta ruajnë identitetin e poshtëm brenda këtyre rregullave, mund ta zhvillojnë dhe mund të ndjehen krenarë me të. Mbi këto gjendet edhe identiteti i kombit. Edhe ky identitet është një identitet i lartë i rëndësishëm që i përfshin të gjitha identitetet e tjera dhe që mundëson mbrojtjen e tyre në paqe. Ndërsa mbi të gjitha këto gjendet identiteti i fesë

dhe vëllazërisë.

Identiteti dhe vëllazëria e fesë është një identitet integruar, bashkuar dhe gjithëpërfshirës. Ky identitet posedon një fushë të gjerë duke u bazuar në parimin: *"Besimtarët janë vëllazër..."*⁶ Korniza e këtij identiteti është e gjerë. Parimi më themelor i këtij identiteti është "tevhidi", apo thënë ndryshe, njësimi i Zotit. Mësimi i parë dhe absolut i këtij identiteti është besimi ndaj ekzistencës dhe njësimi të Allahut (xh.xh.). Të gjithë ata që i besojnë ekzistencës dhe njësimi të Allahut, profecisë së Muhamedit (a.s.), të gjithë pejgamberëve, të gjithë librave dhe ditës së gjykimit, e arrijnë vëllazërinë duke e zhvilluar identitetin e tyre të poshtëm që posedojnë brenda këtij identiteti. Kjo vëllazëri është vëllazëri e përhershme. Rruga për të arritur lumturinë edhe në këtë botë, edhe në botën e përtejme është e lidhur me këtë vëllazëri. Manifestet e tjera të rëndësishme të këtij identiteti pas tevhidit janë parimet absolute si besimi ndaj Kuranit, drejtimi ndaj kiblës, të qenët umet i Pejgamberit (a.s.), etj. Paqja, stabiliteti, siguria, lumturia, njësimi dhe integriteti i rinisë arrihet vetëm me këtë identitet. Kështu që nuk është e nevojshme të jesh magjistër (parashikues) për të thënë se ata që e posedojnë këtë identitet dhe njihen te ai me njëri-tjetrin, kurrë nuk do të devijojnë, nuk do ta lëndojnë njëri-tjetrin dhe nuk do të përbëjnë kërcënim për atdheun dhe popullin e tyre. Materialin tonë dëshirojmë ta përfundojmë me vlerësimin e një dijetari dhe mendimtari tonë.

Kriza e identitetit është një lëmsh i trishtuar problemesh që e shfaqin personalitetet "kaotike dhe të deformuara" të cilat dalin në pah si pasojë e përplasjeve të kulturave të ndryshme. Problemi i identitetit po rritet edhe në vendin tonë ashtu siç po ndodh në të gjithë botën. Zhvillimi i shpejtë i mjeteve të komunikimit dhe kontaktimit masiv, shtimi i marrëdhënieve ndërkombëtare, përsheptimi i urbanizimit paralel me industrializimin, gjendja e prindërve të cilët interesohen më pak me familjen dhe fëmijët e tyre për shkak se punojnë, dobësimi i dialogut ndërmjet nxënësve dhe mësuesve në shkollë, infiltrimi ndërmjet të rinjve i fuqive të fshehta, i qarqeve tradhtarë dhe i njerëzve dashakeqës, shkatërrimi i vazhdueshëm i botimeve të pakontrolluara që ekspozojnë femrën në mënyrë të papërshtatshme, përhapja e alkoolit dhe e drogës, dashje pa dashje nxjerrin në pah një krizë identiteti dhe më e keqja, e vështirësojnë adaptimin e brezave të rinj.⁷

6. Huxhurat, 10.

7. Ahmet Arvasi, Kültür Emperyalizmi ve kimlik Bunalımı – İmp - rializmi i Kulturës dhe Kriza e Identitetit, Revista Jeshilaj, Uyusturucu Kültürü – Kultura e Narkotikës, Stamboll, 1992, fq. 60.

5. Huxhurat, 13.

PËRPPJEKJA

PËR KAPËRCIMIN E PENGESAVE

— Sami Byjkkajnak —

të Jetës

Kurani Fisnik shprehet se njeriu ka dy rrugë në jetën e kësaj bote:

“Allahu i thërret njerëzit për në Shtëpinë e shpëtimit (xhenet) dhe udhëzon kë të dojë në rrugën e drejtë.” (Junus, 25)

“Vallë, a nuk ju kam urdhëruar, o bijtë e Ademit, që të mos e adhuronit djallin, se ai është vërtet armik i hapët i juaji...” (Jasin, 60)

Nisur nga ajetet e mësipërme, njeriu ose është në rrugë që e shpie në mirësi, ose është në rrugë që e shpie në të keqe. Domethënë, në këtë jetë ka dy rrugë që njeriu mund të ndjekë... Rruga që tregon Allahu Teala dhe rruga në të cilën shejtani përpiqet t'i tërheqë njerëzit. Jeta e kësaj bote rrjedh në rrjedhën e këtyre dy rrugëve. Kur njeriu të ecë në rrugën e mirësisë, sigurisht se përballë do t'i dalin ngjitje dhe zbritje. Ja pra, këto ngjitje-zbritje janë sprovimi i njeriut. Allahu Teala e shpall në suren

Beled se cilat janë ngjitje-zbritjet dhe thekson se njeriu mund t'i përballojë këto ngjitje-zbritje vetëm me ndihmën e Tij.

Allahu i Lartësuar thotë se “ngjitje-zbritjet është lirimi i robit”. Kuptimi i ajetit kur zbriti ishte lirimi i njerëzve që janë robëruar. Edhe Ebu Bekri, (r.a.), i ka liruar shtatë robër vetëm e vetëm për ta kaluar këtë sprovë. Të gjithë e dimë lirin e Bilal bin Rebahut (r.a.).

Bilalin e patën shtrirë në rërë të nxehtë. Politeisti Umejje bin Halefi i urdhëroi robërit e tjerë:

“Vendosini sipër Bilalit një gurë të madh, të nxirë nga temperatura e diellit dhe të nxehtë!”

Menjëherë vjen njeriu i madh shembullor, Ebu Bekri (r.a.).

Bilali rënkonte:

“Allahu është një!” Ebu Bekri, (r.a.), i bën një propozim material këtij politeisti materialist:



“Të jap robin tim që është prej fesë tënde dhe i pasur, ndërsa ti më jep Bilalin!”

Politeisti i madh u habit. Një propozim i madh, sepse mendja e atij punonte vetëm për para. Menjëherë pranoi. Një rob me para kundrejt një robi që s’ka asgjë. Në këtë mënyrë, Ebu Bekri, (r.a.), liroi shtatë robër.

Një ditë, babai i tij, Ebu Kuhafe i tha:

“Bir! Ti po liron robërit. Kjo është diçka e vyer, por të paktën liro robër me trup të madh, të dobishëm dhe që mund të na ndihmojnë, në mënyrë që edhe punët tona të shkojnë mirë...” Ebu Bekri, (r.a.), dha këtë përgjigje që tregonte përpjekjen për ta kaluar këtë provë:

“Unë nuk po i liroj robërit për interesin tim. Ata po i liroj vetëm për të fituar pëlqimin e Allahut Teala.”

Sot ky ajet ka dy kuptime për ne:

I pari, lirimi i njerëzve që u është robëruar zemra.

Në kohën tonë ka shumë njerëz që janë robëruar. Robërit e televizorit, robërit e kompjuterit, robërit e parasë, robërit e fëmijëve, robërit e femrave, robërit e bixhozit, robërit e alkolit dhe robërit e argëtimit që e kanë lidhur veten në mënyrë të pakufizueshme me to...

Allahu Teala po na thërret në shekullin e njëzet e një dhe po na thotë:

“O ju që e shikoni veten në rrugë të drejtë! O ju që pranoni se po ecni në rrugë të drejtë! Asgjë nuk arrihet pa kaluar nga këto ngjitje-zbritje! Nëse jeni në rrugë të vërtetë, duhet t’i kaloni këto ngjitje-zbritje. Njerëzia e robëruar po ju pret. Nëse nuk mund ta ndihmoni ndonjë që ka rënë në dallgët e kësaj jete, atëherë nuk mund ta kaloni këtë ngjitje-zbritje.”

I dyti, çdo njeri duhet të bëjë vepra të mira, në mënyrë që të shpëtojë nga fundi i keq, sepse shpëtimi i çdo njeriu është në lidhje me veprat që ka bërë. Ky shpëtim arrihet duke luftuar kundër mashtrimeve të shejtanit dhe dëshirave të nefsit e cila urdhëron të keqen dhe për të cilën thuhet: “Armiku më i madh i yti është nefsi që e ke në brendësi.” (Keshfu’l-Hafa, 1, 160.) (Elmallëllë, 9, 229.)

Domethënë, kuptimi i lirimit të një robi, siç ka lidhje me botën e brendshme të njeriut, edhe në aspektin social është ndihma ndaj njerëzve që e kanë robëruar veten e tyre. Zoti i Lartësuar thotë se “sprova është të japësh për të ngrënë edhe në ditët e vështira”. Edhe në hadithin fisnik thuhet: “Shpëtoje veten nga zjarri qoftë edhe me një gjysmë hurme.” Të dhënë kur ka, është e vështirë për atë që është

bërë rob i nefsit. Edhe të dhënë kur s’ka, është po aq e vështirë. Të dhënë për hir të Allahut duhet të bëhet zakon edhe kur ka, edhe kur s’ka. Vetëm me këtë është e mundur që t’i kalojmë ngjitje-zbritjet e kësaj jete, të bëhemi si sahabët dhe ta fikim llambën, në mënyrë që të ngopet mysafiri. Të bëjmë sikur hamë, në mënyrë që të ngopet mysafiri. Kjo shprehje që kalon në Kuranin Fisnik në lidhje me përkufizimin e të devotshmit, tregon se mund të jepet edhe në vështirësi:

“Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e toka dhe që është përgatitur për të devotshmit, të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit.” (Al Imran, 133-134)

Të japësh edhe në mirëqenie, edhe në vështirësi, është gjëja që i vjen më rëndë vetes. Nisur nga kjo, të dhënë për hir të Zotit sjell më shumë shpërblim dhe sevap, sepse Allahu Teala thotë:

“Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe profetët; e atij që me vullnet jep nga pasuria e vet për të afërmit, jetimët, të varfrit, udhëtarët e mbetur rrugës, lypësit dhe për lirimin e të robëruarve; e atij që fal namazin dhe e jep zekatin; dhe e atyre që i plotësojnë premtimet, kur marrin përsipër diçka; e atyre që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe lufte. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që e kanë frikë Allahun.” (Bakara, 177)

“Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënë rob edhe pse vetë janë nevojtarë.” (Insan, 8) Të japësh në ditë të vështira është altruizëm. Domethënë, të mendosh për gjendjen e të tjerëve duke e lënë mënjane gjendjen tënde. Domethënë, t’u japësh përparësi të tjerëve ndaj vetes tënde. Kjo është një gjendje që nefsi e pranon me shumë vështirësi. Ndërkohë që nefsi thotë “unë”, myslimani ndihmon të tjerët duke u shprehur me gjithë fuqinë që ka: “Jo unë, por të tjerët...”

Në ajetet e tjera tregohet se kush duhet të merret nën mbrojtje në ditë të vështira. Së pari flitet për jetimin. Allahu Teala thotë: **“Jetimin e afërm.”** (Beled, 15)

Mukati, i cili ishte prej komentuesve të periudhës së parë të Kuranit, shprehet se Zoti (xh.sh.), me këtë ajet ka për qëllim jetimin me të cilin dhënësi ka lidhje farefisnore. Për këtë arsye, të ushqyerit e jetimit të afërm është më i virtytshëm. Ai e vërteton këtë duke thënë se marrësi është edhe jetim, edhe i

“Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e toka dhe që është përgatitur për të devotshmit, të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit.” (Al Imran, 133-134)

afërm i dhënësit. Thuhet se në përmbajtjen e kësaj fjale, siç hyjnë të afërmit nga farefisi, hyjnë edhe të afërmit nga aspekti i fqinjësisë.

Jetimët janë amaneti i Allahut për njerëzit, ashtu si pasuria dhe fëmijët e tyre. Allahu Teala, siç kërkon që njeriu t'i ndihmojë të tjerët më pasurinë që ia ka dhënë, po ashtu kërkon që të ndihmohet duke u marrë nën mbrojtje edhe jetimi të cilin e ka lënë si amanet. Për këtë arsye, gjyshërit tanë kanë formuar vakëfet e “Daru'l-Ejtam”. Në këtë mënyrë, ua përkëdhelën kokën jetimëve të cilët janë amaneti i Allahut, dhanë mund për t'i edukuar ata si njerëz të së ardhmes dhe i futën të gatshëm në jetën sociale, sepse, kur jetimët të mos kenë përkujdesje, zvarriten në ndonjë zbrazëti. Fëmijët që nuk u përkëdhelet koka, fillojnë t'i shohin të tjerët si armiq. Si rezultat, bëhen individë të dëmshëm dhe të rrezikshëm për shoqërinë. Për këtë arsye, Allahu kërkon që të shfaqim një ndjeshmëri të veçantë kundrejt jetimëve dhe thekson se kjo është një sprovë e vështirë.

Ndërsa ajeti: **“Ose të varfrin e mjerë.”** (Beled, 16) – që përmendet në pjesën e dytë të atyre që duhet t'u jepet edhe kur jemi në vështirësi, është ai i varfër që është shtrirë përtokë për shkak të varfërisë dhe nevojës që ka. Ai nuk ka asgjë për t'u mbuluar dhe asgjë për të shtruar poshtë. Domethënë, njeri shumë i varfër që nuk posedon asgjë.

Transmetohet se Ibn Abbasi (r.a.), kishte rastisur në një të varfër i cili ishte shtrirë përtokë. Nisur nga kjo, kishte thënë: “Ky është prej atyre që Allahu i Madhëruar ka kërkuar t'i ndihmojmë duke thënë: **“Ose të varfrin e mjerë.”** (Beled, 16) Allahu i Lartësuar e përmend të varfrin dy herë ngaqë myslimanët nuk i ndihmojnë të varfrit aq sa kërkohet. Ndërkohë myslimani duhet ta dijë se ngritje-zbritjet e kësaj jete kalohen duke i ndihmuar të varfrit. Këto janë gjërat që e çojnë njeriun në xhenet dhe që e bëjnë të lumtur edhe në jetën e kësaj bote. Allahu Teala, për t'i inkurajuar njerëzit në lidhje me këtë, para se të tregojë se cilat janë ngjitje-zbritjet e jetës, njofton se njeriu nuk tenton për t'i kaluar këto ngjitje-zbritje. Në të njëjtën kohë, edhe ky hadith fisnik që transmetohet nga i Dërguari i Allahut (a.s.), tregon se atyre që përpiqen t'i kalojnë këto ngjitje-zbritje, u hiqen disa cilësi të këqija.

Një burrë shkoi te i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem dhe iu ankua nga ashpërsia e zemrës së tij. I Dërguari i Allahut, alejhi's-salatu ve's-salam, i tha:

“Ledhato kokën e jetimit dhe jepu për të ngrënë të varfërve.” (Ahmed bin Hanbel, Musned, 5, 250.)

Islami interesohet për botën e jashtme të njeriut aq sa interesohet edhe për botën shpirtërore të tij. Nisur nga ky këndvështrim, Islami përpiket që ta zhdukë çdo vështirësi në shoqëri. Islami i rregullon rregullat e shoqërisë, sepse njeriu është një qenie sociale. Njeriu e ka të pamundur të qëndrojë i ndarë nga të tjerët. Ngaqë njeriu është qenie sociale, duhet t'i rregullohen edhe dispozitat e jetës shoqërore. Ja, në këtë pikë ndërhyt Islami. Vendos kufijtë dhe jep urdhra për të siguruar një jetë të qetë në shoqëri. Këto urdhra mundësojnë daljen në pah të myslimanëve të sinqertë. Nëse myslimani nuk është i sinqertë, nuk mund të lirojë robër, nuk mund të japë kur është në vështirësi, nuk mund të përkujdeset për asnjë përveç vetes së tij dhe nuk mund t'ia ledhatojë kokën jetimit. Kur të vijë në një gjendje që s'i bën dot këto, atëherë bëhet neglizhent dhe i duket e vështirë jeta e ahiretit, sepse sprovat që përmendëm më lart, kërkojnë përpjekje serioze dhe dhënie nga pasuria për hir të Allahut për të fituar ahiretin me punë të mira pa pasur ndonjë interes material te ato. Të japësh është e vështirë. Allahu Teala i jep njeriut në mënyrë të pakufishme, por njeriu është koprrac dhe nuk dëshiron që të ndajë me të tjerët edhe gjysmën e bukës. Kur Allahu i Madhëruar flet për ngjitje-zbritjet (sprovat) e jetës, shprehet se nuk është e mjaftueshme që njeriu thjeshtë të thotë se ka besuar, madje kjo nuk ka asnjë kuptim, prandaj, e rëndësishme është që të kalohen këto sprova. Këto ngjitje-zbritje kalohen duke shpenzuar prej gjerave materialo-shpirtërore. Siç nuk jetohet në këtë botë pa fituar para, edhe ahireti nuk fitohet pa harxhuar para dhe pa bërë vepra të mira vullnetarisht dhe pa e sensibilizuar zemrën për këto punë. Këtë duhet ta bëjmë sado që nefs i nuk e pranon...

Lum për ata që ia imponojnë bindjen nefsit, i kalojnë ngjitje-zbritjet e jetës dhe fitojnë ahiretin!..

“Ju jeni populli më i mirë, i dalë për njerëzimin:
(sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira,
i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun.
Sikur ithtarët e Librit të besonin, do të ishte më mirë për ta;
ka prej tyre besimtarë të vërtetë, por shumica
e tyre janë larg udhës së drejtë.”

(Ali Imran, 110)

Ky ajet, përkrah vlerësimit që i bën bashkësisë islame për statusin madhështor që zotëron në krahasim me bashkësitë e tjera, e ngarkon edhe me shumë përgjegjësi.

“Ju jeni populli më i mirë, i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun.”

Bashkësia islame duhet ta vlerësojë dhe respektojë nderimin që i bën Allahu, duke e konsideruar si bashkësinë më të dobishme për të gjithë njerëzimit. Në të njëjtën kohë, kjo bashkësi islame është e ngarkuar edhe me detyrën për të udhëhequr njerëzimin drejt paqes universale. Por që bashkësia islame të arrijë këtë pozitë, duhet të plotësojë disa kushte, sepse kjo pozitë mund të meritohet vetëm mbas përpjekjeve të mëdha. Nga pikëpamja e teorike (besimi) dhe sistemi social, bashkësia islame është plotësisht e denjë për këtë pozitë, por nuk mjafton vetëm kjo. Përkrah kësaj, për të përfaqësuar denjësisht vullnetin e Allahut në tokë, duhet zotëruar dhe zhvilluar më tej shkenca dhe teknologjia, si dhe çdo gjë që sjell dobi për njerëzit. Nëse kjo bashkësi ndjek me përpikëri metodën hyjnore dhe sjell në vend atë që kërkohet prej saj, Allahu e lartëson këtë bashkësi në të gjitha fushat. Rruga e arritjes së kësaj pozite është e mbushur me vështirësi, por megjithëse e vështirë dhe me pengesa, është e domosdoshme të formohet dhe të ruhet një mënyrë jetese sipas vullnetit të Allahut.

Për të përcaktuar saktë të mirën dhe të keqen, është i domosdoshëm besimi.

Në kohën kur kriteret që përcaktojnë të keqen dhe të mirën ndryshojnë brenda ditës, është e domosdoshme të mbështemi në kriteret hyjnore, sepse mënyra e jetesës së bashkësive të tjera nuk është kriter për përcaktimin se çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe. Botëkuptimi islam me burim hyjnor, qartëson pozitën dhe rolin e njeriut në tokë, duke formuar marrëdhënie harmonike ndërmjet krijuesit, natyrës dhe njerëzve. Pra, për të pasur sukses, duhet një besim i fortë, sepse gjatë rrugës, bashkësia islame do të përballlet me vështirësi dhe armiq të shumtë dhe, i vetmi tek i cili mund të mbështetet, është Allahu. Nxitja për mirë dhe ndalimi nga e keqja, është detyrë e bashkësisë islame dhe, nëse nuk e realizojnë këtë detyrë, nuk e meritojnë emrin mysliman në kuptimin e plotë të fjalës.

“Sikur ithtarët e Librit të besonin, do të ishte më mirë për ta; ka prej tyre besimtarë të vërtetë, por shumica e tyre janë larg udhës së drejtë.”

Kjo është shprehje inkurajuese ndaj ithtarëve të librit për të pranuar fenë islame, sepse besimi në fenë islame do t’u sillte dobi në këtë botë dhe në botën tjetër.

“...ka prej tyre besimtarë të vërtetë, por shumica e tyre janë larg udhës së drejtë.”

Me këtë citat të fundit të ajetit, Allahu (xh.sh.), shpjegon gjendjen e atyre që besuan dhe janë vepërmirë, duke i vlerësuar për aktin e kryer.

Xhabiri, (r.a.) transmeton se Resulullahu (a.s.):

Kaloi nëpër treg, kurse njerëzit ishin tubuar rreth tij. Pastaj ndaloi pranë një cjapi të ngordhur me veshë të vegjël, e kapi për veshi dhe tha: "Cili prej jush dëshiron ta marrë për një dërhëm?" I thanë: "Asnjëri nga ne nuk jep gjë për të, çfarë mund të bëjmë me të?" Pastaj tha: "A e doni të jetë juaji (falas)?" Thanë: "Pasha Allahun, edhe të ishte i gjallë, ishte me të meta, për arsye se ka veshë të vegjël e jo më i ngordhurl" Atëherë tha: "Pasha Allahun, vërtet për Allahun kjo botë është më e pavlefshme sesa ky (cjav) për ju."

(Muslim, Zuhd, 2)

Profeti (a.s.), interesohej për çdo gjë që kishte përreth dhe çdo gjë që e shihte të vlefshme e përdorte si material edukimi. Një nga këto shembuj e shohim edhe në këtë hadith fisnik.

Kapja prej veshi e një cjapi të ngordhur dhe tërheqja e vëmendjes së njerëzve tek ai, dëshmon për pavlefshmërinë e asaj gjëje. Megjithatë, ai (a.s.), i pyeti sahabët se për sa dërhëm do ta blinin atë cjav. Por dihej mirë se askush nga ata që ndodheshin aty nuk do t'i jepte ndonjë vlerë dhe nuk do ta blinte. Dhe me të vërtetë askush nuk doli e ta blinte atë cjav. Madje ata nuk pranuan ta merrnin dhe falas. Në fakt, kjo ishte ajo që edhe pritej të ndodhte. Mbi të gjitha, sahabët u shprehën se nuk do ta dëshironin atë edhe sikur të ishte i gjallë, sepse ishte një kafshë me të meta, pra, i kishte veshët e vegjël. Kjo ishte ajo që donte edhe Profeti (a.s.), sepse ky rast ishte i përshtatshëm për mësimin që donte t'i jepte shokëve të vet.

Duke u nisur nga ky refuzim, u tha sahabëve se vlera e kësaj bote tek Allahu ishte më e vogël se sa vlera e këtij cjapi që ndodhej para tyre. Kështu që i këshilloi myslimanët se nuk duhej të mashtroheshin nga të mirat dhe pasuritë e përkohshme të kësaj bote. Gjithashtu

i lajmëroi se për shkak të vlerës së pakët të kësaj bote, Allahu Teala, atyre që punojnë dhe mundohen, do t'u japë prej kësaj bote pa bërë dallim midis besimtarëve dhe mohuesve. Kjo është drejtësia e Allahut. Për këtë arsye Allahu u jep pasuri mohuesve që punojnë shumë në krahasim me myslimanët që punojnë pak apo aspak. Mirëpo, mirësitë e botës tjetër nuk janë të tilla. Ato kanë shumë vlerë tek Allahu Teala dhe ato do t'i falë besimtarëve të cilët i vlerësonin të mirat e botës tjetër që në këtë botë.

Kjo nuk do të thotë që besimtarët të ndërpresin lidhjet me këtë botë. Përkundrazi, ata të zotërojnë prej të mirave të kësaj bote, por të besojnë dhe të mos harrojnë se ato që zotërojnë janë të përkohshme dhe se nuk do t'i zotërojnë ato përjetësisht.

MËSIMET QË NXJERRIM NGA HADITHI:

1. Profeti (a.s.), ka shfrytëzuar çdo rast për të edukuar sahabët.
2. Ashtu si cjapi i ngordhur nuk ka vlerë në sytë e njerëzve, ashtu edhe kjo botë nuk ka vlerë tek Allahu Teala.
3. Njerëzit nuk duhet të kapen pas kësaj bote sikur të ishte e përjetshme.

Një Hadith



LUMTURIA FAMILJARE

TË DREJTAT E FËMIJËVE

(Sipas një transmetimi) një ditë Mevlana pa vajzën e tij Melike Hatun duke qortuar një shërbëtore. Ai e këshilloi duke i thënë:

“- Përse po e rëndon atë me fjalë? Çfarë do të bëje ti nëse do të ishe shërbëtorja e saj? Bija ime, askush nuk mund të jetë në kuptimin e vërtetë të fjalës robi apo shërbëtori i dikujt tjetër përveçse i Allahut. Ata që të shërbejnë sot nuk mund të jenë kurrë robërshat tuaja, por vetëm motrat tuaja.” (Eflâkî, Âriflerin Menkıbeleri, v. I, fq. 626)

Fëmijët u janë besuar prindërve të tyre.

Prindërit gjithashtu u janë besuar fëmijëve të tyre. Fëmijët dhe prindërit kanë detyrime dhe të drejta kundrejt njëri-tjetrit.

Rritja dhe edukimi i fëmijëve në formën më të bukur dhe përkujdesja ndaj tyre është një tipar i natyrshëm i njeriut nisur nga fakti se fëmijët përbëjnë një vazhdimësi të prindërve pas vdekjes së tyre.

Mendimtari i njohur Mevlana këtë tipar të natyrshëm të njeriut lidhur me shqetësimin për të ardhmen e brezit të ri e shpreh me fjalët:

“Fëmija është sekreti i prindit. Për këtë arsye njerëzit në përgjithësi u mësojnë fëmijëve tiparet e tyre të karakterit. Kur trupat e tyre groposen dhe humbasin nga sytë, ata dëshirojnë që këto tipare të mbesin në këtë botë përmes fëmijëve të tyre. Krijuesi Fuqiplotë u ka dhuruar prindërve

dëshirën dhe ambicien e madhe të edukojnë dhe të rrisin fëmijët e tyre.”

Fëmijët janë si fletë të bardha!

Mbushja e tyre me besim, vepra të mira dhe moral të bukur është detyrë e prindërve.

Nisur nga kjo le të kujtojmë disa çështje në lidhje me detyrat e prindërve:

DETYRAT E PRINDËRVE

1. Së pari, prindërit duhet t'i vendosin fëmijës një emër të bukur, sepse emri ndikon tek njeriu dhe karakteri i tij.

I Dërguari i Allahut ka thënë:

“Ditën e Kijametit do të thirrreni me emrin tuaj dhe emrin e baballarëve tuaj. Atëherë vendosni emra të bukur.” (Ebû Dâvûd, Edeb, 69)

I Dërguari i Allahut i ndryshoi emrat e pakuptimtë në emra me kuptime të bukura.

“Një ditë Pejgamberi ﷺ solli një deve femër dhe pyeti se kush do ta milte? U shfaqën dy persona me emrin Murre (i hidhur), por Pejgamberi ﷺ u tha:

“-Uluni!”

Më pas erdhi një i tretë me emrin Xhemre (flakë), por edhe atij i tha:

“-Ulu!”

Pastaj erdhi një sahabi me emrin Jaish (jetë) dhe si përfundim mori detyrën. (Taberânî,



Múxhem, XXII, 277; Muvatta', Isti'dhân, 24)

Fatkeqësisht sot u vendosen fëmijëve emra të pakuptimtë që nuk krijojnë asnjë ndjesi shpirtërore.

Ne duhet t'u vendosim fëmijëve tanë emrat e pejgamberëve, të bashkëshorteve të tyre, të sahabeve, të njerëzve të mirë e të devotshëm, emra cilësish të lavdëruar në Kuranin Fisnik apo çdo emër tjetër që ka një kuptim të bukur.

2. Qasja me një vëmendje të veçantë ndaj edukimit fetar përbën thelbin e besimit. Duhet t'u mësojmë fëmijëve se kjo jetë është një botë e sprovave.

Mënyra më e përsour për t'u dhuruar fëmijëve këtë edukim është dërgimi i tyre në medrese apo në kurse të ndryshme fetare. Përzgjedhja e ambienteve të tjera mësimore me qëllim arritjen e rehatisë së kësaj bote me shqetësimin e një të ardhmeje profesionale përbën një përgjegjësi të madhe për prindërit për sa kohë këto ambiente frekuentohen nga një gamë nxënësish dhe mësuesish të papërshtatshëm.

Nuk duhet harruar që jeta e vërtetë është jeta e Ahiretit. E ardhmja e vërtetë është Ahireti. Dituria e vërtetë është njohja e Krijuesit (marifetullah).

“Të ardhmen në këtë botë ta ketë të ndritur,

edhe pse në botën tjetër fytyra do i nxihet.”

Prindërit të cilët duhet të investojnë së paku 15-20 vjet për edukimin e fëmijëve të tyre në mënyrë që ata të fitojnë një profesion që do ta praktikojnë për 30-40 vjet në jetën e kësaj bote, duhet të peshojnë mirë rëndësinë e edukimit shpirtëror që do u vlejë fëmijëve pafundësisht në jetën e përtejme. Nisur nga kjo, të mjaftuarit me një kurs fetar njëmuja përbën një qasje nënvlerësuese ndaj edukimit kuranor dhe islam.

U deshën 23 vjet që Kurani të zbriste, të mësohej dhe të praktikohej nga sahabet e nderuar. Në Islam kërkimi i diturisë zgjat nga djepi deri në varr.

Kur bëhet fjalë për edukimin fetar të fëmijëve sot është e nevojshme t'i kush-tohet rëndësi edhe burimit të këtij edukimi sepse fatkeqësisht rrymat moderniste dhe historicizmi po krijojnë ndikimin e tyre edhe ndaj edukimit fetar.

I Dërguari i Allahut i ka thënë Abdullah bin Omerit:

“O Ibn-i Omer! Përqafoje fort fenë tënde, përqafoje fort fenë tënde! Sepse ajo është edhe mishi edhe gjaku yt. Kujdes nga kush e mëson fenë tënde! Shkencat dhe dispozitat fetare t'i mësosh nga dijetarët e devotshëm, jo nga ata që orvaten majtas djathtas për interesat e kësaj bote!” (Hatib el-Bagdadi, el-Kifaje fi Ilmi'r-Rivaje, el-Medinetu'l-Munevvere,

Fëmijët lindin me një ndjenjë naiviteti dhe pastërtie të denjë për xhenetin. Mirëpo nëse prindërit e lënë pas dore edukimin e tyre shpirtëror atëherë ata zogj të xhenetit mund t'i orientojnë në një drejtim të gabuar.

el-Mektebetu'l-Ilmijje, fq. 121)

3. Nën timer dhe baballarët duhet të shfaqin sjellje të bukura shembullore ndaj fëmijëve të tyre. Në të kundërt fëmijët që rriten në ambiente grindjesh dhe mosmarrëveshjesh, reflektojnë në karakterin e tyre një lloj trishtimi dhe rebelizmi. Ndërsa ata të cilët rriten në një ambient të paqte dhe të ekuilibruar fitojnë tipare të bukura dhe rriten të edukuar.

4. Sjellja e fëmijëve duhet të kontrollohet pa u ndier prej tyre. Ata nuk duhet të lejohen të sillen ndryshe kur janë vetëm, e ndryshe në prani të prindërve.

Prindërit nuk mund ta përmbushin detyrën e tyre duke thënë: “Unë i dërgoj fëmijët në medrese prandaj nuk kam më detyrime ndaj tyre.” Tërheqja mënjane dhe qëndrimi në një plan dytësor në çështjen e edukimit të fëmijëve përdiskutim përbën një qasje të gabuar. Përkundrazi, prindërit përveç përzgjedhjes së një ambienti të duhur arsimor, duhet të jenë përherë vigjilent ndaj ambientit shoqëror të fëmijëve të tyre. Kështu në hadithin profetik thuhet:

“Njeriu është në fenë e shokut të tij. Prandaj secili prej jush le të jetë i kujdesshëm me kë shoqërohet!” (Ebû Dâvûd, Edeb, 16/4833)

Nisur nga kjo, secili nga ne duhet të thellohet në mesazhin e këtij hadithi profetik:

“Të gjithë ju jeni çobanë dhe përgjegjës të tufës suaj.”

Burri është çoban i familjes së vet dhe përgjegjës i tufës së tij.

Gruaja është çobaneshë e familjes së saj dhe përgjegjëse e tufës së saj.” (Buhârî, Vesâjâ, 9; Muslim, Imâre, 20)

Vërtet;

Çobani e ndjen gjendjen shpirtërore të kopesë së vet.

Çobani e kullot tufën në një tokë të begatë, e çlodh dhe e ushqen. Nuk e çon në tokë të thatë.

Me fjalë të tjera, prindërit duhet t'i ushqejnë shpirtërisht fëmijët e tyre dhe t'i dërgojnë në ambiente të përshtatshme ku mund ta marrin këtë ushqim shpirtëror.

Çobani e ruan kopenë e vet nga çdo kafshë grabitqare.

Prandaj, një prind duhet ta mbrojë fëmijën e tij nga çdo e keqe (nga gjërat që Allahu i ka ndaluar, nga droga, nga rrugët e gabuara të internetit, televizionit, modës dhe reklamave).

Çobani nuk e lë në mëshirë të ujqërve qoftë edhe një qengj të sëmurë, por e merr atë në krahë dhe e përfshin në tufë.

Prindërit krahas namazit duhet t'u mësojnë fëmijëve edhe mëshirën edhe dhembshurinë. Sepse mëshira është fryt i namazit.

Çobani përherë e kontrollon tufën për të cilën është përgjegjës herë nga para herë nga mbrapa.

Sepse;

Zemra nuk mund të qëndrojë e zbrazët. Nëse ne nuk arrijmë të mbushim zemrën e fëmijëve tanë, atëherë do ta mbushin të tjerët. Për këtë arsye krahas edukimit formal duhet t'i kushtojmë rëndësi edhe edukimit informal.

Me pak fjalë:

Nëse duam që fëmijët tanë të kenë një të ardhme të ndritur atëherë duhet t'i edukojmë me mirësi dhe përkushtim.

5. Duhet t'i vlerësojmë dhe t'i shpërblejmë fëmijët kur ata bëjnë punë të mira dhe të dobishme. Imam Maliku përbën një shembull të bukur në këtë çështje. Babai i bënte një dhuratë sa herë mësonte një hadith përmendsh. Erdhi një kohë që ai kënaqej sa herë mësonte një hadith të ri edhe pse tanimë babai nuk i bënte më dhurata.

Gabimet e fëmijëve duhet të ndreqen me një gjuhë të ëmbël dhe duhet bërë përpjekje që të mos përsëriten më.

Dhembshuria prindërore nuk duhet të jetë shkak që të mbyllet një sy ndaj gabimeve të fëmijëve dhe të mos qortohen për gabimet e tyre. Nuk duhet harruar që Krijuesi Fuqiplotë është Mëshirues, Mëshirëplotë dhe Ai ka urdhëruar ato çështje për të cilat njerëzimi ka nevojë. Do të ishte lajthitje e madhe për njeriun të vepronte sikur të ishte më i mëshirshëm se Ai.

Për shembull, të mos e zgjosh nga gjumi për të falur namazin e sabahut një të ri që ka arritur moshën e pjekurisë nuk është mëshirë, përkundrazi është mungesë mëshire.

Mevlana mëshirën e Mëshiruesit e shpreh me fjalët:

“Nënave ua mësova Unë dashurinë amësore. Mendo pak si është mirësia dhe dashuria që kam zgjuar në zemër...”
(Methnevi)

6. Fëmijëve nuk duhet t’u jepen dënime pa kriter, sepse kjo mund të krijojë një efekt të padëshiruar. Këta fëmijë në vend që të heqin dorë nga një sjellje jo e hijshme, e kthejnë atë në një ves të keq sa që asnjë këshillë nuk u bën më dobi.

7. Urdhëresat, ndalesat, rregullat dhe çdo çështje tjetër e fesë, fëmijëve duhet t’u mësohen në një mënyrë të kuptueshme dhe të qartë, në përputhje me nivelin e tyre të kuptuarit.

8. Është shumë e rëndësishme të tregohemi të kujdesshëm ndaj rregullave të mirësjelljes. Nëna dhe babai duhet të shfaqin modelin më të bukur në mënyrë që fëmija të fitojë personalitetin dhe identitetin e duhur dhe të rritet i sjellshëm dhe i edukuar.

I Dërguari i Allahut u martua me Ummu Se-

lemen e cila ishte e ve dhe mori përsipër edukimin e fëmijëve të saj.

Një nga këta fëmijë, Ebu Hafsi tregon:

“Unë isha një fëmijë që u rrita nën përkujdesjen e Pejgamberit a.s.. Kur ulesha për të ngrënë dora ime shëtiste në të gjitha anët e pjatës. Atëherë i Dërguari i Allahut me tha:

–O djalosh! Thuaj bismilah (me emrin e Allahut)! Ha me dorë të djathtë! Ha në pjesën (e pjatës) para teje!

Që nga ajo ditë kam ngrënë ashtu siç më ka mësuar ai.” (Buhârî, Et’ime 2-3; Muslim, Eshribe 108, Ibn-i Mâxhe, Et’ime, 8)

9. Fëmijëve duhet t’u lejohej ta jetojnë fëmijërinë e tyre brenda kufijve legjitimë. Por nga ana tjetër është e nevojshme që këto kufij të përcaktohen në mënyrë të duhur.

Kur i Dërguari i Allahut emigroi në Medinë, nëna e Enes Bin Malikut i kërkoi Pejgamberit të pranonte djalin e saj 10 vjeçar që t’i shërbente. Mirëpo një fëmijë i kësaj moshe ishte e pamundur t’i shërbente një profeti.

Sidoqoftë, i Dërguari i Allahut e pranoi kërkesën e asaj nëne me qëllim që të na mësonte se si duhet edukuar një fëmijë.

Enesi tregon që shpesh ai harronte detyrat me të cilat ishte ngarkuar dhe përfshihej në lojëra, por asnjëherë i Dërguari i Allahut nuk e qortonte, përkundrazi sillej me butësi dhe dashuri ndaj tij.

Kur i Dërguari i Allahut falej si imam në xhami, vinin nipërit e tij, Hasani dhe Husejni dhe kur ai ishte në sexhde ata i hipnin mbi shpinë.

*Ne duhet të
shqetësohemi
për të ardhmen e
brezit. Duaja e Hz.
Ibrahimit e shpreh
kaq bukur këtë
ndjenjë merakosjeje:
O Zoti im, bëj që unë
dhe pasardhësit e mi
të kryejmë përherë
namazin!
(Ibrahim, 40)*

Por, i Dërguari i Allahut nuk i trazonte, priste në sexhde derisa ata të uleshin. (Hejsemî, IX, 175)

Kjo sjellje e Pejgamberit na mëson dy gjëra:

- Dashuria dhe dhembshuria ndaj nipërve.
- Bërja e namazit të dashur.

10. Fëmijët duhet të mësohen të meditojnë rreth mirësive të panumërta të Krijuesit Fuqiplotë. Ata duhet të mësohen ta falënderojnë Allahun e Lartësuar, ta lavdërojnë Atë dhe të nisin çdo punë me emrin e Tij.

Kur një nga fëmijët e Abdulmutalibëve fillonte të fliste, i Dërguari i Allahut i mësonte ajetin 111 të sures Isra duke ia përsëritur atë 7 herë. (Abdurrezzâk, IV, 334; Ibn-i Ebî Shejbe, I, 348)

“Thuaj: “Çdo lavd e falënderim i përket Allahut, i Cili nuk ka bir, nuk ka ortak në pushtet dhe nuk është i pafuqishëm, që të ketë nevojë për ndihmës” dhe madhëroje Atë, duke ngritur lart madhështinë Tij!” (Isra, 111)

Imam Rabbani i mësonte me ngulm fëmijët e tij që ta përmendnin Krijuesin Fuqiplotë. Në një letër drejtuar të birit Muhamed Masum, thotë:

“Është koha për dhikër. Të gjitha prirjet dhe dëshirat egoiste vendosi brenda fjalës «ل» që të mund t’i çrrënjosësh e të mos biesh pre e tyre. Kënaqu me caktimin e Allahut të Lartësuar!

Kur të shqiptoni pjesën ‘përveç Allahut’ në fjalën e dëshmisë, meditoni rreth madhështisë së Allahut që është përtej çdo imagjinate dhe diturie dhe përbën për ne një mister. Mos e humbni kohën pas shtëpive, pallateve, pasurive e sa e sa gjërave të tjera që ju thërrasin drejt kësaj bote.»

11. Fëmijët duhet të mësohen që në moshë të re ta duan adhurimin dhe të ndjejnë kënaqësi nga shërbimi në rrugë të fesë.

Ibrahimi me të birin Ismailin ndërtuan Qaben dhe e pastruan atë së bashku.

Sahabet e nderuar agjëronin në Ditën e Ashures bashkë me fëmijët e tyre dhe i jepnin atyre lodra në duar që të mund ta kalonin kohën deri në yftar.

Babai im i ndjerë Musa Efendiu na shëtiste në vende historike dhe shpirtërore dhe pasi kishte ndarë ca para kërkonte nga ne që t’ua dhuronim njerëzve në nevojë që rrinin në oborret e xhamisë Ejub Sulltan, Ullu Xhami apo Emir Sulltan. Ne vraponim për të kryer këtë shërbim dhe gëzoheshim me lutjet e atyre njerëzve të vuajtur.

Po ashtu duhet të ngulisim në shpirtin e fëmijëve tanë dashurinë për atdheun, forcën e besimit dhe guximin.

12. Dashuria është themeli i edukimit të fëmijëve. Ne si prindër duhet të bëhemi të dashur tek fëmijët tanë dhe po ashtu t’ua bëjmë të dashur atyre Krijuesin Fuqiplotë dhe të Dërguarin e Tij.

I Dërguari i Allahut ka thënë:

“Edukoni fëmijët tuaj në tre aspekte:

Dashurinë ndaj Profetit, dashurinë ndaj Ehli Bejtit dhe leximin e Kuranit...” (Munâvî, I, 226)

Fatkeqësisht pushtimi i huaj kulturor po mësyn në zemrat e fëmijëve tanë. Rrezikun e drejtimit në rrugë të kundërta nga rruga profetike e



dashurisë dhe devotshmërisë, Mevlana e shpreh me fjalët:

“Kush synon një sofër tjetër pos sofrës së dijes së Profetit, ta dijë që s’ka për të kaluar asgjë poshtë gërmazit.

Kush shkon në një tryezë tjetër përveç tryezës së Profetit, ta dijë se shejtani do të hajë me të në të njëjtën enë.

Kush largohet nga fqinjësia me të ❸, nuk ka dyshim se shejtani bëhet fqinj i tij.

Kush nisat në një rrugë të largët pa të ❹, atëherë shoqëruet do ketë shejtanin.

Edhe në qoftë duke kalëruar një kalë të sojit përsëri lakmia ndaj njerëzve të fisshëm do ta mendojë, sepse tashmë djalli i është qepur pas.

O mik! Allahu i Lartësuar na bëri të ditur se kush ndjek shejtanin, ai do të bëhet pjesë në pasurinë dhe fëmijët e tij. (Isra, 64)

Allahu na ruajtë nga ortakëria me shejtanin e mallkuar.

13. Me pak fjalë, nëse duam të rrisim një fëmijë të përsosur, fillimisht ne si prindër duhet të jemi të përsosur.

Prindërit në përgjithësi nisur nga një ndjenjë e natyrshme e shqetësimit për të ardhmen, dëshirojnë t’i lënë një trashëgimi fëmijëve të tyre në mënyrë që të mos vuajnë nga varfëria apo skamja.

Por e vërteta është se trashëgimia e vërtetë është trashëgimia shpirtërore. Pra, edukimi me një karakter dhe personalitet islam.

Nëse prindërit arrijnë t’i brumosin fëmijët e tyre me këtë formim shpirtëror, atëherë këta fëmijë do jenë të aftë ta përdorin siç duhet edhe trashëgiminë materiale duke e bërë atë mjet për të arritur Jetën e Përtejme, pa u llastuar me pasuri dhe pa rënë në rrugë të gabuara.

Në të kundërt, trashëgimia materiale pa atë shpirtërore do bëhet shkak që fëmijët të kalojnë çdo kufi duke e shpërdoruar atë pasuri pa kriter, pa falënderuar.

Për t’u mbrojtur nga ky përfundim i dhimbshëm është e nevojshme që prindërit t’i japin rëndësi edukimit shpirtëror.

Nëse prindërit nuk i përmbushin ashtu siç duhet detyrat e tyre, në Ditën e Gjykimit ata do të mundohen të largohen nga fëmijët e tyre.

Në ajetin fisnik thuhet:

“Atë Ditë njeriu do të ikë nga i vëllai, nga e ëma dhe nga i ati, nga e shoqja dhe nga fëmijët e vet.” (Abese, 34-36)

Mirëpo njerëzit e devotshëm do të hyjnë në xhenet së bashku me prindërit, fëmijët dhe bashkëshortet e tyre.

“Xheneti i Adnit, në të cilin do të hyjnë ata dhe BESIMTARËT E NDERSHËM prej prindërve të tyre, grave dhe pasardhësve të tyre.” (Rad, 23)

Allahu i Madhëruar mos na bëftë prej atyre që në Ditën e Gjykimit do mundohen t’u shmangen fëmijëve të tyre si rrjedhojë e shpërfilljes së misionit prindëror.

Na pranofte në xhenetin e Tij të lartë bashkë me fëmijët tanë dhe na mundësoftë të shohim bukurinë e Tij (xhemalullah).

Amin!..

NDARJA, AH NNDARJA



— Mehmet Ali Var —

Allahu i Lartësuar i ka krijuar njerëzit në burra dhe gra, i ka bërë ata si dy gjysmat e mollës, pra, i ka bërë një tërësi dhe nevojtarë për njëri-tjetrin, i ka bashkuar ata sipas rregullave të Islamit dhe i ka bërë familje. Prej tyre ka krijuar fëmijët, nipërit dhe pastaj shoqërinë. Familja është njëësia më e vogël e shoqërisë që formohet nga nëna, babai dhe fëmijët. Gjithashtu ajo është një institucion që feja jonë e konsideron të shenjtë. Familja është mjedisi ku njeriu gjen prehje, është mundësia për vazhdimësinë e brezit dhe mirësia e mëshirës së Krijuesit ndaj nesh. Në Kuranin Fisnik thuhet:

“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë.” (Rum, 21)

Njerëzit e arrijnë prehjen me martesën. Edhe pse thuhet se “beqaria është mbretëri”, në të vërtetë është një gjendje në të cilën njeriu ndjehet i paplotësuar. Beqaria është në kundërshtim me natyrshmërinë e njeriut. Në fenë tonë martesë inkurajohet në mënyrë të veçantë. I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: *“Martohuni dhe shtohuni! Unë do të lavdërohem me mizërinë tuaj kundrejt umeteve të tjera në Ditën e Kiametit.”* (Ebu Davud, Nikah, 4.)

Kur studioja në fakultet para disa vitesh, e pata pyetur Profesor Hajrettin Karamanin, në lidhje me këtë hadith. Ai më pati thënë: “Po, është e vërtetë, por i Dërguari i Allahut (a.s.), thotë se “do të lavdërohem me mizërinë e umetit tim”. Prandaj duhet

t’i edukojmë njerëzit dhe të bëhemi umet. Profesori ka edhe një fjalë tjetër të tillë:

“Çdo familje më e pakta duhet të ketë tre fëmijë. Njëri për nënën, tjetri për babain dhe tjetri për atdheun.” Siç edhe kuptohet, ne duhet të edukojmë breza të artë të cilët mund të bëhen umet. Për këtë arsye, fëmijëve duhet t’u japim një edukim të mirëfilltë dhe duhet të përpiqemi t’i mbrojmë nga kurthet e ndryshme të kohës. Përsëri i Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, na këshillon në lidhje me këtë çështje: *“Asnjë baba nuk mund t’i japë diçka më të mirë fëmijës së tij se sa një edukim të mirëfilltë.”* (Tirmidhi, Birr, 33.)

Ajo që feja jonë kërkon prej nesh është një strukturë familjare e fortë dhe në harmoni. Por në ditët e sotme ka ardhur vjeshta në këtë vatër të bekuar. Në vatrë familjare që duhet të jenë si bahçe trëndafilash me fëmijë si trëndafila, prindërit po rrinë diku dhe fëmijët po rrinë diku tjetër... Guri themelor i shoqërisë po tretet çdo ditë që kalon. Vendet e prehjes janë shndërruar në vende vuajtjesh dhe të gjithë mendojnë vetëm për veten e tyre. Mirë, por përse vallë ka ardhur në këtë gjendje ky institucion i bekuar?

Para së gjithash, te njerëzit tanë është dobësuar besimi ndaj shenjtërisë së familjes. Botëkuptimi modern, materialist dhe larg devotshmërisë, i ka marrë nën ndikimin e tij të gjithë njerëzit, qofshin besimtarë apo jobesimtarë. Të moshuarit kanë pas thënë: “Në martesë ka mrekulli.” Tashmë ky mendim nuk merret më në konsideratë. Për këtë arsye, është harruar se jeta pa martesë është një humbje

dhe shkatërrim për shpirtin e njeriut dhe shoqërinë. I Dërguari i Allahut, alejhi's-salam, ka thënë: *"Divorci është gjëja që më së shumti nuk e do Allahu ndërmjet gjërave që i ka bërë hallall."* Ndërsa në një transmetim tjetër thotë: *"Divorci është gjëja e lejuar që më së shumti Allahu nuk e do."* (Ebu Davud, Talak, 3.) Kjo këshillë e të Dërguarit të Allahut (a.s.), sikur e ka humbur vlerën e saj për myslimanët. Edhe në një hadith tjetër, Pejgamberi ynë i nderuar thotë: *"Martohuni dhe mos u divorconi!.. Sepse për shkak të divorcit dridhet Arshi..."* (Ali el-Muttaki, IX, 1161/27874.) Ndërkohë që gjendja duhet të jetë e tillë, situata e popullit tonë në kohët e fundit është frikësuese. Në statistikat e bëra shihet me keqardhje se përqindja e divorceve e ka kaluar përqindjen e martesave.

Të rinjtë i kanë bërë t'i harrojnë detyrat e tyre duke u dhënë përparësi gjithmonë të drejtave të grave me anë të shtypit, telenovelave dhe romaneve dhe duke imponuar mendimin që gruaja të bëhet e lirë dhe moderne. Ndërkohë që në Islam bashkëshorti ka detyra si: Të kaluarit mirë me bashkëshorten, të mbrojturit e saj, plotësimi i nevojave të saj për të ngrënë e për t'u veshur, mbajtja e sekreteve të shtëpisë, sjellja e mirë kundrejt familjes së bashkëshortes, etj., edhe bashkëshortja ka detyra kundrejt bashkëshortit të saj si: Të mos marrë brenda në shtëpi njerëz që nuk i do bashkëshorti i saj, të mos zbukurohet për të tjerët përveç për burrin e saj, ta ndihmojë bashkëshortin në punët e tij, t'i bindet në urdhrat e drejtë, t'ia mbrojë pasurinë, t'ia respektojë të afërmit, t'i mbajë sekretet, t'ia mbrojë nderin, namusin e dinjitetin dhe të mjaftohet me atë që posedojnë.¹

Autoritetet e kanë shtypur mashkullin ndërkohë që mendojnë t'i bëjnë diskriminim pozitiv gruas. Disa gra këtë e kanë përdorur si presion psikologjik. Kjo gjendje e ka acaruar edhe më shumë mashkullin. Burri, i cili është edhe kryetari i shtëpisë në të njëjtën kohë, të paktën në të kaluarën kështu ka qenë, i ka harruar përgjegjësitë që ka kundrejt familjes dhe është shndërruar në një njeri të padurueshëm dhe agresiv. Debatet që mund të bëhen në çdo shtëpi, i ka shndërruar në zënka, madje edhe në tragjedi që mund të shkojnë deri në plagosje dhe vrasje. Si është bërë kaq barbar njeriu ynë sa që mund ta vrasë përpara syve të fëmijëve bashkëshorten e tij me të cilën e ka vendosur kokën në një jastëk? Si mund të ndodhë kjo ndërkohë që përpara syve tanë kemi hadithin e të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili thotë:

"Ju i keni marrë gratë si amanet i Allahut. Nderin

dhe namusin e tyre e keni bërë hallall (jeni martuar me to) duke dhënë fjalën në emër të Allahut." (Muslim, Haxh, 147.)

Që kur të hidhet themeli i familjes nuk duhet të neglizhohen cilësitë e mira si fetaria, në mënyrë që familja të jetë e qetë dhe të premtojë vazhdimësi. Gjithashtu nuk duhet të harrohet se rëndësia e pasurisë dhe bukurisë arrijnë deri diku. Dasmat tona duhet të jenë ceremoni modeste me hijeshi e nur dhe larg çdo lloj shpenzimi të tepërt, shtirjeje dhe ekzagjerimi. Dihet qartë se familjet që formohen mbi borxhe të rënda në të ardhmen do të përjetojnë lëkundje.

Ndërmjet shkaqeve të divorceve mund të përmenden problemet si mosmarrëveshjet ndërmjet bashkëshortëve, zakonet e këqija, xhelozia e tepëruar, sëmundjet kronike, ndërhyrja e prindërve ndaj të rinjve të martuar, kërkesat e pakufishme, papërpunueshmëria, mungesa e edukimit, vështirësitë ekonomike, etj., por institucioni i familjes është një institucion aq sublim sa që gjërat negative nganjëherë duhet të kalohen me durim. Bashkëshortët duhet t'u vënë kraharorin disa vështirësive, duhet ta lënë egoizmin, kërkimin e qejfeve, individualizmin, etj. dhe të përpiqen për ta mbajtur në këmbë këtë institucion, në mënyrë që fëmijët të mos ngelin pa vatër, pa dashuri dhe pa interesim.

Popujt e shëndoshë qëndrojnë në këmbë me strukturën e familjes së shëndoshë, me zakonet e traditat, me respektin e dashurinë dhe me vlerat e tjera që i posedojnë. Fuqitë dashakeqëse që e dinë mirë se nuk mund ta mposhtin popullin tonë pa ia prishur atij strukturën familjare, vazhdimisht përpiqen që ta shkatërrojnë atë. Për këtë arsye, myslimani duhet të jetë vigjilent dhe duhet ta marrë për shembull strukturën e familjes së të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe të sahabëve të tij. Ai duhet të mjaftohet me atë që i ka dhënë Zoti (xh.sh.), duhet të jetë modest, durimtar dhe i mëshirshëm. Bashkëshortët duhet të marrin parasysh cilësitë e bukura të tyre kundrejt cilësive që nuk u pëlqejnë dhe duhet të përpiqen ta vazhdojnë jetën e tyre pa u influencuar prej erërave negative që fryjnë nga jashtë. Atij që është i ndërgjegjshëm për të mos ua nxirë jetën fëmijëve të cilët të gjitha shpresat i kanë të lidhura me prindërit, nuk mund t'i paguhet haku. Asnjë prej nesh nuk mundet dot të jetojë i vetëm dhe të gjithë ne kemi nevojë për njëri-tjetrin. Pikërisht siç ka thënë edhe poeti:

"Burri ka nevojë për gruan, i riu për të moshuarin dhe harku për shigjetën.

Përfundimisht të gjithë njerëzit kanë nevojë për njëri-tjetrin."

1. Omer Nasuhi BILMEN, Byjykk Islam Ilmihali, Detyrat Familjare, fq. 465; Hadithet e zgjedhura, Botimet e Entit për Çështjet Fetare në Turqi, Ankara 1979, fq. 171-194.



Mëshira

NEVOJA E SHEKUJVE DHE ILAÇI I ZEMRAVE

— Hajretin Durmush —

Lapsi ynë le të fillojë të shkruajë duke përmendur Mëshiruesin më të Madh, Allahun Teala, me shpresë se Ai, më i Larti i të lartëve, do të na mëshirojë. Nëse Ai nuk na mëshiron, atëherë, mjerë për ne...

Mëshira është një zjarr që i djeg zemrat me dashuri. Andaj, zemra duhet të digjet në këtë botë, ashtu që të mos digjet në botën tjetër. Ndërkohë që bëhesh dritë për të tjerët rreth e rrotull, në zemër duhet të hedhësh një shkëndijë pa bërë aspak zë. Bota jote e brendshme duhet të digjet, thelbi yt duhet të përvëlohet dhe zemra duhet të shndërrohet në inkandeshent. Patjetër që duhet të mendosh edhe për të tjerët përveç vetes tënde. Vëllezërit duhet t'i kujtosh gjithmonë. Vetën duhet ta vendosësh në vend të atyre që dhunohen, torturohen dhe jetojnë në vështirësi të mëdha kudo që mund të ndodhen nëpër botë. Zemra jote duhet të jetë aq e gjerë sa t'i strehojë ata që u janë shkatërruar vatrat e tyre. Andaj duhet ta përballosh djegien në vend të gjithë njerëzimit. Natën duhet ta kalosh me një të sëmurë, zogut të plagosur duhet t'ia mjekosh plagën dhe duhet të jesh ortak me britmën e nënës që rreh gjunjët e saj nga fatkeqësia që mund t'i ketë ndodhur. Dhimbja nuk ka adresë. Lotët nuk kanë ngjyrë.

Mëshirë do të thotë shfaqje e dhembshurisë,

keqardhje dhe butësi e zemrës. Andaj, ata që kanë zemrën e ngurtë quhet njerëz të pamëshirshëm. I Dërguari i Allahut (a.s.), ishte mëshirë për botët.

Mëshira e shëron plagën dhe e ndalon dhimbjen. Gjithmonë njerëzit e ndërgjegjshëm kanë qenë ata që i kanë pajtuar të zemëruarit dhe të ngatërruarit. Njerëzit e mëshirshëm janë siguria e shoqërisë.

A nuk hyn drita e ditës në vendet më të humbura dhe të shkreta? A ka ndonjë vend që nuk e ngroh dielli? Dielli i rrethon me ngrohtësinë e tij të gjitha krijesat. Ngrohtësia e tij hyn në vendet më të humbura, në shkretëtira dhe në male. Mëshira është si dielli. Mëshirë do të thotë të shfaqësh dhembshuri ndaj bimëve, luleve, kafshëve që janë në zhdukje e sipër, maleve, gurëve, zogjve etj. Mëshira është më shumë strehim se sa dhembshuri.

Islami është drita dhe dielli që na ndriçon jetën tonë. Ligjet e luftës në Islam janë të mbushura plot me dispozita që t'i mbushin sytë me lot. Mëshirë do të thotë që ushtria, e cila ngelet e detyruar të luftojë, të mos i prekë gratë, fëmijët, të moshuarit, ata që rrinë në shtëpinë e tyre, të mbjellat dhe bimët. Ata që i shkatërrojnë bimët dhe sojin e njerëzve gjithmonë kanë qenë më tiranët dhe më të pamëshirshmit e kësaj bote.



Zemrat janë nxirë, ndërsa bota është verbuar dhe shurdhuar. Edhe nëse tirania e tiranëve i bën gurët e drurët të rënkojnë, ti prapë se prapë shfaq mëshirë për botën pa o lodhur dhe hezituar.

Është e vërtetë se njeriu nuk mund të jetojë pa bukë, pa ujë dhe pa ajër, por nëse nuk ka mëshirë, uji na ngelet në grykë, bukës nuk i ngelet shije dhe frymë nuk mund të marrim edhe nëse ka ajër...

AI QË DO MËSHIRË, LE TË JETË I MËSHIRSHËM...

Arritja e mëshirës është e mundur vetëm me mëshirë. Dielli i dy botëve, i Dërguari i Allahut, Muhamed Mustafa (a.s.), ka thënë:

"Ai që nuk mëshiron, nuk mëshirohet." (Muslim, Fedail, 64.)

"Çfarë mund të bëj unë nëse Allahu ua ka shkullur dhe ua ka marrë mëshirën nga zemrat tuaja?" (Buhari, Edeb, 18.) Në këtë mënyrë, na trondit edhe neve ndërkohë që e qorton Akran. Për këtë arsye, le t'i mëshirojmë të tjerët, ashtu që edhe ne të mëshirohemi.

Nëse nuk do të na mëshironte Rrahmani, i Cili është Mëshiruesi më i madh dhe mëshira e të Cilit ia kalon zemërimit të Tij, do të devijonim në rrugë dhe do të përpëliteshim nëpër errësira. Puset e frikshme dhe errësitat e tmerrshme do të ishin vendet në të cilat do të jetonim. Shejtani do të na hidhte në

kurthet e tij dhe do të lozte me ne si të dëshironte. Vallë, si do të ishte gjendja jonë sikur Allahu, i Cili është Rrahman / i Mëshirshëm, të mos i mëshironte të gjitha krijesat?

Allahu i Madhëruar thotë në ajetin fisnik të 204-t të sures A'raf:

"Kur të lexohet Kurani, dëgjoni dhe heshtni, në mënyrë që të mëshiroheni." Ai që dëshiron të mëshirohet, le të dëgjojë Kuran! Ai që dëshiron të mëshirohet, le të ndriçohet nga drita e Kuranit! A ka përgëzim dhe mirësi më të madhe se kjo?

Allahu i Plotmëshirshëm thotë:

"Besimtarët dhe besimtare janë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat; falin namazin, japin zekatin dhe i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Këta janë ata që do t'i mëshirojë Allahu. Se, Allahu me të vërtetë, është i Plotfuqishëm dhe i Urtë." (Teube, 71)

Në këtë mënyrë, u premtom mëshirë atyre që i binden Atij, atyre që i besojnë ajetet e Atij, atyre që e falin namazin dhe atyre që i binden të Dërguarit të tij.

O Zot! Mbushi zemrat tona me mëshirë! Mos na e shkull dhe mos na e merr dashurinë e mëshirën nga zemrat tona! Përvëloji zemrat tona me dashurinë e vërtetë, në mënyrë që të vijmë me zemra të pastra në audiencën Tënde! O Allah që je Rrahman dhe Rrahim! Ne nuk kemi as dije dhe as vepra të mira. Nuk kemi as fuqi dhe as forcë... O Allah i Lartësuar që ke mëshirë për të gjitha krijesat! Na mëshiro!.. Ne kemi mëkate sa malet. Edhe pse ne nuk e meritojmë, na trajto jo sipas veprave tona, por me mëshirën Tënde, o Zot! Amin!..



SHKAQET E DIVORCEVE

që përjetohen nëpër familje

— Ahmet Zijlan —

MUNGESA E JETESËS DHE KULTURËS ISLAME - DOBËSIA NË BESIM

Allahu i Lartësuar ua ka lënë amanet bashkëshortëve njëri-tjetrit dhe ka thënë:

“Dijani vlerën amanetit dhe mos e tradhtoni!..”

Ai që bën padrejtësi konsiderohet sikur e ka tradhtuar amanetin. Tradhtia ndaj amanetit është njëra prej shenjave të hipokrizisë. Jo vetëm bashkëshorti apo bashkëshortja, por edhe pasuria, fëmijët dhe paratë na janë dhënë amanet.

Madje, edhe jeta jonë...

Kështu që nuk mund të themi: “Kjo është jeta ime. Andaj mund të bëj me të ç’të dua vetë dhe askush nuk mund të përzihet...” Jetën nuk mund ta hedhësh në rrezik. Për shembull, nuk mund ta helmosh veten apo të bësh vetëvrasje në ndonjë lloj mënyre tjetër.

Edhe në lidhje me çështjen e pasurisë mund të themi të njëjtën gjë. Andaj, deri diku mund të themi: “A nuk është kjo pasuria jonë? Për këtë arsye, mund ta harxhojmë si të dëshirojmë...” – sepse, nëse kemi një tokë, jemi të obliguar të përkujdesemi për të. Nëse kemi para, jemi të detyruar që t’i investojmë në gjëra dhe aktivitete hallall.

Allahu i Lartësuar na i ka dhënë këto mirësi si amanet. Gjithashtu na e ka lejuar që t’i përdorim

dhe t’i shfrytëzojmë me kusht që të mos i shpërdorojmë.

Përveç të tjerash, na ka urdhëruar dhe sugjeruar që t’u japim edhe të tjerëve nga fitimi dhe ato që posedojmë dhe na ka njoftuar se do të fitojmë sevape nga të dhënë për hir të Tij.

Nëse i besojmë ekzistencës dhe njësimi të Allahut, që elhamdulillah i besojmë, jemi të obliguar t’i zbatojmë urdhrat e Tij.

Për këtë arsye, njeriu duhet të sillet mirë ndaj bashkëshortes apo bashkëshortit, nuk duhet t’ia përplasë gabimet në fytyrë dhe duhet të shohë anët pozitive të tij/saj.

Andaj, ne duhet të lidhemi me dashuri, duhet të sillemi me butësi dhe nuk duhet t’ia thyejmë zemrën njëri-tjetrit.

Nuk duhet të themi: “Unë e di!”, por: “Ti e di...”

Kur bashkëshortët të bisedojmë me bashkëshortet e tyre duhet t’u flasin me fjalë të bukura dhe vlerësuese si: “E bukura ime, lulja ime, drita ime, engjëlli im, mbretëresha ime...”

Respekti nuk duhet vetëm kundrejt bashkëshortit apo bashkëshortes, por edhe kundrejt prindërve.

Të gjithë jemi njerëz dhe të gjithë mund të gabojmë. Domethënë, asnjë rob nuk është i pagabueshëm.

Robër të pagabueshëm janë vetëm pejgamberët. Ata i ka ndihmuar Allahu që të mos gabojnë.

Për këtë arsye, kanë thënë: “Ai që kërkon shok të pagabueshëm apo partner me moral të përsosur, ngelet pa shok dhe pa partner.”

Allahu Teala ka thënë:

“Unë jam pranë familjes që bën jetë të qetë dhe e ndihmoj atë.”

A mund të shkatërrohet një familje nëse Allahu është ndihmuesi i saj? A mund t'i afrohet shejtani? Andaj, neve na takon që t'i zbatojmë me përpikëri urdhrat e Zotit (xh.sh.) dhe të kapemi fort pas Sunetit të të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Ibadetet duhet t'i kryejmë në kohën e tyre dhe pa mangësi, duhet të jemi shumë të kujdesshëm kundrejt haramëve dhe duhet të qëndrojmë larg shtirjes dhe shpërdorimit të çfarëdo gjëje qoftë ajo.

Përveç të tjerash, duhet ta lexojmë shpesh Kuranin Fisnik dhe jetën e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Duhet të lutemi për veten dhe për të gjithë besimtarët e tjerë. Besmeleja asnjëherë nuk duhet të harrohet nga gjuha jonë dhe çdo punë duhet ta bëjmë në përputhje me pëlqimin e Allahut të Lartësuar. Në një familje të tillë shkaqet e ndarjes dhe të divorcit pakësohen në maksimum.

Siç kemi botën e besimit dhe të përsëritshmërisë, kemi edhe traditën dhe kulturën familjare. Edhe një shkak tjetër i divorceve është neglizhimi i kësaj:

NEGLIZHIMI I KULTURËS DHE EDUKIMIT FAMILJAR

Qytetet, vendet dhe racat kanë kulturat e veçanta të tyre. Gjithashtu, çdo familje ka traditën e saj të veçantë. Këtë traditë, zakon apo kulturë duhet ta mësojmë dhe ta praktikojmë përderisa nuk është në kundërshtim me Islamin. Për këtë arsye, nusja që vjen në shtëpi, duhet t'i dijë këto.

Nënat që kanë vajza, nuk duhet t'i shohin vajzat e tyre sikur të ishin fëmijë të vegjël, por duhet t'i edukojnë. Ato duhet t'i mësojnë vajzat e tyre për të larë rrobat, për të hekurosuar, për të gatuar, për të bërë pastrimin, për të nderuar të tjerët etj. Nënat duhet t'u mësojnë vajzave këto dhe t'i bëjnë t'i praktikojnë.

Nënat që kanë vajza, krahas punëve të shtëpisë dhe shërbimit, duhet t'u mësojnë vajzave të tyre që do dalin nuse edhe rregullat e mirësjelljes si respektin, modestinë, edukatën etj. Gjithashtu duhet t'i mësojnë që ta respektojnë bashkëshortin, vjehrrën dhe vjehrrin, duhet t'i mësojnë që të sillen me edukatë kundrejt tyre, duhet t'i mësojnë që të mos sillen me inat, të mos jenë egoiste dhe gjithmonë të thonë fjalë të ëmbla e të jenë të buzëqeshura.

Nënat vazhdimisht duhet t'u a tërheqin vërejtjen dhe t'i paralajmërojnë bijat e tyre duke u thënë: “Ti do të bëhesh nusja dhe pastaj nëna e asaj shtëpie. Andaj, kjo nuk ka kthim prapa!”

Gjyshja ime e ndjerë gjithmonë na ka pas treguar:

Gjyshja ime kishte pasur gjashtë vajza. Ato i kishte edukuar aq sa e kishte pasur të mundur. Ngaqë njëra prej vajzave do të martohej, ishte interesuar më shumë me të. Kështu që koha erdhi dhe vajza u martua. Pastaj i erdhi koha vajzës së dytë për t'u martuar. Asaj i tha:

“Bijë, edhe ti u fejove. Kështu që do të martohesh. Por ja që të kam neglizhuar shumë.” Vajza ia ktheu:

“Mos u shqetëso nënë. Kur t'i edukojë motrën, unë të dëgjoja me vëmendje. Kështu që kam mësuar edhe unë.”

Kur të respektohen tradita, zakoni dhe rregullat e mirësjelljes, familjet jetojnë në harmoni. Në këtë mënyrë, pakësohen në maksimum gjërat negative të padëshirueshme.

Mbi të gjitha, vëmë re se këto tradita nuk gjenden vetëm në vendin tonë, por edhe në vendet e tjera. Madje, gjenden edhe në vende që nuk janë myslimane...

Tani desha të ndajë me ju një kujtim: Para rreth pesëmbëdhjetë vjetësh, pata shkuar në Kore për një vizitë pune. Përgjatë ngrënies së ushqimit po bisedonim me një ekip marketingu. Personin, i cili ishte kryetari i ekipit, e pyeta:

“Sa para fitoni në muaj nga kjo punë?”

Ai u përgjigj krejt i qetë:

“Fitoj 4000 dollarë. Përveç të tjerash, marrim edhe shpërblim nga puna.”

Atë kohë këto para kishin shumë vlerë. Unë vazhdoja ta pyesja:

**Nënat vazhdimisht
duhet t'u a tërheqin
vërejtjen dhe t'i
paralajmërojnë bijat
e tyre duke u thënë:
“Ti do të bëhesh nusja
dhe pastaj nëna e asaj
shtëpie. Andaj, kjo nuk
ka kthim prapa!”**

“Merrkeni para mjaft të mirë. Në çfarë shtëpie banoni?

Kryetari i ekipit qeshi dhe më tha:

“Sipas traditave tona, kur të martohemi jemi të detyruar të rrimë me prindërit për dy vjet radhazi. Përgjatë kësaj kohe, nusja e ardhur i mëson traditat dhe zakonet e familjes sonë. Pas dy vitesh, mund të dalim në një shtëpi tjetër nëse dëshirojmë. Ne u bënë tetëmbëdhjetë muaj që jemi martuar. Domethënë se kemi edhe gjashtë muaj kohë. Sado që të jemi të pasur dhe sado që të fitojmë para, jemi të detyruar ta zbatojmë këtë rregull.” Unë përsëri i thashë:

“Atëherë, shtëpia e babait tuaj duhet të jetë një shtëpi e madhe...”

Ai përsëri qeshi dhe mu përgjigj:

“Shtëpia e babait tim është tetëdhjetë e shtatë metra katror!...”

Ndërsa unë u mendova dhe ngela i mahnitur.

Tani le të bëjmë një krahasim: Ne jemi myslimanë. Ndërkohë që ne duhet të kemi më shumë respekt dhe të bëjmë kujdes nga shpërdorimi i pasurisë, përkundrazi, nuk mund ta mohojmë se e shpërdorojmë pasurinë tonë në mënyrë mjaft drastike.

Edhe njëri prej

shkaqeve që fëmijët nuk edukohen në lidhje me traditat dhe zakonet e jetës familjare është ky:

Të gjitha familjet në vendin tonë, qofshin të varfra apo me gjendje ekonomike mesatare, i çojnë në shkollë fëmijët e tyre djem dhe vajza. Mësimi fillon që në moshë të vogël. Fëmijët nuk kanë kohë as për të ngritur kokën prej mësimëve. Edhe nëse u del pak kohë e lirë, fëmijët preokupohen me televizorin, me telefonin, ose me internetin dhe lozin. Ata merren kaq shumë me këto, sa që nuk kanë kohë të lëvizin as nga vendi. Prindërit janë të vetëdijshëm për këtë program të ngjeshur të fëmijës. Edhe nëse fëmijët gjejnë pak kohë të lirë, menjëherë fillojnë t'i shtrëngojnë duke u thënë:

“A i ke mësuar mësimet? Përse nuk mëson?”

Ndërmjet të gjitha këtyre, është shumë e vështirë t'i bësh fëmijët të merren me punët e shtëpisë. Fëmija arrin deri në atë gjendje sa që edhe kur dëshiron të pijë ujë, thotë:

“Mami, a mund të më japësh ujë? Edhe nëna ia plotëson dëshirën fëmijës së saj që e do shumë. Në këtë mënyrë, fëmija mësohet jo për të marrë urdhër, por për të dhënë.

Nëna bën pastrimin, nëna shtron sofrën, nëna lan enët... Pasi fëmijët të rriten edhe pak, dora nuk u prek asgjë të nxehtë apo të ftohtë, qofshin djem apo qofshin vajza.

Prindërit duhet të jenë të kujdesshëm në lidhje me këto çështje përderisa fëmijët janë të vegjël. Edhe pse mund të jetë e vështirë, atyre duhet t'u a mësojnë kulturën e familjes, përgatitjen e ushqimit dhe punën.

Pasi të rriten edhe pak dhe ta mbarojnë shkollën, si një ligj i natyrshëm që ka vendosur Allahu Teala, ata martohen. Pasi të martohen, të dy bashkëshortët mund të punojnë ose njëri prej tyre. Gjithashtu, ata nuk mund të marrin ndonjë për t'u bërë punët e shtëpisë me pagesë, sepse të ardhurat nuk u mjaftojnë për këtë. Pastaj fillojnë debatet:

“Ti bërë kështu, unë bëra ashtu...”

Që në fillim të martesës del në pah problemi i divorcit.

Në këtë mënyrë, familja shkatërrohet akoma pa u formuar.

Respekti, dashuria dhe këshillat tashmë nuk e ndalojnë dot këtë shkatërrim.

Fëmijët marrim mësim në shkollë, por nuk marrin mësim në familje. Gjithashtu nuk marrin as edukim fetar. Çdo gjë në lidhje me familjen e mësojnë nga televizori. Ndërsa televizori po i edukon brezat e rinj për t'u bërë njerëz që grinden sa më shumë.

Edhe grindjet më të vogla të bashkëshortëve në çfarëdo lloj çështjeje, shndërrohen në debate të ashpra, të cilat përfundojnë në zënka... Tashmë asnjë nuk përpiqet ta zbusë gjendjen, por gjithmonë për ta acaruar sa më shumë. Nuk ka durim, nuk ka mirësjellje, nuk ka pranim të fajit dhe nuk ka sakrificë. “Do të bëhet ajo që them unë, sepse unë kam të drejtë, unë, unë!...”

Ata që i shohin këto pamje, pandehin se me të vërtetë duhet të jenë kështu. Për këtë arsye, edhe vetë fillojnë të sillen në atë mënyrë. Kultura e televizorit po bëhet shkak për shkatërrimin e vatrave familjare.

Në të vërtetë, nëse njeriu do, e mëson kulturën, u shërben të tjerëve dhe ndjen respekt ndaj tyre... Por nëse do ama. Sot familjet formohen pa e njohur dashurinë. Kështu që edhe një shkak tjetër i ndarjeve është:

MOSNJOHJA E PLOTË E DASHURISË

Dashuria është çelësi i çdo gjëje. Ajo është çelësi edhe i respektit, edhe i sakrificës, edhe i harmonisë.

Kush është shembull më i shkëlqyer në çdo gjë?

I Dërguari i Allahut, (a.s.)...

A duke i rrahur i ka edukuar ai bijat dhe nipërit e tij? Jo!

A duke i rrahur dhe duke u bërtitur i ka edukuar nxënësit e tij, Zejdin, Usamën, Enesin dhe të tjerët? Asnjëherë... Ai gjithmonë i edukoi me dashuri, dhembshuri dhe butësi. Kur ishte e nevojshme, bëhej edhe serioz, por prapë se prapë kishte një seriozitet plot dashuri.

Edhe ata e deshën shumë të Dërguarin e Allahut (a.s.). Atë e respektuan shumë. Asnjëherë nuk i dolën prej fjale.

Dashuria nuk është nënvlerësim apo lënie pas dore. Dashuria nuk është tolerim i gabimeve.

Dashuri do të thotë të mos kaplohemi nga zemërimi. Do të thotë të mos sillemi me ashpërsi dhe ngurtësi ndaj fëmijëve, bashkëshortes dhe nxënësve kur t'u rregullojmë ndonjë gabim të tyre. Do të thotë të mos e humbim dashurinë, e cila shkëlqen brenda syve tanë, kur t'u flasim për ndonjë ves të keq të tyre apo edhe kur t'i rruhim vetullat.

Fëmijëve, nuseve, vajzave, punëtorëve, nxënësve dhe gjithë të tjerëve duhet t'u afrohem me dashuri dhe t'ua mësojmë dashurinë. Kjo do të sjellë edhe butësinë, respektin, drejtësinë, durimin dhe sakrificën. Me anë të dashurisë mund të bëhemi të mëshirshëm ndaj njerëzve e ndaj të gjitha krijesave. Si rezultat, nuk ngelet vend më për urrejtjen.

Kur njeriu nuk ka dashuri, i humbet edhe ndjenjat si respektin, durimin dhe sakrificën. Të urtët thonë: "Mirësia nuk arrihet me imponim!" Kështu

që edhe respekti dhe durimi arrijnë deri në një vend me imponim. Kur të humbasë dashuria, humbasin edhe shumë gjëra të tjera. Për këtë arsye, duhet të mësojmë të duam. Gjithashtu, edhe të tjerët duhet t'i mësojmë të duan.

T'ia plotësosh fëmijës të gjitha dëshirat, të mos e angazhosh me punë, të mos e ngresh për namaz, t'ia tolerosh të gjitha gabimet dhe të mos reagosh ndaj gënjeshtres që thotë, nuk është dashuri, por është përgatitje e tij për dëshpërim në këtë botë dhe për zjarr në botën tjetër. Nëse fëmijët i edukojmë kështu, në të ardhmen do të bëhen njerëz pa karakter, njerëz të padurueshëm, njerëz që zihen edhe me veten dhe njerëz që janë të vështirë për t'u kuptuar. Ja, ky është edhe njëri prej shkaqeve të mungesës së harmonisë.

Nëse dëshirojmë të jemi krenarë dhe fatlumë në të dy botët, feja islame na urdhëron që ta duam Allahun e Madhëruar, ta duam të Dërguarin e Allahut (a.s.), ta duam fenë, t'i duam njerëzit, t'i duam të gjitha krijesat dhe t'i duam ata që do Zoti (xh.xh.).

Ata që i duam, duhet t'i duam për hir të Allahut të Lartësuar.

Nëse duam të formojmë një shoqëri të re, të lumtur dhe të qetë, së pari duhet të gjallërojmë dashurinë. Pastaj ajo do t'i mbledhë një nga një të gjitha cilësitë e moralit të lartë.

Në brendësi të të gjithëve ka dashuri ndaj Allahut Teala... Ai që e do Allahun (xh.sh.), e do edhe caktimin që ia ka shkruar Ai. Gjithashtu e do edhe punën që Ai ia ka bërë kështu, e do edhe bashkëshorten, e do edhe vjehrrën, e do edhe nusen. Çdo gjë e pranon si amanet nga Ai. Për këtë arsye, e mbron dhe sillet me butësi ndaj tij/saj.

Zoti (xh.xh.), na dhëntë të gjithëve prej muhabbetullahit / dashurisë ndaj Allahut!

Çfarë rezultati jep mungesa e kësaj dashurie?

Njeriu arrin në një gjendje që do vetëm veten e tij, domethënë, egoizmi. Në sajë të kësaj, ai nuk duron asnjë vështirësi, problem, vuajtje dhe nuk mund të bëjë asnjë lloj shërbimi kundrejt të tjerëve... Domethënë, llastimi... Struktura e familjes shkatërrohet ngaqë:

**T'ia plotësosh
fëmijës të gjitha dëshirat,
të mos e angazhosh me punë,
të mos e ngresh për namaz,
t'ia tolerosh të gjitha gabimet
dhe të mos reagosh ndaj
gënjeshtres që thotë, nuk
është dashuri, por është
përgatitje e tij për dëshpërim
në këtë botë dhe për zjarr
në botën tjetër.**

JEMI TË LLASTUAR DHE EGOISTË

Fëmijët duhet t'i duam, por jo aq sa t'i llastojmë. Ata duhet t'i rrisim duke i përgatitur për të vërtetat e jetës. Përgjatë kohës që rriten, duhet t'i ushtrojmë për të shërbyer, për të punuar, për t'i respektuar të mëdhenjtë dhe për të shfaqur sakrifica. Sepse, ata do të përballen me këto të vërteta, qoftë në jetën familjare apo qoftë në jetën sociale. Nëse ata i edukojmë duke i llastuar dhe pa pritur asnjë punë apo përpjekje prej tyre, u bëjmë keq në vend se t'u bëjmë mirë.

Shembulli që do t'ju tregoj më poshtë e shpjegon më qartë këtë:

Në një Kurs Kurani kishin vënë një rregull. Një herë për çdo jave do të bëhej pastrim i përgjithshëm i klasave. Sipas rregullit të vendosur, çdo nxënëseje i takonte një herë në muaj për të bërë pastrimin.

Përsëri kishte ardhur radha e pastrimit. Njëra prej nxënësve kishte vënë përparëse, kishte ngritur mangët dhe kishte veshur dorezat. Ndërkohë që i kishte duart me sapun, kishte shkuar te mësuese Aishja dhe kishte filluar të ankohej:

-Mësuese Aishja! A nuk kam ardhur për të mësuar këtu? Apo kam ardhur për të bërë pastrimin? Pa shikojeni gjendje time! Mësueset më urdhërojnë që të bëj pastrimin.

Ajo iu përgjigj:

"Bijë, a nuk do të të urdhërojnë të bësh pastrimin nëse do të të çojnë në ndonjë vend tjetër? A nuk po pastroni vendin në të cilin mësoni dhe rrini vetë? Përveç të tjerash, të gjithë po e bëjnë atë që bën ti. Andaj, kjo punë nuk është vetëm për ty. Edhe kjo është pjesë e edukimit... Ti duhet të ushtrohesh me shërbime të tilla. Pasi vajza e shkretë mori këtë përgjigje dhe e kuptoi se nuk do të dilte në të drejtë, filloi të bërtiste me gjithë zërin që kishte si një njeri që kishte humbur edhe shpresën e fundit:

"Nënë!.. Eja dhe shikoje gjendjen e vajzës tënde të dashur! Shikoja mangët, gjendjen e duarve dhe gjendjen e rrobave! Ato po më urdhërojnë të bëj pastrimin!.. Ti nuk më ke lënë asnjëherë të prek ujë të ftohtë apo të ngrohtë me dorë!.."

Nisur nga kjo, mësuese Aishja i tha:

"Bijë, nëse ti shqetësohesh kaq shumë, nxirri përparësen dhe dorezat, sepse do ta bëj unë pastrimin në vendin tënd."

Vajza u habit dhe e pyeti:

-Çfarë? Ju do ta bëni pastrimin në vendin tim?

"S'kam zgjidhje tjetër. Unë do ta bëj për hatrin tënd, sepse ti nuk po mundesh ta bësh. Kështu që

Nëse bashkëshortët dhe bashkëshortet nuk i respektojnë të drejtat e martesës, detyrimisht shkojnë drejt situatave të pakënaqshme dhe ndarjeve.

dikush duhet ta bëjë në vendin tënd. Përndryshe u hymë në hak shoqeve të tua. Në rregull?

Vajza u mendua dhe i tha mësueses së saj:

"Jo, nuk mund t'ua bëj juve këtë. Andaj do ta bëj vetë pastrimin." Pastaj shkoi për të pastruar.

Kjo vajzë e mori këtë edukim kur ishte në kurs. Po sikur të mos e merrte këtë edukim derisa të martohej? Nëse nuk do ta kishte marrë këtë edukim derisa të martohej, shumë shpejt do të shndërrohej në ndonjë problem familjar.

Gjithashtu, edhe nëna e saj paska pasur besim në zemër që e paska çuar atë në kursin e Kuranit. Ku dhe si do ta mësojnë shërbimin, sakrificën dhe përpjekjen fëmijët e atyre që nuk mund t'i dërgojnë ata në një institucion që jepet një edukim i tillë?

Zoti (xh.sh.), ua ka bërë të dashur prindërve fëmijët e tyre dhe u ka dhënë dhembshuri. Kjo është e vlefshme për të gjitha krijesat. Për këtë arsye, prindërit bëjnë çdo gjë që kanë mundësi për t'i rritur, ushqyer dhe mbrojtur fëmijët e tyre.





Gjyshërit tanë kanë thënë:

“Unë digjem për fëmijët e mi. Ndërsa fëmijët e mi digjen për fëmijët e tyre...” Ky është një rregull i përgjithshëm dhe mirësi e Allahut Teala.

Diku në një penxhere të mbyllur, një pëllumb kishte bërë follenë, kishte bërë vezët, ishte ulur mbi to dhe po i ngrohte në mënyrë që të çelnin. Pastaj erdhi zogu mashkull. Sapo erdhi ai, zogu femër u ngrit dhe shkoi për t’u ushqyer. Në vend të saj u ul zogu mashkull dhe i ngrohi vezët. Kur erdhi zogu femër, përsëri ndryshuan vend. Ata vazhduan ta ndihmonin njëri-tjetrin derisa të vegjlit e tyre çelën dhe u rritën për të fluturuar. Aman o Zot! Sa i madh që je! Kush ua ka mësuar zogjve këto? Zogu mashkull dhe zogu femër e bëjnë bashkë follenë dhe i rrisin bashkë të vegjlit e tyre.

Zoti (xh.sh.), ia ka dhënë edhe zemrës sonë këto ndjenja. Gjithashtu na ka frymëzuar të jemi jo egoistë, por sakrifikues; jo të llastuar, por njerëz që përpiqen dhe mundohen. Por nëse ne nuk e edukojmë neftin dhe nuk i edukojmë fëmijët tanë në këtë formë, nefti / vetja e papjekur gjithmonë zgjedh egoizmin dhe llastimin. Edhe djalli i mallkuar dëshiron që të prishë familjet.

Tani le t’i përmbledhim edhe katër gjendjet e tjera që i konsiderojmë prej shkaqeve të divorcit:

MARTESA PËR HATËR TË DIKUJT EDHE PSE NUK DUAM

Kur prindërit t’i martojnë fëmijët, duhet të marrin parasysh edhe mendimin e tyre. Siç shprehemi edhe në ditët e sotshme, njeriu duhet ta dojë atë me të cilin martohet. Te ata të cilët martohen me imponim edhe pse nuk duan dhe e kundërshtojnë me forcë këtë, përgjatë viteve në vijim lindin probleme të mëdha.

MOSPËRPUTHJA E EKUILIBRAVE NDËRMJET FAMILJEVE

Ndërmjet familjeve të të rinjve që do të martohen janë shumë të rëndësishme përputhja dhe ekuilibri.

Ndryshimet serioze të mendimeve të familjeve rreth kësaj bote dhe ndryshimet ekstreme në kupimin materialo-shpirtëror që ato mund të kenë, kërcënon ndjeshëm të ardhmen e familjes së re që do të formohet.

Në fillim, pasi vajza dhe djali ta duam njëri-tjetrin, duket sikur gjërat e tjera nuk ka shumë rëndësi, por ja që ka shumë ngjarje të dhimbshme të cilat tregojnë se kjo nuk është kështu.

PADREJTËSIA DHE KONSIDERIMI I VETES GJITHMONË NË TË DREJTË

Nëse bashkëshortët dhe bashkëshortet nuk i respektojnë të drejtat e martesës, detyrimisht shkojnë drejt situatave të pakënaqshme dhe ndarjeve.

Hapja e frontit kundrejt familjes nga bashkëshorti apo bashkëshortja, shkëputja e marrëdhënieve me të, ndalimi i fëmijëve për t’u takuar me gjyshërit e tyre dhe padrejtësi të tjera të ngjashme me këto, janë prej shkaqeve që i bëjnë copë-copë familjet.

TRADHTIA, NDERI DHE SHKAQET QË NUK MUND TË FALEN

Në martesë shumë mangësi mund të tolerohen. Dembelizmi, mosnjohja e zakoneve dhe traditave, mangësitë fizike apo të trashëguara, etj, mund të tolerohen, por nderi është i padiskutueshëm. Nëse ndodh ndonjë problem serioz në lidhje me nderin dhe namusin, ky është i pafalshëm.

Zoti (xh.xh.), na bashkoftë ne, fëmijët tanë dhe brezat tanë në mirësi! Na dhëntë dashuri të vërtetë dhe sakrificë! Na e mundësoftë që t’i mbajmë traditat dhe zakonet tona të bukura! Na bëftë prej atyre që kanë moral të lartë e sillen me drejtësi dhe na i mbrojtë familjet tona nga fatkeqësitë!

Amin!..

*“Ne ju ushqejmë
vetëm për hir të Zotit.
Për këtë, nuk duam
shpërblim e as
falënderim!”*

(Insan, 9)



ALTRUIZMI

— Sami Gëksyn —

Allahu i Madhëruar i ka lavdëruar në Kuranin Fisnik ata të cilët japin duke thënë:

“Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënë rob edhe pse vetë janë nevojtarë.” (Insan, 8)

Domethënë, në këtë dhënie ka ndjenjë altruizmi. Ka flijim. Edhe pse Hazreti Aliu dhe Hazreti Fatimja ishin agjërueshëm dhe nuk kishin asgjë, ushqimin e iftareve të tyre tri ditë rresht ia dhanë të varfrit, jetimit dhe robët që u erdhi te dera. Sigurisht se këtë vepër e bënë me këto ndjenja.

Prej sahabëve të të Dërguarit të Allahut (a.s.), kishte prej atyre që i linin fëmijët e tyre dhe vetë pa ngrënë asgjë dhe i jepnin mysafirët.

Ata bënë sakrificë të tilla, sepse ata patën dëgjuar se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Shtëpitë me bukuri të veçantë dhe madhështore të xhenetit janë për ata që flasin butë dhe ëmbël, që u japin për të ngrënë të tjerëve, që agjërojnë vazhdimisht dhe që falin namaz kur njerëzit janë në gjumë.” (Tirmidhi, Xhenet, 3, IV/673.)

Si besimtarë të devotshëm, sahabët e kuptuan shumë mirë këtë hadith fisnik dhe të tjerët të ngjashëm me të. Madje, jo vetëm që i kuptuan, por u bënë shembull edhe për ne duke i përjetuar. Edhe ata që i ndjekin sahabët, e kanë pranuar këtë gjendje

si shkak i lumturisë dhe menjëherë kanë filluar ta zbatojnë.

Kjo gjendje është shumë e lartë dhe fisnike nga që siguron zhvillimin e qetësisë, paqes, bashkimit, unitetit, dashurisë dhe respektit në shoqëri.

Nisur nga kjo që thamë më sipër, myslimanët gjithmonë duhet të japin, duhet të jenë altruistë dhe të kenë moral të lartë. Nevojtarët duhet t'i pranojnë si amanet të tyre. Ata duhet t'i lartësojnë gradat e njerëzillëkut të tyre duke ua mundësuar edhe të tjerëve që të përfitojnë nga mirësitë që u ka dhuruar Allahu Teala. Kjo përpjekje duhet të vazhdojë duke u shtuar në kohë të përshtatshme dhe veçanërisht në muajin e Ramazanit. Por të mos harrojmë se në të gjitha këto përpjekje dhe sakrificë, synimi duhet të jetë vetëm pëlqimi i Allahut (xh.sh.). Besimtarët nuk presin ndonjë shpërblim apo vlerësim prej atyre që i kanë ndihmuar si kundërvlerë për atë që u kanë dhënë. Ata nuk presin prej tyre as komplimente dhe as lavdërime. Në ajetin e nëntë të sures Insan, Allahu i Lartësuar thotë duke na treguar për fjalët e robërve të Tij të veçantë të cilët japin për hir të Allahut:

“Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim!” (Insan, 9)

Sakrificat e tyre nuk përbëheshin vetëm prej sofrave që shtroheshin herë pas here. Nëse do t'i hidhnim një shikim jetës së tyre, do të shohim se si e kanë sakrifikuar pasurinë, madje edhe shpirtin e tyre për të tjerët. Sa bukur i lavdëron Allahu Teala në Kuranin Fisnik muhaxhirët dhe ensarët që e shfaqën këtë sakrificë:

“Një pjesë e plaçkës i takon edhe mërgimtarëve të varfër, të cilët u përzunë nga vendlindja dhe pasuritë e tyre, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë e Allahut dhe duke ndihmuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Pikërisht ata janë besimtarët e singertë. Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndjejnë kurrfarë rëndimi, për atë, që u është dhënë atyre, por duan t'u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarë. Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues.” (Hashr, 8-9)

Këto ajete fisnike tregojnë se ensarët e nderuar kishin një moral sublim edhe në lidhje me këtë çështje. Muhaxhirët ishin në vështirësi, ndërsa ensarët e nderuar u lidhnin plagët. Në këtë mënyrë, ensarët shpëtuan që në këtë botë nga koprracia e egoizmi dhe fituan shpëtimin e shpërblimin hyjnor edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër.

Në hadithin që përmendëm më sipër, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, shprehet se të folurit me butësi, ëmbëlsi dhe mirësi është një mundësi e vyer për të shkruar në xhenet dhe fituar shtëpitë madhështore të xhenetit.

I Dërguari i Allahut (a.s.), si në çdo çështje tjetër, edhe në çështjen e të folurit bukur është i vetmi udhërrëfyesi ynë që mund ta marrim për shembull. Atëherë, ne si myslimanë duhet të jemi të sjellshëm dhe të singertë në të folurin tonë dhe në jetën sociale. Në këtë mënyrë do të fitohen zemrat, do të dalë në pah dashuria dhe respekti, do të shtohen mirëkuptimet dhe do të shfaqet paqja e qetësia. Ne duhet ta dimë shumë mirë se nuk mund të arrijmë askund duke ua thyer zemrat njerëzve, duke i urreyer ata dhe duke shkaktuar përçarje e prishje.

Fjalët e thëna me vend, me mënyrë të sjellshme dhe me urtësi, shkrimet domethënëse dhe të shkruara duke menduar thellë mbi to, influencojnë pozitivisht te shpirtrat, i joshin zemrat dhe na ndihmojnë në realizimin e qëllimit tonë.

Edhe Allahu i Lartësuar, në lidhje me këtë çështje, thotë kështu në shumë ajete të Kuranit Fisnik duke ua tërhequr vëmendjen njerëzve:

“...Thuajuni fjalë të ëmbla.” (Nisa, 8)

Besimtarët e singertë dhe të dëlirë i frikësohen Allahut Teala dhe gjithmonë përpiqen të thonë fjalë të vërteta, të dobishme, të ëmbla dhe të buta. Ata

largohen nga fjalët e dëmshme dhe të padobishme. Në ajetin fisnik të mëposhtëm, Zoti (xh.sh.), na e shpreh këtë obligim duke thënë:

“O ju që keni besuar! Kini frikë nga Allahu dhe thoni fjalë të vërteta.” (Ahزاب, 70)

Gjuha e ëmbël, të shprehurit e bukur, të sjellët me ndershmëri... Një zemër e fituar duke vepruar me këtë metodë, është më e vlefshme se e gjithë bota. Ja pra, në sajë të kësaj, rob i arrin lumturinë dhe shpërblimin e kësaj bote dhe të ahiretit. Në të kundërt, shejtani fut hipokrizi ndërmjet njerëzve, nxit të keqen, shton vështirësitë dhe e ndalon realizimin e qëllimeve që synojnë mirësinë. Kurani Fisnik na ka lajmëruar se shejtani është armiku i hapur i yni.

Allahu Teala na njofton haptazi:

“Kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: “Unë, me të vërtetë jam mysliman.” (Fussilet, 33)

Domethënë, robërit që flasin më bukur janë ata njerëz që përpiqen për t'i ftuar robërit e Allahut të Madhëruar për te Ai. Ata i ftojnë njerëzit për t'i bërë ibadet dhe për t'iu bindur Allahut Teala. Ndërkohë, edhe vetë e praktikojnë atë që thonë dhe bëjnë vepra të mira. Ata bëhen shembull virtyti dhe singëriteti për njerëzit.

Fjala e myslimanëve të tillë të singertë është për Allahun dhe për shërbimin ndaj myslimanëve. Madje, edhe pasurinë dhe jetën e flijojnë duke shërbyer për këtë...

Myslimani duhet t'i gjejë nevojtarët kudo që mund të ndodhen në botën Islame, në mënyrë që t'u japë ushqim për të ngrënë, përse i përket çështjes së të ushqyerit. Po ashtu, edhe me përpjekjet e atyre që e kanë arrirë mirësinë e të folurit bukur, duhet të hapë puse uji në vendet e nevojshme, duhet të bëjë çezma, duhet të ndërtojë azile, duhet të ndërtojë kurse Kurani, duhet të bëjë shkolla dhe duhet t'u japë iftare nxënësve që mësojnë Kuranin. Në këtë mënyrë duhet të përpiqet vazhdimisht për t'ua plotësuar njerëzve nevojat e tyre materialo-shpirtërore.

Ndërkohë që jemi në muajin e përsëritshmërisë, duhet t'i vlerësojmë mirë këto mundësi. Prandaj duhet të nxitojmë për t'i ndihmuar nevojtarët duke marrë vendin tonë në këtë fushë me zekatit, lëmoshat, fitrat¹ dhe mirësitë tona. Padyshim se ata që i bëjnë këto përpjekje, në botën tjetër do të arrijnë nderin për të parë në xhenet “xhemalullah / bukurinë e Allahut”.

Zoti (xh.sh.), na dhëntë sukses për të bërë vepra që na shpijnë në xhenet dhe që na japin nderin për të parë “bukurinë e Allahut”. Amin!..

1. Lëmosha në masë të caktuar që duhet t'u jepet të varfërve brenda muajit të Ramazanit.



NËSE FQINJËSIA KA VDEKUR, EJANI TA NGJALLIM!

— Ajnur Tutkun —

A e dinit se në vendet si Anglia, Franca, Zvicra, Holanda, Danimarka, Australia, Zelanda e Re dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ka lëvizje vullnetare për të zhvilluar marrëdhëniet e fqinjësisë? Unë nuk e dija.

Këto informacione i gjeta ndërsa po kërkoja në internet në lidhje me këtë çështje. Këto lëvizje, me anë të aktiviteteve festive si “dita e fqinjësisë” apo “java e fqinjësisë” që i organizonin nëpërmjet shoqatave “Grupi i mbrojtjes së fqinjësisë” apo “Pallati është në festival”, synonin t’i njihnin me njëri-tjetrin njerëzit që kishin ngelur të mbyllur nëpër pallate, në mënyrë që t’i dilnin për zot njëri-tjetrit. Sigurisht se shkak u që i kishte detyruar këta njerëz për t’i organizuar këto aktivitete ishte gjetja e ndonjë zgjidhjeje për parandalimin e ngjarjeve si vjedhjet dhe krimet. Në fakt, këto lëvizje kishin arritur të korrnin suksese. Në lagjet ku këto lëvizje organizonin aktivitete të tilla, ishte regjistruar një rënie e ndjeshme në këto lloj ngjarjesh. Kjo

rënia e krimeve ishte regjistruar ngaqë fqinjët tashmë ndërhyjnë vetë në këto ngjarje ose të paktën i telefononin policisë. (Dr. Veli Sërëm, i liri dhe i dituri)

Tashmë në mendje menjëherë na vijnë koncepte si roja i lagjes, imami i lagjes, dyqanxhiu i lagjes, kafeneja e lagjes, namusi i lagjes, kryetari i lagjes etj. apo jo? Pastaj na kujtohen edhe koncepte dhe të vërteta të tjera si e drejta e fqinjit, fqinji ka nevojë edhe për hirin e fqinjit, piqet të fqinji por na jepet edhe ne, nuk është prej nesh ai që fle me bark të ngopur ndërkohë që fqinji është i uritur, nëna e fqinjit, pjesëtar i lagjes, vajza e fqinjit, dera e fqinjit etj.

Ah sa marrëdhënie të shkëlqyera fqinjësie që kemi pasur në të kaluarën! Asnjëherë nuk kemi pas qenë shqetësuar nëse në shtëpi nuk ngelte kripë apo sheqer. Sapo të kishim nevojë për diçka, menjëherë mund ta kërkonim nga fqinji ose mund ta çonim te dyqani ndonjë prej fëmijëve të lagjes. Ndoshta ndërmjet nesh ka prej atyre

që kanë pas qenë lodhur duke shkuar te dyqani për fqinjët e tyre. Kur bëhej fjalë për dasmë apo ndonjë gëzim tjetër, nënat tona nuk hezitnin aspak për t'i çuar mysafirët të flinin te fqinji apo për t'i marrë mysafirët e fqinjit të shtëpia e tyre për të fjetur. Trahanatë, salcat, turshitë, bullgurët dhe shumë gjëra të tjera bëheshin duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin.

Ai që kishte halle apo probleme mund t'i ndante lehtësisht me të tjerët shqetësimet e tij. Këtë gjë e bënin veçanërisht me njerëzit e urtë që konsideroheshin të mençurit e lagjes. Këta njerëz jepnin zgjidhje, ua hiqnin stresin të tjerëve dhe nuk merrnin pagesë. Të gjithë së bashku kërkonin djem apo vajza të përshtatshme për ata që e kishin arritur moshën e martesës. Të sëmurëve u çoheshin ushqim dhe atyre që ishin në zi u shtrohej sofa. Dyqanxhiu i lagjes u jepte ushqime hua atyre që nuk e kishin gjendjen e mirë. Fqinjëve që vinin për të bërë muhabet përgjatë netëve të gjata të dimrit, u nxirrej në krye të sobës bajame, arra, rrush i thatë dhe kokoshka. Në këtë mënyrë kënaqeshin edhe fëmijët. Përveç të tjerave, fëmijëve u tregoheshin përralla që të mos mërzhiteshin dhe bëheshin lojëra me shkrepe, me litarë dhe me gjetjen e emrave të qyteteve. Të moshuarit nuk vdisnin në vetmi, por e dorëzonin shpirtin e tyre ndërmjet nipërve e mbesave, fëmijëve dhe fqinjëve duke u lutur për ta dhe duke kënduar pjesë prej Kuranit Fisnik. Dyert e shtëpisë që sot kyçen edhe nëse njerëzit janë në shtëpi përgjatë ditës, atëherë nuk mbylleshin. Kur shkohej në ndonjë vend, çelësi i shtëpisë i jepej fqinjit që të kujdesej për shtëpinë. Në atë kohë nuk kishim nevojë për polic apo rojë, sepse patjetër kishte djem të rinj që e ruanin të gjithë lagjen. Madje ata e ruanin edhe nderin e lagjes.

Ndërsa tashmë kultura e lagjes ka filluar të zhduket, apo jo? Mos vallë shkaku është se jetojmë nëpër apartamente të pallateve shumëkatëshe? Mos vallë shkaku është të menduarit që burrat dhe gratë duhet të punojnë shumë dhe fëmijët të mësojnë pa ndërprerje? Ndoshta shkaku është edhe koha që nuk e gjejmë për t'u takuar me fqinjët, edhe pse çdo punë tashmë na e bëjnë makineritë. Ndoshta nuk takohemi edhe prej mendimit se vizita nuk është e përshtatshme përgjatë javës dhe që fqinjët nuk duhen shqetësuar në fund të javës. Ky mendim është një mendim i atillë që do të na bëjë prej atyre të moshuarve që gjenden të vdekur në shtëpitë

e tyre pas disa javëve dhe muajve siç ndodh vazhdimisht në vendet e Evropës.

Në botën e ditëve të sotme mund të themi se nuk ka asnjë vend që të mos e ketë prekur kapitalizmi. Ndërkohë që përpiqemi të fitojmë më shumë, në mënyrë që të banojmë në shtëpi më të gjerë, të hamë gjëra më të mira dhe të harxhojmë sa të dëshirojmë, humanizmi ynë është në vdekje e sipër. Sigurisht se të gjithë kemi diçka për të bërë, në mënyrë që t'i themi "stop" kësaj ecurie. Në vend që të mendojmë se mund t'i shqetësojmë fqinjët me vizitën tonë, le të mendojmë se i bëjmë të lumtur. Ndoshta ky do të ishte hapi i parë. Ndër më të rëndësishmet është edhe bërja zakon e ndarjes së gjërave me të tjerët. Ndërkohë që në ditët e sotme ka edhe shumë gjëra të tjera që janë turp për t'u bërë, duhet të fillojmë të mësojmë se ato nuk janë të turpshme dhe ofenduese. Dyert tona duhet të jenë vende ku fqinji të vijë lehtësisht dhe të kërkojë atë që ka nevojë në çdo çështje. Të duash për tjetrin atë që do për vete është prej rregullave të arta në marrëdhëniet e fqinjësisë.

Sigurisht se këtu kanë shumë për të bërë edhe arkitektët, planifikuesit e qyteteve dhe zonave, bashkitë dhe qeveritë. Rikthimi te kultura e lagjes, gjallërimi i marrëdhënieve ndërmjet fqinjëve dhe ndërtimi i komplekseve apo pallateve në atë formë që të mos i pengojë marrëdhëniet e fqinjëve është detyrë e arkitektëve dhe autoriteteve. Një sistem si në të kaluarën kur nuk kishte nevojë për polic që të mbroheshe, nuk kishte nevojë për shoqata që të ndihmoheshin njerëzit nevojtarë, nuk kishte nevojë për bankë që të merrej borxh dhe nuk kishte nevojë për psikologë që të jepej ndihma shpirtërore, ndoshta mund të vendoset përsëri në çdo lagje. Ky sistem mund të sjellë qetësi, siguri dhe lumturi.

Ndoshta ne, përderisa të mos fshihemi pas preteksteve, mund ta kemi plotësisht në dorë për të mos e lejuar ambicien e fitimit të madh që të na e shkatërrojë humanizmin me anë të egoizmit e indiferentizmit dhe për ta ngjallur kulturën e fqinjësisë e të lagjes që mund të bëhet ilaç për shumë probleme materialo-shpirtërore të shekullit tonë.

Të ankuarit duke thënë: Ah ku janë ato marrëdhënie fqinjësie që i kemi pasur në të kaluarën! – është ose strehim te pretekstet ose mungesë e dëshirës për t'i pasur përsëri ato marrëdhënie.



Feja është *Sinqeritet!*

— Hadi Ënall —

Nëse më pyesin se cila është garancia e dashurisë, besimit dhe e ndarjes së gjërave me të tjerët, do të përgjigjesha: “Sinqeriteti...” Sinqeriteti, i cili është përputhshmëri e mendimeve dhe ndjenjave me veprat tona, në të njëjtën kohë është edhe masa e vendosmërisë, besueshmërisë dhe e vazhdueshmërisë së ndjenjave dhe mendimeve tona. Sinqeriteti është pasqyra në shpirtin e njeriut që reflekton jashtë ndershmerinë, moralin dhe edukatën e tij. Sinqeriteti është çelësi i të jetuarit me plot dashuri, i të kryerit të veprave gjithë kënaqësi dhe pa interes, i shijimit të jetës së kësaj bote dhe i të jetuarit në harmoni. E kundërta e kësaj cilësie, e cila hap dyert e miqësisë, dashurisë dhe besimit ndërmjet njerëzve dhe e cila i bën të gjelbërojnë konceptet dëlirësi, pastërti dhe besueshmëri, është hipokrizia, mashtrimi, gënjeshtria, shtirja dhe dredhia. Atëherë lind pyetja:

Sa e kemi përvetësuar ne këtë cilësi, për të cilën kemi më shumë nevojë në sipërfaqen e tokës, si popull, si shoqëri dhe si individë? A jemi të sinqertë? Domethënë, a është e njëjtë bota jonë e brendshme



me aparençën tonë? Së pari, a jemi të singertë me Allahun, i Cili na ka krijuar? A jemi të singertë kundrejt pejgamberëve, të cilët ishin udhërrëfyesit tanë dhe veçanërisht kundrejt të Dërguarit të Allahut, Muhamedit, alejhi's-selam? A është i singertë udhëheqësi kundrejt atyre që udhëheq, ata që udhëhiqen kundrejt atij që udhëheq, pronari kundrejt punëtorit, punëtori kundrejt pronarit, studenti ndaj pedagogut, nëpunësit kundrejt shefit, burri kundrejt shtëpisë, gruaja kundrejt bashkëshortit dhe shoku kundrejt shokut? A përputhet zemra jonë me fjalët tona? Cila është shkalla e singëritetit tonë kur themi “mirë”, kur themi “në rregull” dhe kur bëjmë ndonjë veprim? A përputhen fjalët dhe sjelljet me zemrat tona? A i aprovon zemra, ndërgjegjja dhe largpamësia jonë ato që bëjmë apo ato që ndodhin përpara nesh? Apo ato bëjnë sikur nuk dinë gjë thjesht për interesat provizore të kësaj bote treditore? Mos vallë jemi prej atyre që gjithmonë mashtrohen apo mashtrojnë për çdo gjë, duke filluar nga vetja jonë e deri te Krijuesi i Lartësuar?

Përgjigjet e të gjitha këtyre pyetjeve janë të fshehura në pasqyrat e pafundme të kësaj toke në të cilën jetojmë. Ne ndoshta nuk i shohim, por sigurisht se ka prej atyre që i shohin dhe i vlerësojnë. Pa shikojeni, për hir të Allahut, këtë botë mbi të cilën jetojmë dhe njeriun të cilit i është dhënë titulli eshrefu'l-mahlukat / krijesa më e nderuar! Pa shikojeni civilizimin dhe humanizmin që ka formuar ai!.. Nga njëra anë gjaku, dhimbjet dhe lotët që formohen si rezultat i shtypjes, tjetërsimit, urrejtjes, zemërimit, vrasjes dhe shfarosjes... Në anën tjetër mosreagimi dhe plogështia e miliona njerëzve që e pinë alkoolin apo kafënë e tyre plot kënaqësi përpara televizorit duke i ndjekur këto... Në njërën anë ka mungesë të ndërgjegjes, mendjemadhësi dhe mburrje, ndërsa në anën tjetër viktima të pafajshme... Në njërën anë një sistem i formuar mbi padrejtësinë, mashtrimin, vjedhjen dhe plaçkitjen, ndërsa në anën tjetër varfëri, uri dhe skamje totale... Atëherë, ku është ndërgjegjja, ndjeshmëria dhe zemra jonë? Nëse thoni se kjo botë është bota e të fortëve dhe se çdo gjë është e lejuar për t'i arritur interesat, nëse thoni se kjo botë është vuajtje e shtypje për disa dhe kënaqësi e lumturi për disa të tjerë, atëherë për çfarë ju duhet

“Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut” që e keni përgatitur plot përkushtim me mendjen që ua ka dhënë Allahu Teala? Përse njeriu? Përse njerëzia? Ja, në të vërtetë, kjo është ajo që duhet të pyetet dhe të shpjegohet...

Nëse pohoni se jeni njerëz, atëherë duhet të jemi të singertë. Singëritetin, i cili është garancia e dashurisë, besimit dhe e ndarjes së gjërave me të tjerët, duhet ta tregojmë në çdo lloj kushtesh dhe rrethanash. Fajësimi i të tjerëve duke i anashkaluar gabimet tona është mënyra më e lirë dhe e lehtë për t'i arritur interesat. Por ne duhet të arrijmë te të vërtetat pa devijuar në këtë mënyrë dhe duke e marrë në llogari veten. Dëlirësia është baza e singëritetit. Njeriu së pari dhe në veçanti duhet të jetë i singertë kundrejt vetes së tij.

Singëriteti duhet të jetë baza si ndërmjet individëve ashtu edhe ndërmjet shteteve. Le të themi se një singëritet i tillë nuk u formua dot ndërmjet popujve të kësaj bote. Atëherë, ne si vende myslimane duhet të formojmë një singëritet të bazuar në besueshmëri ndërmjet nesh. Ne si shtete myslimane përpiqemi të gjejmë perëndimin në themelin e çdo fatkeqësie që po na ndodh këto dyqind vitet e fundit. Perëndimi është interesaxhi, perëndimi është imperialist, perëndimi është kolonizues, perëndimi nuk është i singertë... Le t'i marrim për të vërteta të gjitha këto, por lind pyetja: “Sa e zbatojmë Islamin, baza e të cilit është singëriteti dhe dëlirësia, ne si vende myslimane?” Mos vallë ne jemi të singertë kundrejt njëri-tjetrit, por perëndimi na pengon në këtë çështje? Le të supozojmë se na ka ndaluar, gjë e cila është mjaft normale, atëherë, përse nuk kthehemi nga vetja jonë dhe t'i shohim mangësitë tona në vend që të fajësojmë perëndimin? Çfarë na ndalon ne për ta parë dhe për ta zbuluar mangësinë e kusurin tonë dhe për ta rregulluar atë? Çfarë përgjigjeje mund t'i japim tjetër kësaj pyetjeje përveç të vërtetës se ne nuk jemi të singertë kundrejt njerëzve, Islamit, Kuranit dhe Allahut? Çfarë ka thënë Pejgamberi i dërguar si mëshirë për botët, Muhamedi, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të: “*Feja është e gjitha singëritet.*” (Muslim, Iman, 95.)

NEVOJA E NJERËZIMIT PËR MËSHIRËN E BOTËVE

— Sali Shasivari —

S'do mend se, misioni i njeriut si zëvendës i Zotit në tokë, me gjitha privilegjet dhe obligimet që i ngërthen në vehte, do të ishte i gjykuar të dështojë, po qe se Allahu i Lartësuar nuk dërgonte një pjesë nga mëshira e Tij e pafundtë përmes të dërguarve të Tij, të cilët do të përcillnin mesazhin Hyjnor, si dhe do të udhëzonin në të mirë dhe do të ndalonin nga e keqja. Kjo, ngase, njeriu, pa udhëzimin Hyjnor dhe vetëm në saje të arsyes dhe logjikës, me të cilën Zoti e fisnikëroi dhe dalloj prej gjitha krijesave tjera, nuk do të arrinte dot të ju përballojë cytjeve, dëshirave dhe epsheve të pangopshme të cilat e përshkojnë atë nga brenda, si rezultat i të qenurit krijesë e dobët, e as sfidave dhe rreziqeve të jashtme me të cilat përballohet në çdo hap të jetës, si rezultat i të qenurit pjesë e shoqërisë së gjërë mbarënjerezore të mbushur plotë e përplotë antagonizma, interesa afatshkurta, egoizma, kundërthënie, etj. Thënë ndryshe, jeta e njeriut në këtë botë, pa dritën profetike, do të ishte mjaft e errët dhe e pakuptimtë, bile-bile e rrezikshme dhe afatshkurtë.

Andaj, Allahu i Madhërishtëm dërgoi në çdo popull profetë, e bashkë me ta edhe shpallje. Kështu, Ademi alejhis-selam, i cili qe njeriu dhe pejgamberi i parë në sipërfaqen e tokës, madje Nuhu a.s., Ibrahim a.s., Ismaili a.s., Is'haku a.s. dhe Jakubi a.s., të cilëve iu shpallën fletushka, si dhe më vonë Musai a.s., të cilit iu shpall Teurati, Davudi a.s. të cilit iu shpall Zeburi, dhe Isau a.s., të cilit iu shpall Inxhili, ishin vetëm disa nga qindra apo mijëra profetët të

cilët i dërgoi Allahu i Lartësuar si lajmëtar, udhëzues dhe qortues.

Të gjithë profetët bartnin të njejtin mesazh universal, mesazh ky i cili kishte për qëllim çlirimin e njeriut nga adhurimi dhe nënshtrimi ndaj personave, kah adhurimi i vetëm Një Zoti të pashoq, si dhe ngritjen e tij në pozitën e mëkëmbësit dhe ndërtuesit të kësaj jete. Ky mesazh hyjnor u përtëritë me ardhjen e çdo pejgamberi, deri në shpalljen e vulës së të dërguarve, Muhamedit (a.s.), me ardhjen e të cilit u kurorëzua shpallja qiellore dhe u kompletua mesazhi pejgamberik. I vetmi dallim në mes misionit të profetëve të mëparshëm, si dhe vulës së pejgamberisë, Muhamedit (a.s.), ishte se, profetët e mëparshëm ishin të dërguar për një kohë dhe për një popull të caktuar, ndërkaq, Muhamedi (a.s.) qe dërguar mëshirë për të gjitha kohërat dhe gjithë botërat, deri në Ditën e Gjykimit.

Poashtu, edhe shpalljet hyjnore, si: Teurati, Zeburi, Inxhili dhe Kur'ani, në vete bartnin po të njejtin mesazh qiellor, respektivisht, reformimin e jetës së njerëzimit në tërësi, duke i transferuar ata nga barbarizmi dhe idhujtaria, kah qytetërimi i vërtetë monoteist. Pika dalluese në mes shpalljeve të mëparshme dhe shpalljes së fundit, Kur'anit fisnik, qëndron në dy aspekte thelbësore, edhe atë: së pari, në faktin se shpalljet e mëhershme i referoheshin një periudhe dhe një populli të caktuar, duke përcaktuar dispozita konform kushteve dhe rrethanave në fjalë; ndërkaq, shpallja e fundit, Kur'ani fisnik,

erdhi si udhërrëfim universal deri në Ditën e Gjykimit. Së dyti, Allahu Fuqiplotë e garantoi mbrojtjen dhe autenticitetin e Kur'anit famëlartë deri sa të jetë jeta, gjë që nuk ndodhi me shpalljet e mëparshme, të cilat përjetuan falsifikime dhe ndryshime.

Periodha e cila i parapriu ardhjes së Muhamedit (a.s.) njihej si periudhë e injorancës (xhahilijetit). Ky emërtim nuk ishte antonim i dijes, por në të vërtetë ishte sinonim i idhujtarisë, blasfemisë, padrejtësive, amoralitetit, dhunës, dhe çdo gjëje tjetër negative e cila është në kundërshtim me dinjitetin e njeriut si dhe me rolin dhe funksionin për të cilin është krijuar. Kështu, njeriu ishte rob i vëllaut të tij njeri; dallimet racore, gjinore, klasore dhe fisnore ishin në kulminacion; shoqëria ishte e ndarë në pronarë dhe skllëvër; vlerat ishin përmbysur; gjakderdhja dhe hakmarrjet ishin bërë normalitet; jetimët, të varfërit dhe të dobttit ishin pa mbrojtje; vajzat varroseshin të gjalla; robërit e luftës vriteshin; etj. Të gjitha këto dhe shumë anomali tjera të cilat ishin përhapur në shoqërinë mekkase të asaj kohe si dhe në shoqëritë përreth, e të cilat ishin rezultat i drejtëpërdrejtë i devijimit nga rruga e drejtë si dhe humbjes së lidhjes me Krijuesin, determinuan ardhjen e Muhamedit (a.s.).

Lindjes së tij (a.s.) iu gëzua Tokë e Qiell. Me ardhjen e tij në këtë botë u ringjallën shpresat. Adhurimi i Zotit Një, dituria, dashuria, humaniteti, paqa, toleranca, solidariteti, respekti dhe mirëqenia ishin vetëm disa nga vlerat dhe parimet në të cilat ftoi Muhamedi (a.s.). Të gjitha këto vlera dhe parime, në konceptin kur'anor kanë një emërtim të përbashkët, 'mëshirë për botërat'. Thotë Allahu i Lartësuar: "E Ne të dërguam ty (Muhamed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat" (Kur'an, kaptina 'El-Enbija', ajeti 107). Prandaj, 'dora' e mëshirës së tij, përpos që preku çdo individ, duke përfshirë këtu të dobttit, skamnorrët, jetimët, po bile edhe armiqtë, kjo mëshirë kaploi edhe botën bimore dhe atë shtazore.

Muhamedi (a.s.), me frymëzim nga Allahu i Gjithdijshëm, ftoi në një fe (fenë Islame) e cila përkon me natyrën reale të njeriut; fe e cila përkujdeset për nevojat e shpirtit si dhe kërkesat e trupit, duke bërë një ekuilibrim mes të punuarit për këtë botë dhe të punuarit për Botën Tjetër. Misioni parësor i thirrjes së tij ishte çlirimi i shpirtërave nga bestytnitë dhe bindjet e gabuara, çlirimi i zemrave nga ndjenjat negative, si dhe çlirimi i mendjeve nga mendimet e kota. Madje, ai porositi dhe stimuloi për kërkim të diturisë si dhe shfrytëzim racional të mendjes, për të hulumtuar rreth të vërtetave të kozmosit dhe shkencave, ndërkohë që rreptësisht ndaloi çdo element që ndikon negativisht në arsyen e njeriut.

Poashtu, Pejgamberi (a.s.) vlerësoi lartë vlerat morale dhe etike, duke ftuar në praktikimin dhe mbrojtjen e këtyre vlerave, në mesin e të cilave

bëjnë pjesë: sinqeriteti, besa, matura, etj. Në të njëjtën kohë, ai porositi përforcimin e marrëdhënieve shoqërore, mbajtjen e lidhjeve farefisnore, respektimin e marrëdhënieve familjare, mirësinë në mes bashkëshortëve, kujdesin ndaj prindërve, mëshirën ndaj fëmijëve, respektin ndaj pleqve, etj.; vlera këto të cilat ai i jetësoi edhe praktikisht. Në anën tjetër, ai ndaloi nga vlerat e ulëta morale, duke u distancuar prej tyre dhe duke ua tërhequr vërejtjen njerëzve ndaj veseve të tilla, siç janë: gënjeshtria, pabesia (tradhtia), zilia, amoraliteti, urrejtja, përgojimi, etj. Në sajë të kësaj praktike, Muhamedi (a.s.) e meritoi lëvdatën e Krijuesit të Gjithësisë, me ç'rast, Allahu i Madhërueshëm, në Kur'anin famëlartë, dëshmoi për të dhe moralin e tij, duke thënë: "Vërtet, ti je në një shkallë të lartë të moralit" (Kur'an, kaptina 'El-Kalem', ajeti 4).

Për më tepër, dashuria, humaniteti, respekti, drejtësia, paqa, toleranca dhe solidariteti i Pejgamberit (a.s.) kaploi gjithë botërat. Madje, këto principe u manifestuan në veprat dhe sunnetin (praktikën) e tij të ndritshme, para se të artikulohej në fjalët dhe hadithet (thëniet) e tij. Mjafton të citojmë hadithin (thënien) e tij në vijim, që të kuptojmë dimensionin hyjnor të mesazhit të tij profetik: "Nuk e ka besimin e përkryer asnjë prej jush përderisa nuk ia dëshiron vëllaut të vet atë që e dëshiron për vetveten". (Transmeton Buhariu).

Pikërisht këto vlera unike dhe këto dimensione të larta njerëzore bënë që Pejgamberi (a.s.) të respektohet nga armiqtë, para se të duhet dhe respektohet nga miqtë dhe pasuesit e tij. Kështu, çdokush që e njohu Muhamedin (a.s.), nuk pati zgjidhje tjetër, përpos ta dojë dhe respektojë këtë figurë të ndritur. Bile, të shumë janë ata që, përreth dallimeve ideologjike, vlerësuan lartë misionin dhe kontributin e tij në ndryshimin e rrjedhave botërore, duke i dhënë atij epitetin e 'reformatorit më të madh' në historinë njerëzore. Kjo, përpos disa personave, të cilët, të verbuar nga ndjenja e urrejtjes dhe zilisë, gjithë vrerin dhe mllëfin e tyre e e derdhën mbi qenien më të dashur në sipërfaqen e dheut, të cilën nuk e njohën.

Së këndejmi, nëse bëjmë një krahasim të mirëfilltë në mes të rrethanave të cilat i paraprinë ardhjes së Pejgamberit (a.s.), si dhe atyre të cilat dominojnë në ditët e sotme të kësaj periudhe postmoderne, do të shohim se, përpos distancës së largët kohore, shumëçka tjetër tingëllon mjaft e përafërt, e ngjashme dhe e njohur. Dallimi i vetëm qëndron në emërtime. Andaj, njerëzimi, si asnjëherë më parë, ka nevojë për rikujtim dhe praktikim të traditës profetike, me të gjitha mësimet dhe mesazhet që ngërthen në vete kjo traditë, me qëllim të daljes nga kjo 'injurancë bashkëkohore' në të cilën është zhytur.



5 Përfitimet shëndetësore

TË FRUTAVE AGRUME

Agrumet rriten në pemë dhe shkurre dhe origjinën e kanë nga rajoni i Himalajeve. Këto fruta rriten në të gjithë botën, gjatë gjithë vitit veçanërisht në vende si Azia Juglindore, Australia dhe Papua Guinea e Re, në varësi të stinës në klimat subtropikale dhe tropikale.

Varieteteve të ndryshme të agrumeve janë portokall, limon, lime, mandarina dhe grejpfrut. Limonët ofrojnë mjaft përfitime shëndetësore, sepse ato janë të pasura me acid citrik, i cili dihet se është një antioksidant i fuqishëm, ndërsa portokallet janë një burim i mirë i vitaminës C, transmeton arbresh. info.

Por se cilat janë të mirat shëndetësore që sjellin këto fruta, mund të lexoni më poshtë:

VITAMINA DHE MINERALE

Një portokall me madhësi të mesme ka marrjen e nevojshme ditore të vitaminës C të nevojshme për të mbrojtur trupin kundër sëmundjeve që ka lodhjen si simptomën e saj kryesore. Vitamina C mban sistemin imunitar dhe lëkurën në gjendje të mirë. Për më tepër, magnezi, kaliumi, fosfori dhe bakri në agrumet luajnë një pjesë të madhe në procese të caktuara trupore. Agrumet gjithashtu dihet se përmbajnë një kombinim të shëndetshëm të flavonoideve dhe karotenoideve që mbrojnë trupin kundër sëmundjeve të dëmshme.

PARANDALIMI I KANCERIT

Agrumet veprojnë si antioksidantë dhe parandalojnë kancerin duke bllokuar në mënyrë efektive shprehjen e gjeneve kanceroze. Edhe agrumet shkaktojnë kancerogjenët me këtë metodë. Kanceri i gjirit, kanceri i stomakut dhe pankreasit mund të parandalohet nëse agrumet konsumohen rregullisht. Madje, sipas një studimi një qitro mjafton për të zvogëluar rrezikun e kancerit të mushkërive.

VRET QELIZAT E PASHËNDETSHME TË TRURIT

Sëmundjet e Alzheimer dhe Parkinson janë dy nga llojet më të zakonshme të sëmundjeve neurodegeneruese që mund të parandalohen nga konsumi i flavonoideve në agrumet.

HUMBJA E PESHËS

Portokallet janë një burim i bollshëm i fibrave. Është një fakt i njohur se fibra është e nevojshme për të përmirësuar funksionet e sistemit të tretjes, duke shkaktuar humbje peshe si rezultat. Fibra mbush stomakun dhe ul ndjeshëm oreksin. Një limon përmban 12 kalori dhe një portokall përmban 62 kalori. Një studim i fundit ka gjetur se njerëzit që konsumojnë rregullisht limon dhe portokall kishin peshë më të ulët në krahasim me ata që nuk i konsumonin.

NDALON FORMIMIN E GURËVE NË VESHKA

Sipas një studimi që vëzhgoi formimin e gurëve në veshka për një periudhë prej 40 vjetësh, u zbulua se njerëzit që konsumojnë agrume rrallë janë më të prirur për të vuajtur nga gurët në veshka sesa

ata që konsumojnë rregullisht agrume. Përmbajtja e ulët e citrateve në urinë është e lidhur me një lloj të veçantë të gurit në veshka. Citrat mund të rriten natyrshëm pa u drejtuar në shtesa të citrateve të kaliumit. Prandaj, konsumi i agrumeve mund të konsiderohet një ilaç natyral kundër gurëve në veshka.

Përfitimet E FARAVE TË KUNGULLIT

Gjëja më e mirë që mund të bëni është që t'i thani vetë. Kjo do t'ju garantojë freskinë që ndikon në mbajtjen e vlerave aktive të përbërësve natyralë të farave. Farat shqiptare përmbajnë gjithmonë më pak kripë se ato të importit.

Ato janë ideale, jo vetëm sepse përmbajnë yndyrna dhe fibra, por edhe mbajnë zemrën të shëndetshme dhe ulin enjtjet.

Farat e kungullit janë një metodë fantastike për përfitimin e vitaminës E e cila konsiderohet të jetë një antioksidant i fortë.

Farat e kungullit janë të vetmet fara që formojnë alkalinë. Kur ushqimet janë të pasura me aciditet, ky është një lajm shumë i mirë për ata që duan të ruajnë ekuilibrat e pehashit në trup.

VLERAT SHËNDETËSORE TË FARAVE TË KUNGULLIT

Farat e kungullit që janë të pasura me acide yndyrore Omega-3 që e mbajnë zemrën të shëndetshme duke ulur tensionin e gjakut.

Këto fara ulin nivelin e kolesterolit, rreziqet e shfaqjes së diabetit, peshën e tepërt, përmirësojnë humorin dhe luftojnë tumoret.

PARANDALOJNË PROBLEMET E KOCKAVE DHE REUMATIZMËS

Njerëzit që vuajnë nga pamjaftueshmëria e zinkut duhet të marrin në konsideratë konsumimin e farave të kungullit. Metodat për përfitimin e zinkut, një mineral i nevojshëm për kockat janë të shumta.

Në çerek filxhani me fara kungulli, do të përftoni 17% të dozës së rekomanduar ditore të zinkut.

ULIN KOLESTEROLIN DHE MBAJNË ZEMRËN TË SHËNDETSHME

Farat e kungullit përmbajnë fitosterolë dhe arrijnë të përmirësojnë nivelet e kolesterolit të mirë. Studimet mbi këtë temë kanë provuar se fitosterolët arrijnë të ulin kolesterolin e keq me 13% dhe kolesterolin në përgjithësi me 10%.

PARANDALOJNË FORMIMIN E GURËVE NË VESHKA

Farat e kungullit përmbajnë substance që jo vetëm parandalojnë, por edhe luftojnë gurët në veshka. Rekomandohet të konsumoni 5 deri në 10 gramë me fara kungulli në ditë për të mbrojtur veshkat dhe parandaluar formimin e gurëve.

LARGOJNË DEPRESIONIN DHE ULIN ANKTHIN

Farat e kungullit janë ideale jo vetëm për trupin por edhe për trurin. Studimet kanë treguar që farat e kungullit bashkë me glukozën janë të mira për të ulur ankthin dhe depresionin.

Proçesi i gatimit shkatërron avantazhet ushqimore të farave të kungullit dhe acidet yndyrore aq të nevojshme. Mënyra më e mirë për të përfutur prej tyre është t'i përdorni në sallata ose t'i konsumoni veçmas.





PRODHOHET MERCEDESI I RI PA TIMON

Vision AVTR është një makinë koncept futuriste nga Mercedes-Benz.

Këtu është Vision AVTR, koncepti futuristik i makinës Mercedes, frymëzuar nga filmi “Avatar”. Makina zëvendëson shumë kontrolle themelore për të qenë më të lidhur me shoferin.

Kjo makinë nuk ka timon dhe pedale, dhe në vend të timonit ka një kontrollues interaktiv të ngjashëm me levë në konsolën qendrore, transmeton Lajmi.net Brenda AVTR, makina fillon kur shoferi vendos dorën në levën qendrore të kontrollit. Pajisja përdoret nga shoferët për të përshpejtuar, frenuar dhe kthyer makinën.

Në vend të një pulti ose ekrani infotainment, pjesa e përparme e kabinës përmban një modul gjigant

të ekranit të lakuar që projekton pamje në kohë reale të rrugës përpara. Ju mund të zgjidhni që ajo të ndriçohet me grafikë 3D të ‘Pandoras’, botës së trilluar nga filmi i vitit 2009 i “Avatar”. Për të hyrë në veçoritë e ndryshme të makinës, hiqni dorën nga leva qendrore dhe në pëllëmbën tuaj projektohet një menu kontrollesh që mund ta kaloni me gjeeste.

Trupi i makinës përdor modelin e njëjtë me Mercedes me një hark, si shumë prej koncepteve të tjera të prodhuesit të automobilave, por përmban një xham masiv dhe dyer plotësisht transparente. Koncepti tërësisht elektrik përmban katër motorë, një në secilën rrotë, që së bashku bëjnë një kombinim prej 469 kuaj fuqi. Bateria e saj gjithashtu menaxhon një diapazon total makinerie deri në 600 kilometra.

KAMERA MË E MADHE DIXHITALE NË BOTË SHKREP FOTOGRAFINË E PARË NGA QIELLI

U deshën më shumë se një dekadë dhe rreth 700 milionë dollarë për krijimin e saj, por kamera dixhitale më e madhe në botë realizoi fotografinë e saj të parë.

Kamera që është projekt i përbashkët i dy agjencive qeveritare të Shteteve të Bashkuara, është krijuar për regjistrimin e imazheve të universit për dhjetë vitet e ardhshme.

Projekti më i madh filmik i të gjitha kohërave po ndërtohet në një qendër vrojtimi në Kili.

Misioni i tij? Asgjë më pak se regjistrimi i imazheve të asaj që është e dukshme në univers.

“E dinim se kishim nevojë për një kamera shumë të madhe. Ajo që ne kërkonim ishte më e madhe sesa çdo aparat i krijuar më parë”, tha Dr. Steven Kahn i qendrës vrojtuuese “Vera C. Rubin.

Steven Kahn po udhëheq punimet për ndërtimin

e kamerës me rezolucion prej 3 miliardë pikselë që ofron fotografi 300 herë më të qarta sesa një telefon inteligjent dhe që do të filmojë qiellin gjatë natës për 10 vitet e ardhshme.

“Nëse e bëjmë këtë vazhdimisht për dhjetë vite, atëherë do të kemi mijëra imazhe të çdo pjese të qiellit. Duke krahasuar fotografitë, do të shohim dallimin në qiell dhe gjithçka që lëviz në të”, thotë Dr. Kahn.

Të dhënat që mblidhen për herë të parë nga kamera e financuar nga qeveria amerikane, do të ndihmojnë në zbardhjen e dy mistereve shkencore: errësirës dhe energjisë së saj.

Por studiuesit zgjedhën diçka më të zakonshme për provën e parë të kamerës: një copë brokoli.

U deshën më shumë se një dekadë dhe rreth 700 milionë dollarë për krijimin e saj, por kamera di-



xhitale më e madhe në botë realizoi fotografinë e saj të parë.

Kamera që është projekt i përbashkët i dy agjencive qeveritare të Shteteve të Bashkuara, është krijuar për regjistrimin e imazheve të universit për dhjetë vitet e ardhshme.

Projekti më i madh filmik i të gjitha kohërave po ndërtohet në një qendër vrojtimi në Kili.

Misioni i tij? Asgjë më pak se regjistrimi i imazheve të asaj që është e dukshme në univers.

“E dinim se kishim nevojë për një kamera shumë të madhe. Ajo që ne kërkonim ishte më e madhe sesa çdo aparat i krijuar më parë”, tha Dr. Steven Kahn i qendrës vroituese “Vera C. Rubin.

Steven Kahn po udhëheq punimet për ndërtimin e kamerës me rezolucion prej 3 miliardë pikselë që ofron fotografi 300 herë më të qarta sesa një telefon inteligjent dhe që do të filmojë qiellin gjatë natës për 10 vitet e ardhshme.

“Nëse e bëjmë këtë vazhdimisht për dhjetë vite, atëherë do të kemi mijëra imazhe të çdo pjese të qiellit. Duke krahasuar fotografitë, do të shohim

dallimin në qiell dhe gjithçka që lëviz në të”, thotë Dr. Kahn.

Të dhënat që mbledhen për herë të parë nga kamera e financuar nga qeveria amerikane, do të ndihmojnë në zbardhjen e dy mistereve shkencore: errësirës dhe energjisë së saj.

Por studiuesit zgjedhën diçka më të zakonshme për provën e parë të kamerës: një copë brokoli.

“Fotografimi i saj ishte interesant sepse ndërsa e zmadhoje shihje më shumë gjëra”, shtoi zoti Khan.

Shfaqja e fotografisë së brokolit do të kërkonte një ekran me cilësi tejet të lartë.

Shkencëtarët por edhe qytetarët e interesuar do të analizojnë të dhënat e siguruar nga kamera.

Zoti Kahn thotë se ka mjaftueshëm galaktika për secilën klasë në botë, duke u mundësuar studentëve zbulimin e një supernove.

“Nxënësit e shkollave mund të jenë njerëzit e parë që do të shohin një supernovë.”

Kamera pritet të nisë grumbullimin e imazheve në vitin 2023





Ju ofron:

Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!



Lagja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër

+355 67 47 39389

1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar

5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR

(djem dhe vajza)

NGA KLASA E 1-RË
DERI NË KLASËN E 5-TË

“Elif, Lâ, Mîm.
Ky është Libri në të cilin
nuk ka dyshim.
Ai është udhërrëfyes
për të devotshmit,
të cilët besojnë në të fshehtë,
falin namazin dhe japin nga
ajo që u kemi dhënë Ne”.

(Bekare, 1-3)